



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



**DEMOCRACY
PLUS**

DREJT KOMUNAVE ME PROKURIM PUBLIK TË HAPUR, LLOGARIDHËNËS DHE EFIKAS

Raport i monitorimit të
aktiviteteve të prokurimit
në Komunën e Prishtinës,
Pejës, Gjilanit, Gjakovës
dhe Vushtrrisë

Nëntor 2018



DREJT KOMUNAVE ME PROKURIM PUBLIK TË HAPUR, LLOGARIDHËNËS DHE EFIKAS

Raport i monitorimit të
aktiviteteve të prokurimit
në Komunën e Prishtinës,
Pejës, Gjilanit, Gjakovës
dhe Vushtrrisë

Nëntor 2018



Për Demokraci Plus

Demokraci Plus (D+) është organizatë jo qeveritare që bashkon persona me besim të fuqishëm në vlera demokratike dhe në një Kosovë me demokraci të qëndrueshme. Qëllimi kryesor i D+ është të nxisë vlera dhe praktika demokratike, si dhe politika që stimulojnë aktivizmin qytetarë.

Në kuadër të D+ funksionojnë tri programe: Programi për Qeverisje të Mirë, Programi për Sundim të Ligjit, dhe Programi për Zgjedhje dhe Parti Politike. D+ përkrahë institucionet qeveritare, qytetarët dhe mediat në përmirësimin e qeverisjes, avancimin e politikave publike dhe fuqizimin e sundimit të ligjit.

Organizata jonë përqendrohet në përdorimin e teknologjisë informative për qëllimet e lartëshënuara, dhe si rezultat ka zhvilluar platformat online ndreqe.com dhe qeverisjatani.info të cilat ofrojnë hapësirë për pjesëmarrje qytetare në vendimmarrje dhe llogaridhënie të institucioneve qeveritare. Për më tepër, D+ është anëtare e ProOpen, koalicioni i OJQ-ve që ka për qëllim ngritjen e transparencës në prokurim publik dhe parandalimin e keqpërdorimit të parasë publike.

Nëntor 2018

Titulli i Projektit: Ekspozimi i korrupsionit përmes monitorimit dhe krahasimit të pesë komunave

Data e dorëzimit: Nëntor 2018

Ky raport është përgatitur nga Demokraci Plus (D +) dhe mbështetet nga USAID përmes aktivitetit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënese (USAID TEAM). Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	6
------------------	---

GJETJET KRYESORE	7
------------------------	---

HYRJE	8
-------------	---

KOMUNA E PRISHTINËS	9
----------------------------------	----------

Furnizimi me qumësht për nxënësit e shkollave – niveli i ulët prej klasës së I-V.....	10
Ndërtimi i disa rrugëve në fshatin Trudë	13
Ndërtimi i rrugëve në lagjen Myrtaj, Bekaj, Bahtirovit dhe Nezirovit në fshatin Busi si dhe Ndërtimi i rrugës dhe trotuareve në fshatin Drenovc	17
Ndërtimi i rrugëve në brendësi të Fshatit Slivovë ..	25
Rindërtimi, sanimi dhe zgjerimi i disa rrugëve sekondare në territorin e Komunës së Prishtinës ..	27
Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve II.....	29
Revitalizimi i shkallëve dhe ndërtimi i mbikalimit në lagjen Arbëria	29
Furnizimi me pajisje teknologjike për objektet komunale dhe të bashkësisë lokale.....	30
Infografikat dhe sinjalizimi në objektet e Komunës	32

KOMUNA E PEJES	33
-----------------------------	-----------

Furnizim me dru për institucionet shkollore për fazën e II-të	33
Furnizim me naftë dhe derivate të naftës për Komunën e Pejës	35
Ndërtimi i ndriqimit publik në disa lagje të qytetit të Pejës, Faza e II-të.....	36
Ndërtimi i objektit të Shkollës së Mesme të Artit "Odhise Paskali" - Punët e vrazhdta	36
Shërbimet e telefonisë mobile për nevojat e institucioneve komunale.....	38

KOMUNA E GJAKOVËS	39
--------------------------------	-----------

Furnizim me inventar për shkolla	39
Furnizim me naftë për ngrohje dhe karburante.....	40
Furnizim me një automjet për hemodializë.....	40

Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Komunës së Gjakovës.....	41
Mirëmbajtja e Autorrugëve	44
Furnizim me pajisje mjekësore dhe jo-mjekësore..	50
Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme....	51

KOMUNA E GJILANIT	52
--------------------------------	-----------

Furnizim me inventar për të gjitha njësitë kërkuese në Komunën e Gjilanit	52
Furnizim me material Higjeniko – Sanitar	55
Furnizim me serra për nevojat e fermerëve në Komunën e Gjilanit.....	56
Furnizim me tonera për të gjitha njësitë shpenzuese në Komunën e Gjilanit.....	56
Furnizim me Skener (Detektor) dhe pajisje për nevoja të sallës së re të Kuvendit Komunal	57
Furnizimi dhe montimi i nxemjes qendrore në sallën e edukatës fizike në shkollën fillore "Musa Zajmi"	58
Sigurimi i automjeteve për nevojat e K.K. Gjilan.....	59
Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit të tretë, pastrimi i lumenjëve dhe largimi i deponive të egra në Komunën e Gjilanit	59
Rekonstruimi i stadionit të qytetit në Gjilan.....	61

KOMUNA E VUSHTRRISË	62
----------------------------------	-----------

Furnizim me pajisje të teknologjisë informative për nevoja të Komunës së Vushtrrisë.....	62
Furnizim me fidane Arrë	63
Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale të Komunës së Vushtrrisë	64
Ndërtimi i lapidarit në fshatin Gllavotin (Faza e I-rë)	65
Ndërtimi i Qendrës së Kulturës "Hasan Prishtina" në Vushtrri	65
Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni (Faza e IV-rë)	67
Riasfaltimi i rrugës lokale Vushtrri-Sllatinë	68
Rregullimi i varrezave	68
Zgjerimi, thellimi dhe pastrimi i shtratit të Lumit Llap.....	69

SHKURTESAT

AK	Autoritet Kontraktues
AMD	Advanced Micro Devices
AVUK	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DIN	Instituti Gjerman i Standardizimit
DT	Dosja e Tenderit
FDT	Fletën e Dosjes së Tenderit
ISO	Organizata Ndërkombëtare për Standarde
JUS U.N2.060	Standard Jugosllav i Cilësisë
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
KV	Kushtet e Veçanta
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
LPPA	Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative
OE	Operator Ekonomik
OSH	Organi Shqyrtues i Prokurimit
TVSH	Tatimi Mbi Vlerën e Shtuar
UDHËZUESI	Udhëzuesi dhe Rregullat e Prokurimit Publik
UHT	Temperaturë Ultra e Lartë e Procesimit të Qumështit
ZHD	Standard Gjerman i Cilësisë

GJETJET KRYESORE

Prokurimi publik paraqet njërin ndër aktivitetet kryesore ekonomike të komunave dhe si i tillë po ashtu paraqet një ndër rreziqet kryesore në drejtim të ofrimit të shërbimeve kualitative për qytetarët. Me qëllim të identifikimit të shkeljeve në aktivitetet të prokurimit publik dhe me qëllim të ofrimit të të dhënave të argumentuara për shkeljet të cilat ndodhin në prokurim, humbjet dhe dëmet e shkaktuara në buxhet, D+ ka monitoruar nga nëntë aktivitetet të prokurimit në këto komuna. Përfundimisht, në Komunën e Pejës janë monitoruar pesë aktivitetet të prokurimit, pasi që në kohën e fillimit të fazës së monitorimit, komuna nuk ka patur më shumë projekte në zbatim.

Paraprakisht, D+ ka publikuar "Matësin e Prokurimit Publik" i cili ka pasur për qëllim identifikimin e praktikave të mira në prokurimin publik në këto pesë komuna. Qëllimi i këtij raporti ishte që praktikata e mira të identifikoheshin në cilëndo nga këto pesë komuna të mund të vlerësohen dhe të ndahen me autoritetet e tjera kontraktuese. Në këtë raport, D+ është fokusuar në identifikimin e shkeljeve në prokurim publik, sidomos në rastet kur kemi të bëjmë me humbje apo dëmtim të buxhetit të komunës. Si rezultat i punës së D+ në monitorimin e prokurimit publik në nivel komunal, të paktën 36,684 euro të parave të taksapaguesve u kursyen. Monitorimi theksoi gabimet në faturim nga një kontraktues, të cilat më herët nuk janë identifikuar nga Komuna e Prishtinës. Pas kësaj, Komuna planifikon të ndërmarrë masa korrigjuese, duke ndryshuar kontratën për të rregulluar përshtatjen e çmimit dhe rimbursimin e parave të humbura të taksapaguesve. Ky është vetëm një shembull se si monitorimi nga shoqëria civile mund të përdoret si një mjet nga komunat në adresimin e dobësive të sistemeve të tyre të brendshme.

Nga ky monitorim D+ ka identifikuar një numër të gjetjeve të cilat janë të përbashkëta për të pesë këto komuna, por gjithashtu janë evidentuar edhe shkelje të cilat janë karakteristike e vetëm një komune. Disa prej gjetjeve kryesore të këtij raporti përfshijnë:

- Hartimin e paramasave dhe parallogarive të projekteve sidomos tek kontratat e ndërtimit të rrugëve të cilat i kanë fryrë pozicionet, Kompanitë që kanë informacion rreth volumit të fryrë të punës ofertojnë me çmime jo-normalisht të ulëta, duke e ditur paraprakisht se duhet të kryejnë më pak punë në realitet. Kompanitë që nuk kanë qasje në këtë informacion ofrojnë me çmime reale, duke supozuar që komuna ka planifikuar siç duhet volumin e punimeve. Rrjedhimisht, kompanitë me oferta më të ulëta fitojnë kontrata. Për shembull, tenderi i Komunës së Gjilanit për riparimin dhe hapjen e rrugëve terciare ka deklaruar se sasia e materialeve të ndryshme duhet të jetë 32500 m³, ndërsa sasia është 17500m³ në total. Diferenca në sasi është më e madhe se 15000 m³, pothuajse sa gjysma e parashikimit. Një kompani e cila ka këtë informacion mund të tejkalojë konkurrentët, duke ditur se vëllimi i punëve është më i ulët se sa që është paraqitur në dosjen e tenderit. Kjo praktikë ka një efekt negativ në konkurrencë dhe mund të çojë në humbje të fondeve publike.
- Porositja vetëm e artikujve të shtrenjtë të kontratës, pa kërkuar artikuj me çmime më të lira. Për shembull, Komuna e Gjakovës urdhëroi veçmas pastrimin e rrugëve nga bora dhe veçmas hedhje të kripës. Këta dy artikuj së bashku kushtojnë dy herë më shumë se pika e tjetër e kontratës, pastrimi i rrugëve nga bora dhe hedhja e kripës së bashku.

Të gjeturat tjera nga monitorimi i aktiviteteve të prokurimit përfshijnë:

- Mungesa e mbikëqyrjes efektive të pranimit të mallrave, që mund të krijojë rrezikun e marrjes së furnizimeve që nuk përputhen me kontratën, ose janë të vjetra ose më të lira. Për shembull, Komuna e Vushtrrisë ka marrë kompjuterë të përdorur dhe të vjetër nga një furnizues e cila ishte një shkelje e qartë të kontratës;
- Blerja e punëve ose shërbimeve me çmime më të larta se vlera e tregut, në disa raste shumë më shtrenjtë, për shkak të mungesës së një sistemi efikas të vlerësimit të ofertave financiare të kompanive, Komuna e Pejës bleu dru për ngrohje me çmim prej 48 Euro për metër kub, në krahasim me 38 euro që Komuna kishte paguar një vit më parë;
- Përshtatja e kriterëve dhe termave dhe kushteve të dosjes së tenderit për një markë ose prodhues të caktuar. Komuna e Gjilanit kopjoi katalogun e një kompanie në dosjen e tenderit;
- Kriteret e dosjes së tenderit të cilat janë të pamatshme dhe të pakuantifikueshme. Komuna e Gjilanit kërkoi karrige me cilësi të lartë, pa përcaktuar ndonjë standard apo metodë vlerësimi. Rastet si kjo lënë të gjithë fuqinë në duart e komisionit vlerësues për të vendosur se çfarë konsiderohet cilësi e lartë dhe çfarë nuk është.
- Kritere në dosje të tenderit për produkte joekzistuese, veçanërisht në teknologjinë e informacionit. Komuna e Prishtinës ka kërkuar kompjuterë me karakteristika që nuk ekzistojnë në treg;
- Përdorimi i standardeve të cilësisë së vendeve të tjera, në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, madje edhe në rastet kur ka standarde të BE-së për të njëjtën çështje.

HYRJE

Rritja e efikasitetit dhe transparencës së sistemit të prokurimit publik është një shqetësim i vazhdueshëm i shoqërisë kosovare dhe komunitetit ndërkombëtar në Kosovë. Për këtë qëllim, në vazhdimësi në Kosovë janë zbatuar projekte të ndryshme të cilat kanë pasur për qëllim përmirësimin e legjislacionit dhe praktikave për prokurim publik. Përkundër kësaj, prokurimi publik në Kosovë mbetet si një sektor me shumë dyshime për korrupsion, mos efikasitet dhe kualitet të dobët të shërbimeve për qytetarët.

Demokrasi Plus në kuadër të bashkëpunimit me Projektin e USAID për Komuna Transparente, Efikase dhe Llogaridhënëse (TEAM), ka ndërmarrë iniciativën e monitorimit të pesë komunave, duke përfshirë Prishtinën, Gjilanin, Pejën, Gjakovën dhe Vushtrrinë. Ky monitorim është i fokusuar në dy komponentë kryesore:

- Monitorimin e aktiviteteve të prokurimit me qëllim të ekspozimit të shkeljeve të ligjit, humbjeve dhe dyshimeve për korrupsion, dhe;
- Identifikimin e praktikave të mira dhe promovimin e tyre për të ndarë përvojat e mira në menaxhimin e prokurimeve publike.

Për këtë qëllim D+ që nga shtatori 2017 e deri më tash, ka bërë një vlerësim bazë të këtyre komunave, një raport të matjes së praktikave të mira dhe tani publikon raportin e tretë, i cili ka të bëjë identifikim e shkeljeve në prokurim publik me të dhëna nga monitorimi i drejtëpërdrejtë.

Ky monitorim është realizuar duke u bazuar në metodologjinë e adaptuar nga D+ e cila ka përfshirë monitorime direkte të vlerësimit të ofertave, monitorim të dokumenteve të tenderëve dhe monitorim të zbatimit të kontratave përmes observimit të punëve në terren dhe kontrollit të dokumenteve mbi realizimin e kontratave. Të gjeturat e monitorimit paraprkishtë janë ndarë me komunat përkatëse, për të ofruar komentet e tyre, si mjet i validimit të të dhënave. Në disa nga të gjeturat e raportit D+ dhe komuna nuk kanë arritur të ndajnë një gjykim të përbashkët, dhe për këtë arsye janë prezantuar edhe të gjeturat e monitorimit edhe komentet e komunave.



KOMUNA E PRISHTINËS

Raporti i monitorimit për Komunën e Prishtinës nxjerr të dhëna në lidhje me shkelje të prokurimit publik të cilat përsëriten në pothuajse secilin tender. Në tenderët për rrugë ka kërkesa që të përdoren produkte nga ndonjë kompani e caktuar (brende apo marka tregtare specifike) pa shtuar edhe fjalën ekuivalent. Projektet e rrugëve edhe pse janë hartuar nga kompani e jashtme e kontraktuar, kanë në përshkrimin e tyre kërkesa që të përdoren standarde të shteteve të huaja, ndërkohë që për të njëjtat ka standarde ndërkombëtare të njohura si ISO. Sipas Ligjit të Prokurimit publik, standardet të cilat mund të përdoren në prokurim, janë standardet kosovare, evropiane dhe ndërkombëtare. Standardet e shteteve të tjera nuk janë të aplikueshme dhe sidomos jo në ato raste kur për të njëjtat ka standarde kosovare apo ndërkombëtare. Në të gjithë tenderët për rrugë, në përshkrimin e çmimeve ka gabime të shumta në llogaritjen e sasive, të cilat duhet të bëhen në bazë të dimensioneve të dhëna në përshkrimin teknik, i cili është pjesë e Dosjes së Tenderit (DT).

Në tenderin për furnizim me qumësht, kompania Abrazen (ish Devolli Group)¹ ka dhënë normë të gabuar të TVSH-së, e si rezultat komuna ka humbur rreth 36 mijë euro. Komunës për këtë vit kontrata i ka kushtuar edhe dukshëm më shtrenjtë sesa viteve paraprake pasi që në vitin 2017 kontrata është lidhur për 20 cent për njësi, në vitin 2016 me 15 cent e në vitin 2015, 10 cent për njësi. Nga viti 2015 çmimi i kontratës është dyfishuar për të njëjtin artikull nga i njëjti furnitor.

Në tenderin për furnizim me pajisje të teknologjisë informative, specifikat teknike kanë qenë shumë të ngarkuara e tenderi është anuluar tre herë pasi asnjë kompani nuk ka qenë e përgjegjshme. Në këto specifika është kërkuar një model i procesorit të kompjuterit që në treg nuk ekziston me ato specifika. Në të njëjtin tender, por për llot tjetër, kompania Europrinty ka ndryshuar vetë katalogun e prodhuesit dhe ka ndryshuar të dhënat, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me specifikat e kërkuara.

Në një tender për ndërtimin, sanimin dhe zgjerimin e disa rrugëve sekondare, konsorciumi i kompanive Bashkimi & Bageri ka ofruar me tender me çmim jo-normalisht të ulët. Komuna nuk ka analizuar çmimet e dhëna e si rezultat as nuk ka kërkuar sqarime nga ky konsorcium.

Në shumicën e tenderëve ka vonesa në publikimin e Njoftimit për Nënshkrim të Kontratës, që në bazë të ligjit duhet të bëhet brenda dy ditëve nga data e përgatitjes së njoftimit². Në disa tenderë Kushtet e Veçanta (KV) nuk janë plotësuar, ndërsa duhet të plotësohen në momentin që përgatitet Dosja e Tenderit. Në KV shënohen të dhënat rreth garancionit, mënyrës së furnizimit, koha kur do të fillojë zbatimi i kontratës, zgjidhja e mosmarrëveshjeve, etj. Këto të dhëna duhet të jenë në dispozicion të operatorëve ekonomik (OE) që të mund të përgatisin ofertat e tyre.

Qarkullimi financiar i kërkuar, në shumicën e tenderëve është në kufirin maksimal që e lejon ligji, që është sa dy herë vlera e parashikuar të tenderit, ndërsa 1.5 herë vlera e parashikuar kur kërkohet qarkullimi për punë, shërbim apo furnizim të ngjashëm. Kjo kërkesë edhe pse është brenda kufirit maksimal ligjor, mund të dëmtojë konkurrencën dhe veçanërisht e benë të pamundur konkurrimin e kompanive të reja të cilat kanë hyrë në treg, kompanive të vogla dhe atyre të mesme.

¹ Devolli Group e ka ndryshuar emrin në Abrazan LLC më 11 nëntor 2016.

² Ligji i Prokurimit Publik 05/L-068, Neni 41/A. (2016). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11332>

Furnizimi me qumësht për nxënësit e shkollave – niveli i ulët prej klasës së I–V

Buxheti i Komunës së Prishtinës si rezultat i mosverifikimit të normës së TVSH-së të dhënë nga kompania fituese Abrazen (ish Devolli Group) është dëmtuar për së paku 36,684.90 euro. Gjithashtu Abrazen e ka fatuar Komunën me çmim 19 cent pa TVSH për paketim 0.25 litra, ndërsa në ofertën e vet e ka çmimin 18 cent pa TVSH.

Ndryshimi i çmimit është në kundërshtim me nenin 4.1 dhe 4.3 të Kontratës ku thuhet që çmimet për njësi janë fikse dhe nuk do t'i nënshtrohen ndryshimeve. Në kontratat paraprake të nënshkruara me të njëjtën kompani në vitin 2015 çmimi ka qenë 10 cent për paketim 0.25 litra. Në vitin 2016 ishte 15 cent ndërsa më 2017 çmimi është rritur në 20 cent.

Abrazen ka rritur çmimin dyfish nga kontrata e vitit 2015 në atë të vitit 2017. Po të lidhej kontrata me çmim 10 cent, buxheti i komunës do të kursehej për 366,849 euro. Komuna në vitet 2016 dhe 2017 nuk e ka bërë parashikimin e vlerës së kontratës në përputhje me nenin 13.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (më tutje Udhëzuesi) ku është dashur që të kenë parasysh çmimet e kontratave paraprake. Komuna këtë e arsyeton me faktin se çmimet ndryshojnë gjatë viteve dhe se për këtë janë marr për bazë të dhënat e Agjencisë së Statistikave (ASK) dhe tregut. Sidoqoftë, të dhënat e ASK tregojnë që çmimi i qumështit për litër nga viti 2015 ka pësuar rënie për 0.03 euro³, përderisa komunës së Prishtinës ky çmim nga kontrata e vitit 2015 i është ngritur 100%.

Në bazë të të dhënave që gjenden në Njoftimin për Nënshkrim të Kontratës të vitit 2016⁴ dhe llogaritjes së bërë nga Demokraci Plus (D+), çmimi për njësi është 4 cent e jo 15 cent siç është në kontratë. Kjo pasi që shikuar nga Njoftimi për Kontratë për tenderin e vitit 2016, është parashikuar të blihen 407,610 njësi nga 0.25 litër qumësht për muaj (*12 muaj) me vlerë të kontratës së parashikuar 200,000 euro.

II.1.11) Vlera e parashikuar e kontratës: 200,000.00

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen) - **Numri i nxënësve është gjithsej: 19,410, që për 21 ditë furnizime do të thotë gjithsej duhen 407,610 copë nga 0.25l për një muaj.**

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj **12 apo ditë 365** (nga data e kërkesës së zyrtareve të Autoritetit kontraktues)

FOTOGRAFIA 1

Parashikimi i sasisë dhe vlerës së kontratës për furnizim me qumësht

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit 2002-2017, faqe 59-61.

<http://ask.rks-gov.net/media/4081/ihck-2002-2017-shqip.pdf>

⁴ Njoftimi për nënshkrim të kontratës për tenderin "Furnizim me qumësht për nxënësit e shkollave – niveli i ulët prej klasës së I-V i publikuar më 6 Dhjetor 2016. <https://krpp.rks-gov.net/DownloadNotice.aspx?ID=133049&LID=1>

Tenderi i vitit 2017 për furnizim me qumësht për nxënësit e shkollave ishte shpallur dy herë. Vlera e parashikuar e kontratës është 730,000 euro. Procedura e përdorur ishte procedurë e hapur dhe kontratë kornizë për 12 muaj. Janë kërkuar 3,668,490 paketime qumështi nga 0.25 litra. Ky tender ka kufizuar në disa elemente konkurrencën. Së pari kushtet e dosjes së tenderit kanë kërkuar që qumështi të jetë i llojit Ultra High Temperature (UHT)⁵.

Këtë kriter nga 13 prodhues të qumështit në Kosovë e plotëson vetëm kompania Vita. Sipas këtij kushti, të drejtë të aplikimit kanë pasur Vita dhe ndonjë kompani e importit. Po ashtu afati i dorëzimit të ofertave ka qenë i shkurtuar, gjë e cila po ashtu ndikon në uljen e numrit të ofertave.

Në Dosjen e Tenderit (DT) është kërkuar që paketimi të jetë nga Tetra Pak. Kjo kërkesë e kufizon konkurrencën pasi ka shumë kompani tjera që ofrojnë paketime alternative. Për këtë komuna ka arsyetuar se nuk ka paketime të tjera 0.25 litër. Mirëpo, edhe nëse kjo është e vërtetë, prapëseprapë nuk është dashur të ceket një markë e një prodhuesi.

Në tenderin e parë nuk ka ofertuar asnjë kompani edhe pse në listën e kompanive të licencuara për përpunim të qumështit nga Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit i Kosovës (AVUK) janë 49 kompani. Si rezultat i kësaj Komuna ka dështuar në aktivitetin e parë të prokurimit, për shkak të mungesës së ofertave për tender.

Gjithashtu në DT, është kërkuar qarkullim financiar për projekte të ngjashme në vlerë 700,000 euro për tri vitet e fundit. Ndërsa në tenderët e dy viteve paraprake kjo kërkesë ishte për 200,000 euro. Rritja e kësaj kërkesë për 3.5 herë pa ndonjë arsye e kufizon konkurrencën edhe më tej, pasi në tenderin e vitit 2016 kishte ofertuar vetëm Devolli Group e në atë të vitit 2015 katër kompani përfshirë Devolli Group. Komuna arsyetonte se në vitin 2016 kjo ishte gabim teknik.

Arsyeja pse ka shumë pak oferta në këto dy vite është që Komuna me një buxhet shumë të vogël ka synuar të blejë një sasi të madhe të qumështit. Kjo vërtetohet nga tenderi i vitit 2016 ku vlera e parashikuar ka qenë 200,000 euro për 12 muaj ndërsa janë kërkuar rreth 4.9 milionë paketime nga 0.25 litra apo rreth 1.2 milionë litra. Çmimi i parashikuar për një paketim ka qenë 4 cent. Këtë çmim asnjë kompani nuk mund ta arrijë duke marrë parasysh koston e prodhimit, taksat, pagat e punëtorëve, etj.

Në tenderin e dytë ka ofertuar Abrazen e cila fitoi tenderin me çmim 733,698 euro. Oferta e ka tejkaluar vlerën e parashi-kuar, por në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP), autoritetit kontraktues (AK) i lejohet që të vendosë a të pranojë apo jo tejkalimin e vlerës së parashikuar⁶. Afati për dorëzim të ofertave ishte shkurtuar me arsyen që kontrata ekzistuese është në përfundim. Mirëpo shkurtimi i afateve në një kontratë me vlerë të tillë zvogëlon dukshëm konkurrencën. Alternativë e kësaj do të duhej të ishte iniciimi me kohë i aktivitetit të prokurimit dhe hartimi i dosjes së tenderit me kushte më të favorshme për prodhuesit. Edhe pse është përdorur procedura e përsheptuar vlerësimi i ofertës së vetme ka zgjatur 41 ditë, që tejkalon afatin ligjor normal prej 30 ditëve. LPP i lejon AK-të, në këtë rast komunën që në raste të jashtëzakonshme kur kontratat janë komplekse afati i shqyrtimit të ofertës të zgjatet për 10 ditë më shumë, e që në këtë rast përsëri do ta tejkalonte afatin ligjor. Në këtë rast ka patur vetëm një ofertë dhe objekti i kontratës ka qenë relativisht i thjeshtë. Nënshkrimi i kontratës është bërë më 11 janar 2018 dhe publikimi i njoftimit është dashur që të bëhet brenda dy ditëve, por është publikuar më 23 janar 2018.

Abrazen ka ofertuar me çmim prej 20 cent me TVSH. Mirëpo tek çmimi pa TVSH ka ofertuar me 18 cent. Kjo paraqet një gabim në llogaritje të TVSH-së, pasi që TVSH në qumësht është 8%. Komuna në këtë rast është dashur që në rregullim të çmimit me TVSH të ul çmimin në 0.1944 euro. Edhe nëse komuna do të bënte rrumbullakimin e çmimit, e që diçka e tillë nuk duhet të bëhet në tatime, prapëseprapë çmimi do të duhej të ishte 0.19 e jo 0.20 euro. Për më tepër në Udhëzues thuhet që çmimi duhet të ketë vetëm dy numra pas pikës dhjetore, ndërsa çdo numër i shënuar pas numrit të dytë nuk do të merret parasysh⁷. Në këtë rast çmimi do të duhej të ishte 0.19 euro. Me këtë çmim komuna do të kursente edhe më

5 Qumështi UHT është qumështi që ngrohet në 135 gradë për një deri dy sekonda në mënyrë që të eliminohen bakteriet.

Ky qumësht ka afat më të gjatë të skadimit se qumështi jo-UHT.

6 Ligji i Prokurimit Publik 05/L-068, Neni 62.2. (2016). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11332>

7 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 18.3 (2017).
<http://rebrand.lv/rroopp>

shumë buxhetin, më saktë 36,684.9 euro⁸. Në formën se si është llogaritur çmimi me TVSH, Komuna e Prishtinës në vend se të ngarkohet me 8% TVSH, në fakt është ngarkuar me 11.11%. Komuna e ka pranuar këtë gabim dhe është zotuar se do të ndryshojë kontratën për të bërë rregullimin e çmimit dhe rimbursimin e Komunës.

Një e gjetur tjetër është kohëzgjatja e Sigurisë së Ekzekutimit të tenderit e cila në bazë së Dosjes së Tenderit është dashur të jetë valide për 13 muaj. Siguria e Ekzekutimit është dashur të fillojë nga 11 janari 2018, por është prej datës 4 shkurt 2019 deri 10 shkurt 2019. Pra në vend të sigurimit prej 13 muaj, kompania ka ofruar siguri të ekzekutimit për vetëm 7 ditë. Zyrtarët e prokurimit është dashur ta shikojnë para se ta nënshkruajnë kontratën. Komuna e Prishtinës e konteston këtë të gjetur, duke thënë se data e lëshimit të polisës së sigurimit është 11.01.2018. Mirëpo, data e lëshimit nuk është edhe data e hyrjes së saj në fuqi. Në polisë shkruan qartë se data e hyrjes në fuqi është data 04.02.2019.

NUMRI PERSONAL IDENTIFIKUES	1003685116	ADRESA E DREJTORISE SIGURUESI	Rr. "2 Komku", nr. 4, Prishtinë, 10000
SIGURIMIGARANCIA FILLON ME:	04.02.2019	PRIMI I SIGURIMIT	8.47 €
SIGURIMIGARANCIA PËRFUNDON ME:	10.02.2019	TATIMI I VLERËS SË SHITUAR 18%	1.53 €
SHUMA E SIGURUAR	73,369.80	€ SHUMA PËR PAGESË	10.00 €
DATA E LËSHIMIT TË POLISËS	11.01.2018	DATA E PAGESËS	11.01.2018
PËRFITUESIAUTORITETI KONTRAKTUES	KOMUNA E PRISHTINES		

Mungesa e validitetit të sigurisë së tenderit ekspozon komunën para situatës që në rast të shkeljeve serioze nga kompania, të mos mund të mbrojë interesin e saj prej prej 73,369.80 euro. Kompania e sigurimit me të drejtë nuk do të bënte ekzekutimin e kurrfarë pagese për këtë çështje.

Përshkrimi i çmimeve është bërë në Word, ndërsa është dashur të bëhet në Excel dhe të përgatitet me formulë, duke mbrojtur me fjalëkalim qelitë ku nuk mund të shkruhet. Është dashur të lejohet vetëm një kolonë për tu plotësuar nga tenderuesi, çmimi me TVSH për njësi, ndërsa totali do të llogaritet nga formula. Kjo metodë ia pamundëson OE që të vendosë vet normën e TVSH-së dhe do të zvogëlonte keqpërdorimet dhe mashtrimet. Komuna nuk pranon këtë gjetje me arsyetimin se asnjë dispozitë ligjore nuk e përcakton këtë kërkesë. D+ nuk pretendon në asnjë formë se kjo është kërkesë ligjore, por e njëjta është praktikë e mirë e cila përdoret në komuna të tjera⁹ dhe po ta bënte edhe Prishtina, ky gabim me TVSH do të ishte i pamundur të ndodhte.

Komuna përveç që ka dëmtuar buxhetin si pasojë e mos verifikimit të normës së TVSH-së të dhënë nga Abrazen, ka lidhur edhe kontratë me çmim më të lartë se kontratat paraprake me kompaninë e njëjtë. Komuna thotë se ajo i lidh kontratat me çmimin e tregut dhe nuk merr për bazë çmimin e kontratës paraprake dhe se në bazë të Ligjit, askund nuk kërkohet referenca në kontratat paraprake. D+ nuk konteston faktin se Ligji i lejon asaj të blejë furnizime me çmimin e tregut, përkundrazi e inkurajon një gjë të tillë. Mirëpo përderisa dy vite më herët çmimi ka qenë 0.10 euro dhe tani është ngritur në 0.20, pa ndryshuar vlera e qumështit në treg (vetëm sa është liruar për 0.03 euro) komuna ose atëherë ose tani ka lidhur një kontratë në kundërshtim me vlerën reale të tregut. Gjithashtu D+ inkurajon komunën që specifikacionet teknike të mos i përshtat për një numër të kufizuar të kompanive, por të lejohet konkurrencë më të madhe.

Për më tepër, në këtë tender, në komisionin për vlerësimin e tenderëve, anëtare e komisionit ka qenë një zyrtar e lartë për media, që për këtë tender nuk paraqet përgatitje adekuate në mes punës së saj dhe furnizimit të kërkuar.

⁸ Abrazen ka ofruar me çmim 0.20€ për paketim. Vlera pa TVSH është 0.18€, dhe TVSH 0.02€. Norma e TVSH për qumësht është 8%. Po të pjesëtojmë 0.20 / 1.08 = 0.1851. Në bazë të LPP duhet të merren vetëm dy numra pas pikës dhjetore. Atëherë duhet të gjejmë vetëm TVSH e cila llogaritet kështu: 108/8 = 13.5, 0.20 / 13.5 = 0.0148. Pasi duhet t'i marrim vetëm 2 numra atëherë 0.18+0.01 = 0.19€ do të duhej të ishte çmimi i ofruar. Kjo vërtetohet edhe nga llogaritja e çmimi pa TVSH shumëzuar me normën e TVSH-së, 0.18 * 1.08 = 0.1944, me vetëm 2 numra është 0.19€. Sasia e kërkuar kur shumëzohet me çmimin e vërtetë. 3,668,490 * 0.19 = 697,013.1. Diferenca është 733,698 - 697,013.1 = 36,684.9 euro.

⁹ Nga monitorimi i pesë komunave, është vërejtur se Komuna e Vushtrrisë në disa raste e përdorë një praktikë të mbrojtjes së celulave në Excel e cila i pamundëson operatorëve që të bëjnë disa ndryshime, dhe e cila në praktikë e bënë më të lehtë procesin e vlerësimit.

ZBATIMI I KONTRATËS

Në ofertë Abrazen kishte dhënë çmim 18 cent pa TVSH dhe 20 cent me TVSH. Por në fatura, çmimi është ndryshuar në 19 cent pa TVSH, dhe është rumbullakuar në 20 cent me TVSH. Ndryshimi i çmimit nuk lejohet sipas kontratës¹⁰ dhe është bazë e mjaftueshme që kontrata të shkëputet.

Kontrata është nënshkruar më 11 janar 2018. Të gjitha kërkesat, zotimet dhe urdhërblertjet janë bërë për rreth dy deri në tre muaj më vonë se faturat e pranuar. Komuna për këtë çështje fajëson sistemin e pagesave të Ministrisë së Financave Free Balance. Mirëpo, kjo e gjetur tregon se së pari komuna është furnizuar me qumësht, kompania e ka distribuuar atë, dhe pas disa muajsh është porositur malli. Një gjë e tillë nuk ka asnjëkuptim të ndodhë.

Së pari bëhet kërkesa për blerje dhe zotimi i mjeteve. Pas kësaj lëshohet urdhërblertje për OE, ku porositet puna, furnizimi dhe shërbimi. Pas urdhërblertjes, kompania fillon zbatimin e kontratës, ku pasi zbaton një pjesë të kontratës, bëhet pranimi teknik i punëve të kryera. Pas kësaj kompania dërgon faturën, të cilën komuna e paguan. Sipas Rregullës Financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike (Rregulla Financiare), neni 22 thotë që së pari duhet të bëhet kërkesa për blerje, pastaj urdhërblertja, hapi i tretë është raporti i pranimi të punëve të kryera dhe në hapin e katërt është pranimi i faturës¹¹. Pas pranimi të faturës mund të bëhet pagesa. Në këtë rast faturat e muajit janar dhe shkurt janë paguar në muajin prill. Këto vonesa tejkalojnë afatin ligjor prej 30 ditëve.¹² Si rezultat komuna rrezikon që të penalizohet për vonesë të pagesave.

● Ndërtimi i disa rrugëve në fshatin Trudë

Në këtë tender, si rezultat i dimensioneve të dhëna gabim në paramasë, të cilat nuk përputhen me të dhënat që janë në përshkrimin teknik të rrugëve¹³, komuna ka humbur së paku 16,767.78 euro.

Për këtë tender është përdorur procedura e hapur, vlera e parashikuar ka qenë 499,794.05 euro me afat për kryerjen e punëve 120 ditë. Në këtë aktivitet kanë ofertuar 18 kompani, nga të cilët 14 ishin të përgjegjshme dhe katër të papërgjegjshme. Fitues i kësaj kontrate është zgjedhur kompania Pro & Co Group me çmim prej 375,501.30 euro.

Në Dosjen e Tenderit ka kërkesa për aplikimin e standardeve gjermane DIN¹⁴, ndërsa sipas LPP vetëm standardet e Kosovës dhe/ose të organizatave ndërkombëtare si ISO standardet, standardet EN të Bashkimit Evropian (BE), do të duhej të aplikoheshin në këtë tender¹⁵. Zbatimi i standardeve nacionale (të një vendi tjetër) dëmton konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik në garën për tender, apo nëse mbetet i pa zbatuar për shkak të mungesës së njohurive të kompanive, kjo mbetet vetëm standard në letër i cili nuk prodhon efekt. Komuna arsyetohet se projektimi është bërë nga kompania private e kontraktuar në vitin 2010 dhe se standardet janë paraparë në përputhje me Ligjin për Standardizim. Mirëpo, në këtë rast kemi të bëjmë me zbatimin e Ligjit të Prokurimit Publik dhe i njëjti shprehimisht ka përcaktuar se cila standarde mund të aplikohen në Kosovë. Në vitin 2010 kur ky projekt është hartuar ka mundur të ketë qenë e lejuar të përdoren standardet e vendeve të caktuara.

Gjatësia e rrugës kryesore është 870m dhe gjerësia 5.5m e cila ka sipërfaqe $870 * 5.5 = 4785 \text{ m}^2$, ndërsa me bankina dhe trotuar është $870 * 8.5 = 7395 \text{ m}^2$. Rruga kryesore do të shtrohet me asfalt, ndërsa rrugët tjera me kubëza betoni. Në shumë pozicione të paramasa Komuna ka dhënë dimensione të gabuara të cilat nuk përputhen me dimensionet e dhëna në paramasë dhe përshkrimin teknik. Disa nga pozicionet ku ka dallim të madh në sasi janë në tabelën e mëposhtme:

¹⁰ Neni 4.1 dhe 4.3 i Kontratës në mes Abrazen dhe Komunës së Prishtinës.

¹¹ Rregull Financiare Nr. 01/2013/MF – Shpenzimi i parave publike. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10203>

¹² Neni 18.2 i Kushteve të Përgjithshme të Dosjes së Tenderit për Furnizim. Formulari B27 i KRPP-së.

<https://rebrand.ly/b27>

¹³ Përshkrimi Teknik është një përshkrim i detajuar i rrugës ku tregohen të dhënat për rrugën që do të ndërtohet siç janë dimensionet, koordinatat, vizatimet e detajuara, profilet, etj.

¹⁴ DIN është shkurtesë për Deutsches Institut für Normung, apo në Shqip Instituti Gjerman i Standardeve.

¹⁵ Ligji i Prokurimit Publik 04/L-042, Neni 28.4, 28.5. (2011). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

PËR SHKAK TË DYSHIMEVE PËR ÇMIME JO-NORMALISHT TË ULËTA, KOMPANISË I ËSHTË RRRITUR SIGURIA E EKZEKUTIMIT

nga 10% në 30%

Sipas projektit rrugët kanë këto dimensione:

Gjerësia: 5.5m

Trotuari 1.5m

Bankinat 2*0.75m

Gjerësia totale 10m

Traseja e rrugës sipas projektit ka këtë përmbajtje:

Asfaltbeton 0-16 4cm


Zhavor 0-32 10cm

Shtresa stabilizuese 0-150 30cm

Bituzhavor 0-31 8cm

Zhavor 0-63 20cm

Totali 72cm trashësi



Rruga Kryesore

Pozicioni në listën e çmimeve	Përshkrimi	Sasia e dhënë	Sasia që duhet	Çmimi i ofruar	Çmimi i ri sipas sasisë që duhet
2.1	Gërmimi i gjerë i dheut, pozicioni përfshinë edhe ngarkimin dhe bartjen në deponin e qytetit në Shkabaj.	11,626 m ³	7395 * 0.72 = 5324.4 m ³ Për të arritur sasinë e dhënë duhet gërmim prej 11626 / 7395 = 1.57m	€ 9,300.80	€ 4,259.52
4.1	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-150mm si stabilizues ne dy shtresa me ngjeshje me trashësi t=30cm, me CBR>20%	3360 m ³	7395 * 0.3 = 2218.5 m ³	€ 10,080.00	€ 6,655.50
4.2	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=20cm	1570 m ³	7395 * 0.2 = 1479 m ³	€ 6,280.00	€ 5,916.00
4.3	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-32mm me trashësi t=10cm	785 m ³	7395 * 0.1 = 739.5 m ³	€ 3,925.00	€ 3,697.50
4.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e bituagregatit 0-31mm me trashësi t=8cm.	5360 m ²	870 * 5.5 = 4785 m ² Për të arritur sasinë e dhënë duhet të shtrohet asfalti 5360 / 870 = 6.16m gjerësi	€ 39,128.00	€ 34,930.50
4.5	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltbetonit 0-16 mm me trashësi t=4cm.	5360 m ²	870 * 5.5 = 4785 m ² Për të arritur sasinë e dhënë duhet të shtrohet asfalti 5360 / 870 = 6.16m gjerësi	€ 22,512.00	€ 20,097.00

Rruga “Beteja e Lumes”

4.1	Punimi i tamponit (60MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=20cm	528 m ³	2240 * 0.2 = 448 m ³	€ 2,112.00	€ 1,792.00
-----	---	--------------------	---------------------------------	------------	------------

4.2	Punimi i tamponit (60MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=10cm	264 m ³	2240 * 0.1 = 224 m ³	€ 1,320.00	€ 1,120.00
Ndërtimi i pesë rrugicave krah rrugës Sanxhaku i Nishit					
3.2	Formësimi dhe ngjeshja e nenbazes së trupit të rruges me ngjeshmeri 30MN/m ²	4200 m ²	840 * 4.5 = 3780 m ²	€ 410.00	€ 378.00
4.1	Punimi i tamponit (60MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=20cm	840 m ³	3780 * 0.2 = 756 m ³	€ 3,360.00	€ 3,024.00
4.2	Punimi i tamponit (60MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=10cm	420 m ³	3780 * 0.1 = 378 m ³	€ 2,100.00	€ 1,890.00
Totali				€ 100,527.80	€ 83,760.02
Diferenca				€ 16,767.78	

TABELA 1. Pozicionet e analizuar të cilat kanë patur pasaktësi në paramasën për ndërtimin e rrugëve në Trudë

Si rezultat i sasive të dhëna gabim, buxheti i Komunës është dëmtuar për së paku 16,767.78 euro. Komuna për këtë çështje thotë se planifikimi dhe projektimi janë bërë nga kompania Proart në vitin 2010. Sidoqoftë, D+ nuk ka vërejtje në lidhje me projektin dhe përshkrimin teknik, por me paramasën e dosjes së tenderit, e cila ka qenë në kompetencë të komunës dhe jo kompanisë projektuese.

Në paramasë janë edhe disa rrugë tjera, të cilat në bazë të dimensioneve të dhëna, llogaritja e sasive është bërë pa gabime.

Në pikën 3.1 për rrugën "Xhemush Kamberi" për pikën gërmimi i dheut i kategorisë së II- IV-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi max. 15km (në çmim është dashur të parashihet edhe demolimi i asfaltit ekzistues, kubëzave dhe skajoreve me ngarkim dhe bartje deri në deponi) Pro & Co Group ka ofruar me çmim 0.80 euro për m³. Në manualin me çmime referente të publikuar në faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), i cili shërben si orientim për autoritetet, për të njëjtën punë çmimet janë 3.4 deri 4.5 euro.

Në të gjithat pikat për furnizimin, bartjen dhe vendosjen e kubëzave me trashësi 8 cm në shtresë rëre me trashësi 5 cm kompania ka ofruar çmim 7 euro m², ndërsa nga lista e KRPP-së çmimi është 13.73 euro¹⁶. Ndërsa çmimi në treg është përafërsisht 14 euro.

Sipas Njoftimit për Kontratë afati për përfundimin e punëve është 120 ditë, ndërsa në Kontratë është 90 ditë.

¹⁶ Lista e çmimeve për njësi mesatare referent për punë ndërtimore dhe materiale ndërtimore, PN0068 (2015). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. <https://rebrand.ly/krpp>

● Ndërtimi i rrugëve në lagjen Myrtaj, Bekaj, Bahtirovit dhe Nezirovit në fshatin Busi si dhe Ndërtimi i rrugës dhe trotuareve në fshatin Drenovc

Edhe në këtë tender si rezultat i sasive të dhëna gabim në paramasë buxheti i komunës është dëmtuar për së paku 13,107.50 €.

Ky tender ka qenë i ndarë në dy (2) lloje, procedurë e hapur me afat kohor prej 90 ditësh për përfundimin e punëve. Vlera e parashikuar e kontratës ka qenë 993,080.26 euro. Fitues për llot 1 është shpallur Papenburg & Adriani Company me ofertë prej 347,880.30, ndërsa për llot 2 fitues është Erdi Group & El-Bau me çmim 367,972.12 euro. Kontrata për të dy llotet është nënshkruar më 22 shkurt 2018, por përgatitja e Njoftimit për Nënshkrimin e Kontratës është bërë më 1 mars 2018, ndërsa është dashur të bëhet brenda dy ditëve nga nënshkrimi.

Edhe në këtë tender në përshkrimin teknik ka kërkesa për standarde gjermane DIN, standard serb JUS U.N2.060¹⁷ i cili deri më tani ka skaduar në vitin 2016¹⁸. Si edhe në tenderët e tjerë kjo konsiderohet e paligjshme, pasi që përveç standardeve kosovare në prokurim publik mund të përdoren standardet evropiane apo ndërkombëtare. Për llotin 1 nuk është ofruar përshkrimi teknik së bashku me dosjen e tenderit, gjë që nënkupton se nuk ka projekt të detajuar, në të cilin përfshihen vizatimet se si do të duket rruga, përmbajtja e trasesë dhe koordinatat e rrugës.

Komuna ka kërkuar sqarime për dyshime për çmime jo-normalisht të ulëta të dy kompanive, për pozicionet 2.4, 3.1 dhe 3.3 të paramasës (për këto pozicione shih tabelën e mëposhtme). Të dy kompanitë janë përgjegjës me sqarimet e tyre se si kanë arritur deri te çmimi i dhënë. Komuna ka kërkuar që siguria e ekzekutimit të rritet nga 10% në 30% si shkak i këtyre dyshimeve. Ky sigurim i ekzekutimit të kontratës është një lloj garancioni se në rast të moszbatimit të kontratës kjo shumë i konfiskohet kompanive të cilat nuk kanë performuar.

Pasi për llotin 1 nuk ekziston përshkrimi teknik, gjerësinë e rrugës përfshirë bankinat dhe trotuarin e nxjerrim nga pika **2.2** që është për gërryerjen, planifikimin dhe rrafshimin e nënbazës me sipërfaqe **24059 M²** dhe gjatësinë e rrugës **2830.48M**.

$$24059 / 2830.48 = 8.5M$$

Nga pika **3.3** që është shtrimin me asfaltbeton sasia është dhënë **14750 M²**.

Nga ky numër e nxjerrim gjerësinë e shtrimit të asfaltit.

$$14750 / 2830.48 = 5.21M$$

Zakonisht gjerësia e shtrimit është me numra që përfundojnë

me **0** ose **5**, psh. **5M**, **5.5M**, etj.

¹⁷ Standard i Serbisë për prodhimin e pjesëve të fabrikua të betonit.

http://www.iss.rs/en/standard/?natstandard_document_id=12091

¹⁸ SRPS U.N2.060:1990, Institute for Standardization of Serbia.

http://www.iss.rs/en/standard/?natstandard_document_id=12091

Në të gjitha rrugët që do të shtrohen brenda fshatit Busi, në pikën 2.4 të paramasës, Komuna ka dhënë dimensione të gabuara të cilat nuk përputhen me dimensionet e dhëna në paramasë, përkatësisht me pikën 2.2. Këto mospërputhje mund të jenë gabime të projektuesve, mirëpo po ashtu mund të jenë lëshime për t'iu dhënë përparësi kompanive të cilat i dinë këto mangësi të projektit dhe ofertojnë me çmime shumë të ulëta për të fituar kontratën. Disa nga pozicionet ku ka dallim të madh në sasi janë në tabelën e mëposhtme:

Rruga e Lagjes Myrtaj në Busi, Aksi kryesor

Pozicioni në paramasë	Përshkrimi	Sasia e dhënë	Sasia që duhet	Çmimi i ofruar	Çmimi i ri sipas sasisë që duhet
2.4	Furnizimi, transporti, punimi i materialit mbushës guror jokoherent me CBR>20% , shtrirje dhe ngjeshja në shtresa jo më të mdha se 30cm deri në modulën e ngjeshmërisë 45MN/m ²	16922.64 m ³	2830.48 * 8.5 * 0.3 = 7217.72 m ³	€ 33,845.28	€ 14,435.44
3.1	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit (65MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror, 0-60mm me trashësi t=20cm	5186 m ³	24059 * 0.2 = 4811.8	€ 25,930.00	€ 24,059.00
3.2	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit (80MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror, 0-31mm me trashësi t=10cm	2047.2 m ³	24059 * 0.1 = 2405.9	€ 14,330.00	€ 16,841.30

Rruga e Lagjes Bahtirovit në Busi

2.4	Furnizimi, transporti, punimi i materialit mbushës guror jokoherent me CBR>20% , shtrirje dhe ngjeshja në shtresa jo më të mdha se 30cm deri në modulën e ngjeshmërisë 45MN/m ²	5287.05 m ³	7454.5 * 0.3 = 2236.35 m ³	€ 10,574.10	€ 4,472.70
-----	--	------------------------	---------------------------------------	-------------	------------

Rruga e Lagjes Nezirovit në Busi, Aksi 2

2.4	Furnizimi, transporti, punimi i materialit mbushës guror jokoherent me CBR>20% , shtrirje dhe ngjeshja në shtresa jo më të mdha se 30cm deri në modulën e ngjeshmërisë 45MN/m ²	2620 m ³	5355 * 0.3 = 1606.5 m ³	€ 5,240.00	€ 3,213.00
-----	--	---------------------	------------------------------------	------------	------------

Rruga e Lagjes Bekaj në Busi, Aksi 3 dhe 4

2.4	Furnizimi, transporti, punimi i materialit mbushes guror jokoherent me CBR>20% , shtrirje dhe ngjeshja në shtresa jo më të mdha se 30cm deri në modulën e ngjeshmërisë 45MN/m ²	1305 m ³	2025 * 0.3 = 607.5	€ 2,610.00	€ 1,215.00
Totali				€ 92,529.38	€ 64,236.44
Diferenca				€ 28,292.94	

TABELA 2. Pozicionet e analizuarat të cilat kanë patur pasaktësi në paramasën për ndërtimin e rrugëve në Busi

Si rezultat i sasive të gabuara, kryesisht të pika 2.4¹⁹ buxheti i Komunës është dëmtuar për së paku 28,292.94 euro. Këto lëshime të projektuesve duket se janë vërejtur dhe shfrytëzuar nga kompania Papenburg & Adriani Company dhe ka ofruar me çmim dy euro, i cili sipas konsultimeve që D+ ka bërë me kompani të ndërtimit, na ka dalur të jetë çmimi i kostos që kompania ka për të kryer këtë punë. Në tenderin për rrugët në Trudë për këtë pikë çmimi i ofruar ishte tre euro, nga kompania tjetër që kishte fituar këtë tender. Në këtë kontratë po të ishin sasitë e sakta, kompania nuk do të ofertonte me çmimin prej dy euro.

Sipas komunës të gjeturat në lidhje me këtë tender nuk janë të sakta, pasi që bëhet fjalë për trashësi të rrugës e cila nuk është konstante dhe se në këtë projekt përfshihet edhe zgjerimi i rrugës ekzistuese. Për më tepër në këtë pozicion janë përfshirë edhe zgjerimet, rrugët lidhëse dhe kthesat. Sidoqoftë, D+ ndanë mendim të kundërt me komunën për këtë çështje, pasi që dallimi në këtë pozicion është i dyfishtë dhe ofertimi i kompanive me çmime jo normalisht të ulëta e vërteton këtë pretendim të D+ se pozicioni ishte i mbillogaritur.

¹⁹ Furnizimi, transporti, punimi i materialit mbushës guror jokoherent me CBR>20% , shtrirje dhe ngjeshja në shtresa jo më të mëdha se 30cm deri në modulën e ngjeshmërisë 45MN/m².

LLOTI 2 ËSHTË PËR NDËRTIMIN E DISA RRUGËVE DHE TROTUAREVE NË FSHATIN DRENOC. PËR KËTË LLOT SË BASHKU ME DT ËSHTË OFRUAR EDHE PËRSHKRIMI TEKNIK I RRUGËS, NGA EDHE KU JANË LLOGARITUR DIMENSIONET. SIPAS PROJEKTIT KËTO JANË TË DHËNAT E RRUGËS:

Gjerësia: — 5.5m rruga kryesore,
— 5m aksi Majtas dhe te Gjafollt,
— 4m aksi te Varrezat

Trotuaret: 1.5m

Bankina: 1m

Totali: — 8m rruga kryesore,
— 7.5m rrugët tjera.

Ndërsa rruga do të përbëhet nga:

Asfaltbeton 4cm
AB011

Tampon prej gurit gëlqeror 0-31.5 – 10cm

Material mbushës me CBR> 20% - 30cm

Shtresa Bituzhavorrit BZH022 8cm

Tampon prej gurit gëlqeror 0-60 – 25cm

Totali 77cm trashësi



Në paramasën për rrugën kryesore, pika 2.1 që është për gërmimin e dheut të kategorisë së III dhe IV, si dhe ngarkimi dhe bartja deri në deponi sasia e dhënë është 4145 m³. Gjatësia e rrugës është 1044.26m. Sipërfaqja e rrugës 1044.26 * 8 = 8354.08 m². Thellësia për t'u gërmuar është 4145 / 8354.08 = 0.496m. Pasi përbërja e rrugës është 77cm dhe sipas projektit është tentuar që të ruhet niveli vertikal i rrugës, D+ dyshon që disa pjesë të përbërjes do të shtrohen me trashësi më të vogël ose nëse shtrohet 77cm, niveli i rrugës do të ngritët për 77 – 49.6 = 27.4cm.

Te pika 2.2 për gërryerjen, rrafshimin e nënbazës dhe ngjeshjen sasia është dhënë 7875 m², ndërsa duhet të jetë 8354.08 m².

Në pikën 3.3 që është për shtrimin e trotuarit për të gjitha rrugët, sasia është dhënë me m² në vend që të përdoret m³, pasi ka të bëjë me furnizimin, bartjen, shtrirjen dhe ngjeshjen e rërës së imët me trashësi 5cm. Pra përveç sipërfaqes është dhënë edhe trashësia, e në këtë rast janë tri dimensione dhe duhet të përdoret matja me metër kub.

Në rrugën kryesore pika 3.5 për furnizimin dhe punimin e bitu zhavorrit sasia është 2553 m², ndërsa pika 3.6 që është për furnizimin edhe punimin e asfaltbetonit ka sasi 5952 m². Këto dy pika duhet të kenë sasi të njëjta, pasi bëhet fjalë për shtresën e parë dhe të dytë të asfaltit. Këtu sasia duhej të ishte:

$$1044.26\text{m gjatësia e rrugës} * 5.5\text{m gjerësia e asfaltit} = 5743.43\text{ m}^2$$

Në rrugën Aksi majtas pikat për bitu zhavorr dhe asfaltbeton nuk kanë sasi të njëjtë, përkatësisht 738 dhe 3625 m², ndërsa duhet të jetë 3625 m² në të dyja.

Në tabelën e mëposhtme janë disa nga pikat ku ka dallime më të mëdha në sasi:

Aksi: A dhe Aksi:B Trotualet					
Pozicioni në paramasë	Përshkrimi	Sasia e dhënë	Sasia që duhet	Çmimi i ofruar	Çmimi i ri sipas sasisë që duhet
2.4	Furnizimi, transporti, punimi i materialit mbushës guror jokoherent me CBR>20% , shtrirje dhe ngjeshja në shtresa jo më të mëdha se 30cm deri në modulën e ngjeshmërisë 50MN/m ²	930 m ³	2424.2 * 0.3 = 727.26 m ³	€ 2,790.00	€ 2,181.78
3.1	Furnizimi, transporti , planifikimi dhe ngjeshja e tamponit (Msh=80MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-60mm me trashësi t=25cm.	805 m ³	2424.2 * 0.25 = 606.05 m ³	€ 5,635.00	€ 4,242.35

Aksi kryesore - Drenoc

2.2	Gërryerja, planifikimi, rrafshimi i nënbazës dhe ngjeshje deri në modulën e ngjeshmërisë 20N/mm ²	7875 m ²	1044.26 * 8 = 8454.08 m ²	€ 1,575.00	€ 1,690.81
2.4	Furnizimi, transporti, punimi i materialit mbushës guror jokoherent me CBR>20% , shtrirje dhe ngjeshja në shtresa jo më të mëdha se 30cm deri në modulën e ngjeshmërisë 60MN/m ²	1780 m ³	8454.08 * 0.3 = 2536.22 m ³	€ 5,340.00	€ 7,608.66
3.5	Furnizimi dhe punimi i Bitu Zhavorit BZH22 - BIT 50/70 me trashësi t=8cm, me spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m ² të sipërfaqes së bito agregatit.	2553 m ²	1044.26 * 5.5 = 5743.43 m ²	€ 15,318.00	€ 34,460.58
3.6	Furnizimi dhe punimi i asfaltbetonit AB11, PmB 50/70-65) me trashësi t= 4cm, me spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m ² të sipërfaqes së binderit.	5952 m ²	1044.26 * 5.5 = 5743.43 m ²	€ 23,808.00	€ 22,973.72

Aksi te Varrezat, Drenoc

2.2	Gërryerja, planifikimi, rrafshimi i nënbazës dhe ngjeshje deri në modulën e ngjeshmërisë 25N/mm ²	2145 m ²	330.42 * 5 = 1652.1 m ²	€ 214.50	€ 165.21
2.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gjeotekstilit 400gr/m ²	2345 m ²	330.42 * 5 = 1652.1 m ²	€ 1,641.50	€ 1,156.47
3.1	Furnizimi, transporti , planifikimi dhe ngjeshja e tamponit (Msh=70MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-60mm me trashësi t=20cm	455 m ³	1652.1 * 0.2 = 330.42 m ³	€ 3,185.00	€ 2,312.94

3.2	Furnizimi, transporti , planifikimi dhe ngjeshja e tamponit (Msh=80MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-32mm me trashësi t=10cm	215 m ³	1652.1 * 0.1 = 165.21 m ³	€ 1,505.00	€ 1,156.47
3.3	Furnizimi dhe punimi i shtresës së Bitu Zhavorit BZH22-BIT 50/70, me trashësi t=8.0cm duke përfshirë spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m ² .	1345 m ²	330.42 * 4 = 1321.68 m ²	€ 8,070.00	€ 7,930.08
3.4	Furnizimi, transporti , planifikimi dhe ngjeshja e tamponit (Msh=80MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-32mm me trashësi t=10cm	1345 m ²	330.42 * 4 = 1321.68 m ²	€ 5,380.00	€ 5,286.72

Aksi te Gjafollt, Drenoc

3.4	Furnizimi , transporti dhe punimi i Bitu Zhavorit BZH22 - BIT 50/70 me trashësi t=8cm, me spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m ² të sipërfaqes së bito agregatit.	1893 m ²	364.63 * 5 = 1823.15 m ²	€ 11,358.00	€ 10,938.90
3.5	Furnizimi transporti dhe punimi i asfalt betonit AB11 PmB 50/70-65) me trashësi t= 4cm, me spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m ² të sipërfaqes së binderit.	1893 m ²	364.63 * 5 = 1823.15 m ²	€ 7,572.00	€ 7,292.60

Aksi 1

3.4	Furnizimi, transporti dhe punimi i Bitu Zhavorit BZH22 - BIT 50/70 me trashësi t=8cm, me spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m ² të sipërfaqes së bito agregatit.	553 m ²	125 * 4 = 500 m ²	€ 3,318.00	€ 3,000.00
3.5	Furnizimi transporti dhe punimi i asfalt betonit AB11 PmB 50/70-65) me trashësi t= 4cm, me spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m ² të sipërfaqes së binderit.	553 m ²	125 * 4 = 500 m ²	€ 2,212.00	€ 2,000.00

Aksi 1

3.4	Furnizimi , transporti dhe punimi i Bitu Zhavorit BZH22 - BIT 50/70 me trashësi t=8cm, me spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m2 të sipërfaqes së bito agregatit.	925 m ²	224 * 4 = 896 m ²	€ 5,550.00	€ 5,376.00
3.5	Furnizimi transporti dhe punimi i asfalt betonit AB11 PmB 50/70-65) me trashësi t= 4cm, me spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m2 të sipërfaqes së binderit.	925 m ²	224 * 4 = 896 m ²	€ 3,700.00	€ 3,584.00
Totali				€ 108,172.00	€ 123,357.29
Diferenca				€ (15,185.29)	

TABELA 3. Pozicionet e analizuar të cilat kanë patur pasaktësi në paramasën për ndërtimin e rrugëve në Drenoc

Diferenca është -15,185.29€. Në shumicën e pikave çmimi i ri në bazë së sasisë që D+ ka llogaritur është më i ulët se çmimi i ofruar, përveç pikës 3.5 dhe 3.6 për aksin kryesor që kanë çmime më të larta. Këto dy pika duhet të kenë sasi të njëjtë pasi bëhet fjalë për shtresën e parë dhe të dytë të asfaltit. Me sasinë e dhënë në pikën 3.5 nuk mund të shtrohet asfalt me gjerësi të rrugës 5.5m, por vetëm 2.44m. Kjo vlerë është llogaritur duke pjesëtuar sasinë e dhënë për pikën 3.5 në tabelën më lartë, pjesa aksi kryesor, që është 2553 m² dhe gjatësisë së rrugës, 1044.26 m.

Në të gjitha pikat që kanë të bëjnë me shtrimin e kubëzave për trotuar, kompania ka ofruar me çmim 6 euro. Në bazë të letrës së dërguar për dyshimin mbi çmime jo-normalisht të ulëta, kompania është përgjigjur duke dhënë detaje për mënyrën e prodhimit, duke ardhur në kosto variabile në 5.4 euro, por pa llogaritur kostot fikse.

Kostot fikse janë kosto që ndodhin pavarësisht a prodhon kompania apo jo. Disa nga kostot fikse janë qiraja, pagat e punëtorëve, shpenzimet fikse si regjistrimi i automjeteve, i energjisë elektrike, etj. Kostot variabile janë kosto që ndodhin dhe variojnë varësisht nga sasia që prodhohet. Shembull të kostove variabile janë lënda e parë. Kostot variabile rriten me rritjen e prodhimit, përderisa kostot fikse janë të njëjta si të prodhohet një produkt ose 1000.

Në kontratë, edhe pse për të dy kompanitë është kërkuar që të vendoset siguria e ekzekutimit në 30%, vetëm Erdi Group & El-Bau e ka 30%, ndërsa Papenburg & Adriani 10%.

Në lidhje me këto të gjetura në lidhje me paramasën e këtij projekti komuna në përgjigjen e saj²⁰ nuk ka mohuar gjetjet por ka thënë se kompensimi i punëve do të bëhet në përputhje me sasi të reale të ekzekutuara në terren.

Mirëpo, D+ tërheq vërejtjen se sasi të hartuara në mënyrë të gabuar kanë ndikime në konkurrencë të drejtë në mes të operatorëve, për shkak se operatorët të cilët e dinj se sasi të reale mund të ofertojnë me çmime shumë më të ulëta dhe të fitojnë kontratat.

²⁰ Përgjigja e plotë e komunës - Në lidhje me Projektin: "Ndërtimi i disa rrugëve dhe trotuareve në fshatin Drenoc", Në kuadër të këtij projekti, kemi të bëjmë me realizimin e rrugëve të reja dhe rrugëve ekzistuese. Ky projekt do të realizohet duke u bazuar në projektin detal, të përpiluar nga kompania projektuese "3D projekt" e të mbikëqyrr nga Komuna e Prishtinës. Duke u bazuar në konsultim me kompaninë projektuese për projektin dhe duke u bazuar në nevojat në terren ne do të zhvillojmë punimet në kuadër të kësaj kontrate. Normalisht edhe sasia e punëve të realizuara do të paguhet në harmoni me situatën e ekzekutuar në terren në bazë të projektit të hartuar.

Ndërtimi i rrugëve në brendësi të Fshatit Slivovë

Si pasojë e sasive të dhëna gabim në paramasë, buxheti i komunës është dëmtuar për së paku 7,476.53 euro.

Në këtë tender është përdorur procedura e hapur, vlera e parashikuar e kontratës ka qenë 139,275.56 euro me afat për përfundimin e punëve prej 60 ditëve.

Në Fletën e Dosjes së Tenderit (FDT) afati është 120 ditë, ndërsa në Njoftimin për Kontratë është 60 ditë. Siguria e Ekzekutimit është kërkuar 120 ditë, por duhet të jetë plus 30 ditë nga afati kohor i kërkuar për përfundimin e punëve, në këtë rast për shkak të afateve të ndryshme 90 ose 150 ditë.²¹

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ka qenë 18 ditë, por në bazë të Udhëzuesit²² për vlera të mesme afati normal është 20 ditë.

Fitues i këtij tenderi është zgjedhur NTP Bashkimi me ofertë prej 99,385.36 euro, ndërsa kontrata është nënshkruar më 12 shkurt 2018. Njoftimi për Nënshkrimin e Kontratës është përgatitur më 28 shkurt 2018, gjë që është dashur të bëhej brenda dy (2) ditëve.

Në përshkrimin teknik prapë ka kërkesa të paligjshme për përdorimin e standardeve zvicerane, gjermane dhe serbe.

Sipas projektit rruga përbëhet nga këto shtresa:

-  Asfalt beton – 4cm
-  Shtresa e asfalt binderit – 7cm
-  Tampon prej gurit gëlqeror 0-31.5 – 10cm
-  Tampon prej gurit gëlqeror 0-60 – 20cm
-  Material mbushës me CBR>20% - 40cm
-  Totali – 81cm trashësi

Gjatësia e rrugës është **1194.03M** ndërsa gjerësia e paraparë për tu shtruar me asfalt është **4M**, me bankina **2X1M**, që japin sipërfaqen

$$1194.03 * 6 = 7164.18 \text{ M}^2$$

²¹ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 30.6 (2017).

<http://rebrand.ly/rroopp>

²² Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 21.1 (2017).

<http://rebrand.ly/rroopp>

Te paramasa, në pikën 2.4 që është për furnizimin, transportin dhe punimin e materialit mbushës, trashësia e kërkuar është 30cm, ndërsa sipas projektit duhet të jetë 40cm. Në këtë pikë NTP Bashkimi ka ofruar me çmim një euro dhe nuk ju është kërkuar sqarim për çmim jo-normalisht të ulët edhe pse në tenderin për rrugët në Busi dhe Drenoc për të njëjtën pikë, më të njëjtin tekst kompanive Papenburg & Adriani Company që kishte ofruar me dy euro dhe Erdi Group & El-Bau që kishte ofruar me tre euro, ju është kërkuar sqarim. Për shkak që kjo pikë ka dallim të madh në sasi, kompania ka ofruar me çmim të ulët, duke e ditur që sasia që kërkohet është më e lartë se sasia reale.

Në paramasë janë disa llogaritje të bëra ku sasisë për shtrimin e asfalt betonit dhe binderit, pika **3.3** dhe **3.4**, i është shtuar vlera **100**. Sasia e llogaritur është **4960.75** dhe është bërë **5060.75**.

Disa nga dallimet më të mëdha në sasi janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Rruga Kryesore					
Pozicioni në paramasë	Përshkrimi	Sasia e dhënë	Sasia që duhet	Çmimi i ofruar	Çmimi i ri sipas sasisë që duhet
2.2	Gërryerja, planifikimi, rrafshimi i nënbazës dhe ngjeshje deri në modulën e ngjeshmërisë 25N/mm ²	7767.5 m ²	$1194.03 * 6 = 7164.18 \text{ m}^2$	€ 1,553.50	€ 1,432.84
2.4	Furnizimi, transporti, punimi i materialit mbushës guror jokoherent me CBR>20% , shtrirje dhe ngjeshja në shtresa jo më të mëdha se 30cm deri në modulën e ngjeshmërisë 45MN/m ²	4324 m ³	$7164.18 * 0.3 = 2149.25 \text{ m}^3$	€ 4,324.00	€ 2,149.25
3.1	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit (65MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror, 0-60mm me trashësi t=20cm	1613 m ³	$7164.18 * 0.2 = 1432.84 \text{ m}^3$	€ 8,871.50	€ 7,880.59
3.2	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit (80MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror, 0-31mm me trashësi t=10cm	738 m ³	$7164.18 * 0.1 = 716.42$	€ 3,925.00	€ 2,865.72

3.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfaltit binder BZH 22 me trashësi t=7,0cm duke inkorporuar edhe shtresën e par të emulsionit prej 03kg/m2.	5060.75 m ²	1194.03 * 4 = 4776.12 m ²	€ 35,425.25	€ 33,432.84
3.4	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfaltbetonit nga materiali i njëtrajtshëm AB11 me trashësi t=4,0cm duke inkorporuar edhe shtresën e dytë të emulsionit 0.3kg/m2.	5060.75 m ²	1194.03 * 4 = 4776.12 m ²	€ 20,243.00	€ 19,104.48
Totali				€ 74,342.25	€ 66,865.72
Diferenca				€ 7,476.53	

TABELA 4. Pozicionet e analizuar të cilat kanë patur pasaktësi në paramasën për ndërtimin e rrugëve në Slivovë

Kontrata edhe pse është nënshkruar më 12 shkurt 2018, ende nuk kanë filluar punimet. Kompania Bashkimi ka kontratë tjetër me Komunën e Prishtinës e cila është duke u zbatuar në të njëjtën kohë. Kjo mund të jetë arsyeja pse ende nuk kanë filluar punimet.

Rindërtimi, sanimi dhe zgjerimi i disa rrugëve sekundare në territorin e Komunës së Prishtinës

Komuna ka shpërblyer me kontratë një tender jo-normalisht të ulët. Komuna nuk ka analizuar çmimet e ofertuesve, nuk ka krahasuar tenderët e tyre dhe si pasojë as nuk ka kërkuar sqarime për tender jo-normalisht të ulët. Gjithashtu konsorciumi fitues ka paraqitur kontratë të panënshkruar nga e punësuar, si dhe një automjet të marrë me qera nga një person por libereza e automjetit ka qenë në emër të një personi tjetër. Për këto dy elemente konsorciumi fitues do të duhej të shpallej si i papërgjegjshëm.

Në këtë tender është përdorur procedura e hapur, vlera e parashikuar e kontratës ka qenë 476,515.04 euro, me afat të përfundimit të punëve për 12 muaj. Komuna me sqarim shtesë e ka bërë ndryshimin në Kontratë Kornizë për 12 muaj. Dallimi kryesor është që me Kontratë Kornizë lejohet devijim në sasi +-30%. Zakonisht për ndërtim të rrugëve nuk përdoren kontratat kornizë pasi dihen saktë sasi të cilat janë të llogaritura në paramasë. Përdorimi i kontratës kornizë kur dihen sasi të lejon hapësirë që të ketë keqpërdorime, pasi kompanitë mund të ofrojnë me çmime jo-normalisht të ulëta, e më pastaj të rrisin sasi të deri në plus 30% për pjesët ku kanë dhënë çmime të larta.

Fitues i këtij tenderi është grupi i operatorëve ekonomik Bashkimi & Bageri me çmim 247,853.52 euro. Në tender kishte gjashtë oferta, ku pesë ishin të përgjegjshme dhe një e papërgjegjshme. Ka pasur kërkesë për rishqyrtim nga kompania e dytë me çmimin më të ulët, Toifor, me pretendimet për mungesë dokumentacioni nga konsorciumi fitues. E njëjta kërkesë është refuzuar nga komuna. Njëra nga pikat e kësaj kërkesë ka qenë që inxhinierja e diplomuar e ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik ka prezantuar kontratën e punës të nënshkruar vetëm nga Bashkimi. D+ ka shikuar dokumentet për këtë tender dhe kemi vërtetuar që kontrata nuk është e nënshkruar nga e punësuar. Gjithashtu kontrata është lidhur duke u bazuar në

rregulloret e UNMIK-ut dhe Ligjin Themelor të Punës. Në kontratat në mes të punëtorëve dhe Bashkimi orari i punës është nga 07:00 – 18:00 me mundësi të zgjatjes ose shkurtimit të orarit. Në kontrata nuk është e shkruar as se në cilën ditë do ta ketë pushim punëtori. Me Ligjin e Punës²³ orari i rregullt i punës është 40 orë në javë, me mundësi edhe të 8 orëve jashtë orarit nëse kërkohet. Në këto kontrata orari ditor është 11 orë, ndërsa javor 77 orë, ndërsa maksimumi duhet të jetë 48 orë.

Kërkesa për rishqyrtim është refuzuar nga Komuna, ndërsa për ankesën për kontratën e panëshkruar nga e punësuar, është përgjigjur me “Edhe pse kontrata nuk është nënshkruar nga menaxheri i projektit kjo është konsideruar si lëshim teknik, bazuar në faktin se diploma e të njëjtit është me noterizim origjinal në ditën e fillimit të kontratës dhe dëshmohet se noterizimi i tillë është kryer nga vetë menaxheri e jo nga ndonjë person tjetër”. Sipas Ligjit të Punës, Neni 10 kontrata duhet të nënshkruhet nga të dy palët dhe nuk mund të cilësohet si lëshim teknik. Pasi kontrata nuk është nënshkruar nga të dyja palët, për këtë kriter ky konzorcium do të duhej të shpallej si i papërgjegjshëm.

OE Bashkimi pajisjet e kërkuara në DT i ka marrë me qera nga Enver Aliu, por njëri nga kamionët, Mercedes i vitit 1991 është në pronësi të Leotrim Aliut. Edhe për këtë pikë konzorciumi do të duhej të shpallej i papërgjegjshëm pasi ka prezantuar kontratë për qiramarrje për pajisje ku njëra prej tyre nuk është e regjistruar në emër të Enver Aliut. Kjo tregon se jo të gjitha pajisjet ishin pjesë e kontratës së qirasë.

Për Dosjen e Tenderit është përdorur formulari B17 nga KRPP që është Dosja e Tenderit për punë, ndërsa pasi Komuna e ka ndryshuar procedurën në Kontratë Kornizë do të duhej ta përdorte formularin B29 që është Dosja e Tenderit për procedurë të hapur, punë, kontratë kornizë. Këta dy formularë kanë dallime në nenet e Kushteve të Veçanta edhe Kushteve të Përgjithshme të DT.

Edhe në këtë tender ka kërkesa që të përdoren standardet dhe rregulloret gjermane DIN dhe ZTV.

Krahasuar me tenderët e mëparshëm përshkrimi teknik dhe DT kanë më pak detaje. Nuk dihet se në cilat lokacione do të kryhen punët. Rrugët të cilat do të rindërtohen, sanohen apo zgjerohen nuk janë shkruar as në DT, as në Njoftim për Kontratë e as në Përshkrimin Teknik.

Çmimi i ofruar është rreth 230,000 euro më i ulët se vlera e parashikuar ose 52% e kësaj vlere. Ky çmim është për rreth 81,000 euro më i ulët se oferta e dytë më e lirë, që është e kompanisë Toifor. Bashkimi & Bageri e kanë ofertën e tyre për 54.37% më të ulët se mesatarja e tenderëve të përgjegjshëm, 32.45% më të ulët se tenderi i dytë më i lirë. Sipas formularit B57²⁴ të KRPP-së autoriteti kontraktues duhet të kërkojë shpjegime nga operatorët ekonomik kur çmimi i ofruar është nën 30% të mesatares së tenderëve të përgjegjshëm, 10% më i ulët se oferta e dytë më e lirë dhe kur janë së paku tre tenderë. Të gjitha këto kushte janë plotësuar dhe Komuna do të duhej të kërkonte sqarime për tender jo-normalisht të ulët, por nuk e ka bërë këtë.

Në bazë të paramasës, pika 2.1 është nxjerrë sipërfaqja e rrugëve e cila është 275,000 m² (gjatësia 55km dhe gjerësia 5m).

Në pikën 1.3 të paramasës që është për gërmimin e dheut të kategorisë IV dhe V, hapja e trasesë së re dhe transporti i materialit të gërmuar është ofruar çmim 0.80 euro për m³, ndërsa nga Lista e KRPP-së çmimi është 2.87 euro²⁵ m³ për punën e ngjashme.

Në pikën 3.1 dhe 3.4 për furnizim me gypa prej betoni të armuar, për të gjitha gypat nga fi 400mm – 1200mm çmimi është 20 euro. Në treg gypat me trashësi të ndryshme nuk kanë çmime të njëjta.

23 Ligji i Punës 03/L-212, Neni 23.1 (2010). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>

24 B57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët- Verzion i korrigjuar, Neni 3 (2016). Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik.

<http://rebrand.lv/b57>

25 Lista e çmimeve njësi mesatare referent për punë ndërtimore dhe materiale ndërtimore, PN0014 (2015). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

<https://rebrand.lv/krpp>

ZBATIMI I KONTRATËS

Për këtë kontratë deri më 28 qershor 2018 është bërë vetëm një pagesë në vlerë 11,198.40 euro. Sipas kontratës fillimi i punëve duhet të përcaktohet në KV. Në KV thuhet që data e fillimit të punëve do të jetë e përcaktuar nga ekipi menaxhues. Fatura e lëshuar nga kompania Bashkimi nuk përmban të dhëna se çka është punuar, ndërsa në dokumentet që na ka dhënë Komuna e Prishtinës nuk ka qenë i bashkangjitur situacioni për punët e kryera. Situacioni është një dokument që tregon se çka është punuar dhe cilat pozicione të paramasës janë përfunduar. Mungesa e situacionit mund të nxisë dyshime rreth nivelit të punëve të kryera.

● Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve II

Në DT Komuna ka vendosur kriter që OE të ofrojnë dëshmi që kanë realizuar së paku dy shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit. Ky kriter është diskriminues dhe favorizon vetëm kompanitë që kanë fituar tender publik në të kaluarën. Kompanitë transportuese që punojnë me persona privat lëshojnë vetëm fatura individuale dhe e kanë të pamundur që të dëshmojnë shërbimet e kryera me kopje të referencave ose certifikata të pranimeve. Një kompani që bën çdo ditë bartjen e udhëtarëve e që nuk ka fituar asnjëherë tender publik nuk do të mund të fitonte në këtë tender. Komuna nuk pajtohet me këtë të gjetur, duke arsyetuar se kompanitë mund të ofrojnë edhe me dokumente të tjera të konsideruara si të përshtatshme nga autoriteti kontraktues të cilat dëshmojnë aftësitë teknike dhe profesionale. Kjo rregullohet me Nenin 69 të LPP. Mirëpo, në rastin e kompanive që bëjnë bartjen e udhëtarëve cdo lloj tjetër i dokumentit është i pa përshtatshëm për të dëshmuar këtë kërkesë të komunës. Kjo pasi që shërbimi në këtë rast mund të dëshmohet me kontratë apo referencë, dhe cdo lloj tjetër i dokumentit, nuk garanton se kompania në të vërtetë ka ofruar këtë shërbim në të kualuarën. Këto dokumente nuk mund të lëshohen nga udhëtarët individual dhe një kërkesë e tillë e komunës për këtë llojë të shërbimit nuk ka ndonjë relevancë, përveq që ul konkurrencën ndërmjet operatorëve. Për këtë dëshmi është fakti se për 12 lloje të kësaj kontrate kanë ofertuar 22 oferta nga 13 kompani, apo në mesatare 1.83 oferta për një lloj, që është dukshëm nën mesataren e aktiviteteve të tjera të prokurimit në Prishtinë.

Tenderi për transportin e nxënësve dhe arsimtarëve është përbërë nga 12 lloje me vlerë të parashikuar prej 162,112 euro. Procedura e përdorur është e hapur, kontratë kornizë për 12 muaj. Nga 14 tenderues, të gjithë ishin të përgjegjshëm. Kontratat janë nënshkruar më 22 dhjetor 2017, ndërsa përgatitja e Njoftimit për Nënshkrim të Kontratës është bërë më 24 janar 2018, e cila është dashur të bëhej brenda dy ditëve nga nënshkrimi.

Afati për dorëzimin e ofertave ka qenë 18 ditë. Në Njoftimin për Kontratë thuhet që është bërë së pari Njoftimi Paraprak. Pasi vlera është e madhe, me Njoftim Paraprak afati kohor është dashur të jetë 24 ditë²⁶.

Në DT tek kapaciteti teknik është kërkuar që OE duhet të kenë minibus, por në dy relacione numri i nxënësve dhe arsimtarëve është më i lartë se kapaciteti i një minibusi, prandaj kompanitë kanë ofruar që transporti të bëhet me autobus.

● Revitalizimi i shkollëve dhe ndërtimi i mbikalimit në lagjen Arbëria

Në këtë tender është përdorur procedura e hapur, vlera e parashikuar ka qenë 653,071.76 euro, afati për përfundimin e punëve 120 ditë. Nga 14 ofertues, dhjetë ishin të përgjegjshëm dhe katër të papërgjegjshëm. Fitues është NBT-ING me çmim 463,262.41 euro. Kontrata është nënshkruar më 5 shkurt 2018, dhe Njoftimi për Nënshkrimin e Kontratës është publikuar me datën 23 mars 2018 me rreth dy muaj vonesë.

²⁶ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 21.1 (2017). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. <http://rebrand.ly/rroopp>

Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve (më tutje Deklarata e Nevojave) nuk e ka datën të plotësuar. Kjo Deklaratë duhet ta ketë datën para publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Në DT, në pjesën tek Kushtet e Veçanta, garancioni është kërkuar për pesë vjet, por pasi është nënshkruar Kontrata, garancioni është ulur në tre vjet. Komuna ka thënë se ka ndodhur gabimisht dhe se kontrata duhet të modifikohet. Garancioni paraqet kosto për kompaninë. Shkurtimi i afatit të garancionit ul koston për kompaninë, mirëpo dëmton interesin publik, sidomos atë të komunës, pasi kjo nënkupton se komuna ka marr më pak për paratë e njëjta të shpenzuara. Garancioni për tri vjet është dashur të jetë i shkruar kur është publikuar DT, pasi shkurtimi pas nënshkrimit të kontratës krijon pabarazi. Kompanitë po ta dinin që garancione kërkohej për tri vjet, do të mund të ofertonin me çmim më të lirë.

Paramasa është e hartuar më mirë se tenderët për ndërtim të rrugëve, me detaje të shumta dhe pa gabime në llogaritje të sasive. Në ofertën e kompanisë fituese, në pikat 3.2 dhe 3.3 për Gërmim të gjerë të dheut të kategorisë III dhe IV, çmimi është 1 euro për m³, ndërsa në Listën e KRPP-së çmimi varion nga 2.7 – 2.87 euro.

Në pikat 6.4.1 – 6.4.6 që është për shufra me dimensione nga fi 8 deri 22, çmimi për kg është i njëjtë, 0.80 euro.

Furnizimi me pajisje teknologjike për objektet komunale dhe të bashkësisë lokale

Specifikat teknike për kompjuterë, lloptop dhe serverë kanë qenë shumë të ngarkuar e si rezultat tenderi për lot 1 është anuluar tri herë. Disa nga specifikat e kërkuara kanë qenë të pamundura të plotësohen pasi produkti i kërkuar nuk ekziston në treg me ato specifika. Për lot 2, furnizim me printer, kompania fituese dyshohet që e ka shkruar vetë katalogun e kërkuar, njëkohësisht duke ndryshuar të dhënat në mënyrë që ato të përshtaten me specifikat e kërkuara. Këtë nuk e ka vërejtur komisioni i vlerësimit. Kjo kompani është dashur që të shpallet e papërgjegjshme e njëkohësisht të kërkohej nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që kompania të futet në listë të zezë. Nëse verifikohet kemi të bëjmë me mashtrim të pastër. Kompania, përveç futjes në listë të zezë, duhet të hetohet edhe nga prokuroria për falsifikim të katalogut.

Ky tender ka qenë i ndarë në 2 llopte, me vlerë të parashikuar prej 80,000€, ndërsa afati për përfundimin e furnizimit ka qenë 60 ditë. Në tenderin e parë nga katër oferta, të gjitha kanë qenë të papërgjegjshme, sepse e kanë tejkaluar vlerën e parashikuar, ndërsa Komuna e ka anuluar aktivitetin e prokurimit. Në tenderin e dytë pesë oferta kanë qenë të përgjegjshme për llot 2, ndërsa me kontratë është shpërblyer Europrinty. Për llot 1 të gjitha ofertat kanë qenë të papërgjegjshme. Llot 1 është anuluar, por nuk është publikuar Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit. Në tenderin e tretë që ka qenë vetëm për llot 1 aktiviteti përsëri është anuluar pasi të gjitha ofertat kanë qenë të papërgjegjshme.

Në DT në pikat për server, kompjuter dhe lloptop është kërkuar që të kenë procesor nga kompania Intel, ndërsa procesora me performancë të ngjashme ka edhe kompania AMD. Nëse komuna kërkon një produkt nga një prodhues specifik, atëherë duhet të shtojë edhe fjalën “ekuivalente” siç kërkohej me ligj²⁷. Komuna arsyeton se procesorët e kompanisë Intel kanë performancë më të mirë²⁸. D+ nuk konteston kualitetin e njëjës apo tjetrës, thjesht i kujton komunës se markat tregtare nuk mund të vendosen në DT, pasi që dicka e tillë ndalohet me LPP. Gjithashtu te PC, është kërkuar që procesori të jetë Intel Core i3 7100 6M Cache²⁹, por ky procesor është me 3M Cache. Si rezultat janë shpallur dy kompani të papërgjegjshme pasi kanë ofruar me këtë procesor me 3M Cache, ashtu edhe siç ekziston në treg.

Për lloptopët e kërkuar, një nga specifikat është që lloptopi të ketë One-Link Docking Port e cila është e prodhuesit Lenovo. Sipas ligjit është e ndaluar që të përshtaten specifikat teknike për një prodhues të caktuar.

27 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 20.8 (2017). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

<http://rebrand.ly/ruopp>

28 Përgjigja e plotë e komunës - Duke pasur para sysh që kërkesat e komunës për kapacitetet harduerike janë çdo herë e më shumë në rritje ne kemi zgjedhur procesorët Intel pasi që ofrojnë performanca shumë më të mira krahasuar me procesorët AMD. Në treg ekzistojnë shumë kompani Brand Name, të cilat ofrojnë produkte me procesor Intel (siç janë: HP, DELL, ACER, FUJITSU, Asus, Apple, Toshiba etj.)

29 Intel Core i3-7100 Processor.

<https://ark.intel.com/products/97455/Intel-Core-i3-7100-Processor-3M-Cache-3-90-GHz>

Një nga ofertuesit i cilësuar si i papërgjegjshëm, Ilir-Kosova është eliminuar pasi procesorin për server e ka ofruar Intel Xeon 2620 v3, ndërsa është kërkuar 2620 v4. Përveç që është kërkuar markë e një kompanie (Intel) është kërkuar edhe produkti specifik. Për furnizimin e kërkuar ka edhe kompani tjetër siç është AMD. Specifikat teknike për procesor kanë mundur të hartohen më mirë duke kërkuar shpejtësinë e procesorit dhe vitin e prodhimit.

Po ashtu te serveri i kërkuar, kompania InterAdria është shpallur e papërgjegjshme pasi ka ofruar me kapacitet të memories 1.5TB, ndërsa është kërkuar 3TB. Kapaciteti i instaluar është kërkuar 128GB. Procesori i kërkuar Intel Xeon 2620 v4 përkras RAM memorie deri në 1.54 TB³⁰. Pra kërkesa prej 3TB RAM memorie nuk ka mundësi praktike që të plotësohet. Pasi këtu bëhet fjalë për RAM memorie, kapaciteti prej 1.5TB është mëse i mjaftueshëm për nevojat e Komunës.

Pasi që kërkesat në specifikimin teknik për lloptop, kompjuter dhe server ka qenë shumë të detajuara, ky tender ka dështuar tre herë. Komuna duhet të thjeshtësojë këto specifika dhe si udhëzim gjatë hartimit të specifikimit teknik në të ardhmen të ketë parasysh manualin e publikuar në faqen e Ministrisë së Administratës Publike (MAP)³¹.

Komuna arsyeton se specifikacionet teknike janë përpiluar më të detajuara në mënyrë që operatorët ekonomik të ofrojnë pajisjet më të mira dhe më të avancuara. D+ vë në dukje se specifikat e kërkuara nga komuna në disa raste nuk ekzistojnë në treg dhe si të tilla janë hartuar gabimisht e rrjedhimisht nuk mund të ofertojnë nga asnjë operatorë.

Për llot 2, ku fitues ishte Europrinty katalogu për printerët e ofruar është shkruar nga vetë kompania, ndërsa të dhënat janë ndryshuar duke i përshtatur me specifikimin teknik të kërkuar. Kërkesa ka qenë që printeri të ketë 512MB memorie, ndërsa në faqen e prodhuesit HP, në katalogun e printerit të kërkuar shkruan që ka kapacitet 256MB³². Europrinty në katalog e ka shkruar që printeri vjen me 512MB memorie.

Në ofertën e Europrinty, tonerët për 2 printerët e kërkuar janë ofruar me çmim 16 euro. Tonerat origjinal nga prodhuesi HP kanë çmim 86.44 euro³³ në faqen Idealo.de, ndërsa 126.89 dollarë³⁴ në Amazon.com. Tonerë nga kompani që bëjnë mbushjen e tyre, çmimet janë rreth 30 euro. Pasi dallimi në çmim është shumë i madh, ekziston dyshimi i arsyeshëm se kompania ka ofruar tonerë të mbushur e jo origjinal.

Në Kontratë garancioni i kërkuar shkruan "Për periudhën e parashikuar të furnizimeve", ku kjo periudhë është 60 ditë. Garancioni do të duhej të kërkohej për një periudhë më të gjatë. Të paktën garancioni është dashur të kërkohej për një vit.

Për llot 1 tre herë është shpallë tender dhe është anuluar në të tri rastet. Specifikat teknike të kërkuara janë të tepërta, ndërsa në një pikë e pamundur të përmbushet. Për llot 2 komuna është dashur të përdorë si kriter për dhënie të kontratës, çmimin ekonomikisht më të favorshëm. Në printera një pjesë e madhe e kostos është pas blerjes, ku duhen tonera dhe mirëmbajtja e printerit.

Komuna po ashtu ka gabuar për faktin se nuk ka përdorur specifikat teknike të hartuara nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit e cila është e specializuar për çështje të teknologjisë informative. Për më tepër duket se komuna nuk ka bërë asnjë hap për të shmangur mashttrimet nga kompanitë private, për të krahasuar katalogjet e ofruara nga operatorët me ato të prodhuesve.

30 Intel Xeon E5 2620 v4.

https://ark.intel.com/products/92986/Intel-Xeon-Processor-E5-2620-v4-20M-Cache-2_10-GHz

31 Specifikime Teknike "Pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për përdorim zyre". Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. 2017

<https://map.rks-gov.net/getattachment/76a9628b-65c1-4416-9ce8-dcd86644be11/Specifikime-Teknike.aspx>

32 HP LaserJet Pro MFP M426 Series Datasheet.

<http://h20195.www2.hp.com/v2/GetDocument.aspx?docname=4AA6-1046EEP>

33 Hewlett-Packard HP 26A schwarz (CF226A).

rebrand.ly/idealc519a

34 HP 26A (CF226A) Black Original Toner Cartridge for HP LaserJet Pro M402 M426.

rebrand.ly/amazoa7ca

Infografikat dhe sinjalizimi në objektet e Komunës

Për këtë aktivitet të prokurimit është përdorur procedura e hapur, vlera e parashikuar ka qenë 50,000 euro, ndërsa afati për kryerjen e punëve 45 ditë. Ky tender është shpallur dy herë. Herën e parë është anuluar pasi kompania e vetme që kishte ofertuar është shpallur e papërgjegjshme pasi që nuk e ka plotësuar formularin e tenderit lidhur me validitetin e tenderit.

Në tenderin e dytë fitues është zgjedhur kompania Depart Studio me çmim 42,120 euro. Pas shpalljes së fituesit ka bërë kërkesë për rishqyrtim Grafo-Loni me arsyetimin që kompanisë fituese i mungojnë dëshmitë për punët e ngjashme të realizuara në vitet 2014, 2015, 2016. Depart Studio ka prezentuar referenca të punëve të kryera më 2017. Komuna aprovoi kërkesën për rishqyrtim dhe tenderin e ktheu në rivlerësim. Pas rivlerësimit fitues zgjedhet Grafo-Loni me çmim 43,117.20 euro.

Komuna përmes letrës për sqarim të tenderit ka hequr nga paramasa pikën 4 që është për ceradë të printuar me ngjyra dhe pikën 18, që është për qese të letrës, ndërsa vlera e parashikuar ka mbetur e njëjtë. Kjo bën që të rritet vlera e parashikuar për pikat tjera dhe ju mundëson OE të ofrojnë me çmime më të larta.

Në tenderin e parë Kushtet e Veçanta nuk janë plotësuar.

Afati për kryerjen e punëve në Njoftim për Kontratë është 45 ditë, por në Kontratë është 90 ditë.



KOMUNA E PEJËS

Për Komunën e Pejës, për dallim nga komunat e tjera, janë analizuar vetëm pesë tenderë ku të gjeturat kryesore janë këto: Kushtet e Veçanta nuk plotësohen, e si pasojë nuk kërkohet as garancioni i punëve apo produkteve. Edhe në këtë Komunë ka kërkesa për produkte të prodhuesve të caktuar. Ka gabime të shumta në llogaritjen e dimensioneve për tenderin për ndërtimin e Shkollës së Mesme të Artit, ku gjithashtu ka përdorim të gabuar të njësive matëse në kundërshtim me praktikën që janë në treg.

Për tenderin e furnizimit me dru ka Urdhërblerja që mbanë datën e para nënshkrimit të kontratës. Tenderi i është dhënë kompanisë Acvilla me çmim 9.9 euro (për njësi) më të lartë se kontrata paraprake që e kishte me Komunën e Pejës. Në tenderin për ndërtimin e ndriqimit publik është llogaritur gabim afati i kërkesës për rishqyrtim, ku edhe pse kompania ankuese e ka bërë kërkesën brenda afatit, i është refuzuar si e pas afatshme. Në tenderin për shërbimet e telefonisë mobile, në specifikat teknike ka qenë kërkesë që oferta e OE të jetë për 30% më e lirë se tarifat ekzistuese të saj. Kjo kërkesë është e paarsyeshme dhe e paligjshme pasi kompania është ajo që cakton çmimet për shërbimet e saj.

Në komentet e dërguara në këtë Raport, Komuna e Pejës është deklaruar se kushtet e veçanta të dosjeve të tenderit, që nga viti 2018 plotësohen në të gjitha rastet. Sidoqoftë në 15 aktivitetet të prokurimit të publikuara për periudhën 1 qershor – 31 korrik 2018, vetëm në një dosje janë plotësuar kushtet e veçanta³⁵ dhe në një tjetër janë plotësuar pjesërisht³⁶, përdërisa në 13 dosje të tjera këto kushte janë tërësisht të pa plotësuara.

Furnizim me dru për institucionet shkollore për fazën e II-të

Komuna ka lidhur kontratë me kompaninë Acvilla me çmim 48.60 euro për metër kub, ndërsa në kontratën paraprake që kishte me të njëjtën kompani çmimi ishte 38.70 euro. Dallimi është 9.9 euro për m³ sidoqoftë kjo kontratë ishte regionale, që do të thotë se sasi të kanë qenë dukshëm më të mëdha. Komuna po të lidhte kontratë me çmim 38.70 euro do të kursente 23,611.50 euro. Komuna ia ka mundur kompanisë Acvilla që të ofertojë me çmim më të lartë, pasi së pari vlerën e parashikuar për metër kub e ka dhënë 45 euro. Pastaj ka publikuar njoftim për korrigjim të gabimeve ku e ka ulur sasinë e kërkuar e në mënyrë automatike është rritur vlera e parashikuar, në 50 euro për metër kub. Sipas komunës kjo ka ndodhur për shkak se blerja është bërë gjatë muajit nëntor kur edhe çmimi i drunjëve shënon rritje. Rritja e vlerës së parashikuar ka bërë të mundur që operatori të ofertojë me çmime më të larta dhe në këtë mënyrë të dëmtohet buxheti i Komunës. Sipas hulumtimeve të D+ një metër kub i drunjëve për ngrohje me shërbimet përcjellëse të qarjes dhe transport nuk duhet të kushtojë më shumë sesa 40 euro për metër kub. Komuna e Pejës arsyeton se për këtë kohë dhe këtë sasi, çmimet sillen rreth 50 euro, duke ofruar dëshmi tenderët e Komunës së Gjilanit (47.80 euro) dhe Komunës së Klinës në vitin 2014 (47.80 euro). Sidoqoftë, këto çmime D+ i ka rikrahuar me Komunën e Obiliqit e cila ka bërë blerjet në tetor të vitit 2017 me 36.6 euro për metër kub dhe me tre herë më pak sasi. Pastaj Komuna e Novobërdës në shtator 2017 ka blerë po ashtu katër herë më pak në sasi me çmim prej 36.60 euro për metër kub. Komuna e Klinës në janar 2018 ka blerë sasi të përafërt me Pejën për 39.92 euro. Këto të dhëna dëshmojnë se çmimi i druve për metër kub në Komunën e Pejës nuk ka siguruar vlerë për parandë dhe potencialisht ka dëmtuar buxhetin e kësaj komune.

35 Asfaltimi i Rrugës Llogagji-Glogjan, Nr. i Prokurimit 635-18-5549-521.

36 Rregullimi i disa hapësirave publike në Komunën e Pejës, Nr. i Prokurimit 635-18-4240-521.

Tenderi është shpallë për kontratë kornizë për gjashtë muaj me vlerë të parashikuar 119,250 euro. Afati për dorëzim të ofertave është shkurtuar me arsyen që tani jemi në fazën dimërore dhe furnizimi me dru ka qenë kompetence e AQP-së. Por AQP më 13 korrik 2017 ju ka dërguar letër AK-ve, ku thuhet që mund të iniciojnë aktivitetet të prokurimit për furnizim me dru. Komuna ka pasur kohë të mjaftueshme që ta fillojë aktivitetin e prokurimit dhe të përdorë afatet kohore normale. Deklarata e Nevojave nuk ka qenë e plotësuar e gjitha, përkatësisht nuk është shënuar a ka qenë i planifikuar aktiviteti i prokurimit apo jo. Në këtë tender kanë ofertuar tri kompani, ku dy ishin të përgjegjshme. Fitues është zgjedhur Acvilla me çmim 115,911 euro.

Kontrata është lidhur më 24 nëntor 2017, por pasi hulumtuesit tanë i kanë shikuar të gjitha dokumentet kemi vërejtur që Komuna ka lëshuar Urdhërblerja për Acvilla që ka datë 22 nëntor 2017. Komuna në lidhje me këtë ka deklaruar se urdhërblerja është bërë për kontratën paraprake me këtë operator. Mirëpo, edhe ajo kontratë në këtë kohë ka qenë e skaduar³⁷ dhe nuk ka patur mundësi që të lëshohet urdhërblerja për datën 22 nëntor 2017.

Deri më 15 korrik 2018 ende nuk është publikuar Njoftimi për Nënshkrimin e Kontratës i cili është dashur të bëhej dy ditë pas nënshkrimit.

Në Dosjen e Tenderit në pikën 2.6 nuk është shënuar vlera e parashikuar. Kushtet e Veçanta nuk janë plotësuar. Në e-prokurim është ngarkuar DT me paramasë ku është shënuar çmimi për njësi, 45 euro. Me Njoftimin për Korrigjim të Gabimeve është ndryshuar sasia nga 2650 m³ në 2385 m³, por vlera e parashikuar ka mbetur e njëjtë. Pasi vlera nuk ka ndryshuar çmimi i planifikuar është rritur pasi është zvogëluar sasia, pra $119,250 / 2385 = 50$ euro për metër kub. Ky çmim është shumë më i lartë se i tregut, ku aty çmimet janë rreth 35 euro, e ndoshta edhe më lirë duke marrë parasysh që sasia e kërkuar është sa për 150 shtëpi. Çmimi i ofruar nga Acvilla është 48.60 euro për m³, me vlerë totale 115,911 euro. Në ofertën e Acvilla ka dy lista të çmimit, njëra është me çmim 115,911 euro ndërsa tjetra me çmim 124,614 euro. Kompania Acvilla do të duhej të shpallej e papërgjegjshme pasi në dosjen e saj ka dorëzuar dy lista të çmimit që nuk janë të njëjta.

ZBATIMI I KONTRATËS

Tenderi për furnizim me dru është monitoruar duke analizuar faturat, pagesat dhe dokumentet tjera. Për një faturë komuna ka bërë zotimin e mjeteve financiare dhe urdhërblerja rreth tre muaj pasi kompania ka filluar furnizimin me dru. Edhe pagesa është bërë në këtë periudhë, e cila e tejkalon afatin ligjor prej 30 ditëve³⁸. Vonesat në pagesa mund të shkaktojnë dëmtim të buxhetit pasi komuna do të mund të detyrohej të paguajë kamatë-vonesë për kompaninë. Një faturë në vlerë 40,726.80 euro nuk është paguar në tërësi, janë paguar vetëm 20,000 euro. Arsyeja që nuk është paguar në tërësi ka qenë që ka mungesë të mjeteve, ndërsa pagesa për pjesën e mbetur do të bëhet më vonë. Edhe për këtë faturë zotimi i mjeteve dhe urdhërblerja është bërë pasi është kryer furnizimi me dru.

Disa nga fletëdergësat e kompanisë Acvilla e kanë të ndryshuar çmimin për metër kub nga 38.70 euro në 48.60 euro. Çmimi 38.70 euro ka qenë çmimi i kontratës paraprake me të njëjtën kompani. Faturat janë paguar në xhirollogari të ndryshme bankare. Pagesa e parë prej 10,011.60 euro është paguar në xhirollogarinë e kompanisë në bankën BpB. Këtë xhirollogari Acvilla e kishte dhënë në Dosjen e Tenderit kur kishte ofertuar. Pagesa në vlerë 66,144.60 është bërë në një llogari të bankës Raiffeisen, edhe pse në dy fatura që lidhen me këtë pagesë, Acvilla në faturë kishte shkruar llogarinë që e ka në bankën BpB. Ky numër i llogarisë ka qenë i shënuar me dorë, dhe përbën rrezik që paratë të përfundojnë në llogari e cila nuk është e autorizuar për pagesat. Sipas nenit 18.1 të Kushteve të Përgjithshme të Dosjes së Tenderit pagesa do të bëhet në llogarinë bankare të dhënë në pjesën Identifikimi Financiar³⁹. Nëse ka ndryshime të të dhënave formulari Identifikimi Financiar duhet t'i bashkangjitet kërkesës për pagesë. Në të gjitha pagesat formulari i bashkangjitur është më të dhënat e llogarisë në bankën BpB. Në lidhje me këtë të gjetur komuna është arsyetuar se:

³⁷ Kontrata me AQP ka skaduar me datën 11 nëntor 2017. Ndërsa komuna ka marr leje për zhvillimin e aktivitetit të ri të prokurimit për furnizim me dru për ngrohje me datën 13 korrik 2017.

³⁸ Neni 18.2 i Kushteve të Përgjithshme së Dosjes së Tenderit për Furnizim. Formulari B27 i KRPP-së. <https://rebrand.ly/b27>




³⁹ Neni 18.1 i Kushteve të Përgjithshme së Dosjes së Tenderit për Furnizim. Formulari B27 i KRPP-së. <https://rebrand.ly/b27>

“Sa i përketë gjetjeve të pagesave në 2 llogari të O.E, kjo gjetje nuk është relevante për faktin, se O.E kanë nga disa llogari në bankat komerciale, dhe Sistemi i Free Balancit lehtësisht i identifikon O.E për llogaritë e tyre. AK bën pages në llogari të O.E sipas identifikimit Financiar të O.E. AK, nuk ka mundësi që të bëjë pagesa në llogari të ndryshme nëse ato nuk janë të regjistruara në Sistemin e Freebalancit (departamenti i thesarit)”

Furnizim me naftë dhe derivate të naftës për Komunën e Pejës

Ky tender është një aneks kontratë pasi kontrata ishte duke përfunduar dhe Komuna kishte nevojë për naftë. Procedura e përdorur është procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Vlera e parashikuar është 50,000 euro për dy (2) muaj. Siç ndodh në të gjithë tenderët për naftë, nuk kërkohet çmimi për litër, por premiumi për litër, i cili është fitimi i kompanisë për litër. Premiumi llogaritet nga mesatarja nga sistemi PLATTS, kompani e cila bën analizë, krahason dhe shet të dhënat për shumë fusha siç janë të naftës, energjisë, gazit, etj. Problemi me sistemin PLATTS është që merren mesatare për naftë nga bursa dhe tregje më të mëdha. Përderisa Komuna nuk ka qasje në këtë sistem është kërkuar nga kompania që ta nxjerrë çmimin. Lejimi që kompania të përcaktojë koston e mbi bazë të koston të aplikohet premiumi, lejon mundësinë për keqpërdorime pasi kostoja e prezantuar nga kompania dhe kostoja reale sipas dokumenteve të importit mund të mos jetë e njëjtë. Aneks kontrata është lidhur me Seferi-Mont me premium prej 0.01 euro për litër.

Sasia e kërkuar është:

-  Dizel për vetura 10ppm – 10,000
-  Dizel për nxemje 10ppm – 80,000
-  Benzin për vetura 10ppm – 5,000

Përderisa vlera e parashikuar ishte 50,000 euro, nuk ka mundësi që këto furnizime të bëhen me këtë vlerë. Premiumi i Seferi-Mont është 950 euro në total. Llogaritja nga PLATTS merr parasysh vetëm koston direkte të naftës siç është transporti, akciza, taksat, TVSH, ndërsa kostot fikse nuk mund të mbulohen me 0.01 euro fitim për litër.

Margjina bruto e fitimit pa shpenzimet operative të kompanisë është $950/50000 = 1.9\%$. Ka të ngjarë që kompania do të fitojë më shumë se 1 cent për litër, pasi nga llogaritja përmes PLATTS çmimi mund të dalë më i lartë se çmimi i tregut⁴⁰.

Në Dosjen e Tenderit siguria e tenderit dhe e ekzekutimit janë kërkuar por nuk janë dhënë afate kohore se sa duhet të vlejë siguria e ekzekutimit të tenderit. Në lidhje me këtë të gjetur komuna ka thënë se kjo është kërkesë mbetet në përgjegjësi të AK, nëse e vlerëson të nevojshme një kërkesë të tillë. Në anën tjetër D+ nuk konteston diskrecionin e komunës për të kërkuar

⁴⁰ Përmes PLATTS kompania mund të bëjë llogaritjen që për shembull litri të kushtojë 1.10 euro, dhe mbi të llogaritet premiumi 0.01 euro. Por kompania realisht mund ta importojë me çmim 1 euro, e në këtë rast fitimi do të ishte 0.11 euro.

ose jo sigurinë e ekzekutimit të tenderit, mirëpo nësë diçka e tillë kërkohet sikur në rastin e këtij tenderi, ajo duhet të ketë validitet kohor për 30 ditë më shumë sesa afati i zbatimit të kontratës. Problemi kryesor në këtë rast është se komuna ka kërkuar sigurim të ekzekutimit, pa specifikuar afatin e vlefshmërisë së saj.

Ndërtimi i ndriçimit publik në disa lagje të qytetit të Pejës, Faza e II-të

Në tenderin për ndërtimin e ndriçimit publik është përdorur procedura e hapur, vlera e parashikuar 67,486 euro, me afat për përfundimin e punëve 16 muaj. Kishin ofertuar katër kompani, ku të gjitha ishin të përgjegjshme sipas vlerësimit të parë. Fitues ishte shpallur grupi i OE BK-Construction & V3-Ing me çmim 50,533 euro. Pas shpalljes së fituesit ka bërë kërkesë për rishqyrtim kompania Risamont me arsyen që fituesit i mungojnë referencat për punë të ngjashme, ku në bazë të kërkesës në DT së paku 50% duhet t'i takojnë udhëheqësit të konzorciumit. Gjithashtu i mungonin certifikatat dhe katalogjet e kërkuara. Kërkesa për rishqyrtim është miratuar dhe tenderi është kthyer në rivlerësim. Pas rivlerësimit fitues është zgjedhur Elmont shpk me çmim 54,665.67 euro. BK-Construction & V3-Ing bën kërkesë për rishqyrtim më 9 tetor 2017, por Komuna ja refuzon me arsyetimin që është bërë pas afatit të lejuar me ligj⁴¹ duke i dhënë edhe arsyet se pse është bërë refuzimi i ankesës. Pra edhe pse kërkesa ka qenë e palejuar (sipas komunës) ajo e ka shqyrtuar edhe themelin e saj, duke e cilësuar të njëjtën si të pa bazuar po ashtu. Njoftimi për Kontratë është përgatitur më 3 tetor 2017, që ka qenë e martë, ndërsa kërkesa për rishqyrtim është bërë të hënën më 9 tetor 2017. Pasi afati për të bërë kërkesën është pesë (5) ditë dhe nëse dita e fundit i bie e shtunë, e dielë, ose festë zyrtare afati duhet të zgjatet deri ditën e parë të punës. Dita e fundit në këtë rast ka qenë e shtunë, pra është dashur të zgjatet deri të hënën. Komuna nuk e ka llogaritur mirë afatin dhe në mënyrë të padrejtë e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim. Por edhe në qoftëse komuna do ta pranonte të njëjtën si të afatshme, prapëseprapë ajo do të refuzohej si e pabazuar. Në DT, në disa pika ka kërkesa për produkte të një kompanie të caktuar pa e përdorur edhe fjalën ekuivalent. KV nuk janë plotësuar fare. Gjithashtu si në tenderët tjerë Njoftimi për Nënshkrimin e Kontratës nuk është bërë.

Në pikën 153, 368 dhe 399 të paramasës është kërkuar mihja e kanalit me dimensione 0.4 x 0.75 x 0.45m që bëjnë 0.135 m³. Në këto pika kanë pasur për tu vendosur 10 shtylla elektrike për një rrugë. $10 * 0.135 = 1.35 \text{ m}^3$, ndërsa sasia e kërkuar është 25 m³. Njëjtë është edhe në pikat 158, 372, 403 ku dimensionet janë $0.8 \times 0.8 \times 0.9 = 0.576 \text{ m}^3$, ndërsa sasia e kërkuar është 17 m³. Kompania fituese Elmont ka ofruar për këto pika çmim prej 10 euro pëdr m³, ndërsa nga Lista e KRPP-së⁴² çmimet për gërmim janë më pak se 5 euro për m³. Komuna duhet të sigurohet që sasi të për punë që do të kryhen të jenë të sakta, pasi eliminohet edhe mundësia për keqpërdorime. Zbatimi i kësaj kontrate ka filluar, por deri më 24 maj 2018 nuk ka ndonjë pagesë të bërë nga ana e komunës.

Ndërtimi i objektit të Shkollës së Mesme të Artit “Odhise Paskali” - Punët e vrazhdta

Tenderi për ndërtimin e shkollës së mesme të artit është parashikuar me vlerë 480,000 euro. Afati për përfundimin e punëve është 15 muaj. Nga dhjetë ofertues, tetë ishin të përgjegjshëm, ndërsa fitues është zgjedhur Armendi-FA me çmim 331,562.30 euro. Si edhe në tenderët më lartë edhe për këtë nuk është publikuar Njoftimi për Nënshkrimin e Kontratës. Në Kontratë, në pikën 10.1 të KV, data për fillimin e punimeve është 9 tetor 2017, ndërsa menaxheri është caktuar më 14 tetor 2017. Menaxheri i Projektit e përgatit planin për menaxhimin e kontratës, i cili duhet të përgatitet para fillimi të zbatimit të kontratës⁴³. Kjo i ka mundësuar kompanisë që për pesë ditë të punojë pa mbikëqyrje nga menaxheri i projektit. Komuna në anën tjetër e mihon këtë të gjetur, duke pretenduar se vetëm data e shënuar është gabim, dhe se menaxheri është caktuar në kohë. Për këtë tender së pari ka pasur konkurs projektimi për ta bërë projektin e shkollës. Por ky projekt

41 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 22.3, Pjesa C (2017). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

<http://rebrand.ly/rroopp>

42 Lista e çmimeve njësi mesatare referent për punë ndërtimore dhe materiale ndërtimore, PN0009-PN0052 (2015). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

<https://rebrand.ly/krpp>

43 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 61.8 (2017). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

<http://rebrand.ly/rroopp>

nuk është ofruar së bashku me DT ashtu siç kërkohet me Udhëzues⁴⁴. Kushtet e Veçanta nuk janë plotësuar, pra nuk është kërkuar as garancion. Pasi kemi të bëjmë më ndërtim të shkollës, garancioni është dashtë të kërkohet për së paku tri vite. Megjithatë, komuna ka ofruar dëshmi se garancioni është kërkuar, në kontratë (jo dosje të tenderit) për një vit kalendarik. Sidoqoft, D+ konsideron se ky afat është minimal dhe komuna do të ishte mirë të kërkonte të paktën tri vite garancion.

Në DT, në paramasë, në pikat 1.4 dhe 5.5 që janë për furnizim dhe lyerje me betolit janë kërkuar që produkti të jetë i prodhimit italian. Në pikat 3.7, 3.8, 5.8, 5.10 janë kërkuar prodhime të kompanive Geberit dhe Rehau, por pa e shtuar edhe fjalën ekuivalent.

Në shumë pika ka dimensione të dhëna gabim nga projektuesi dhe njësia kërkuese, të cilat janë të radhitura më poshtë:

- Në pikën 1.7 është kërkuar kallëpimi, latimi dhe mbushja e themeleve me beton dhe armaturë. Betoni dhe armatura është dashur të ndahen, pasi betoni llogaritet me m³ ndërsa armatura me kg. Sasia e dhënë është 1233.50 m². Pasi mbushja e themeleve nuk e kalon 1m thellësi po të llogaritej me m³ sasia do të dilte më pak.
- Në pikën 1.93 që është për kallëpimin, latimin dhe mbushjen e pllakës mbi themele sasia është dhënë 1161.50 m². Në këtë pikë është dhënë edhe trashësia 20cm. Sasia në m³ do të duhej të ishte 1161.50 * 0.2 = 232.3 m³. Edhe në këtë pjesë betoni dhe armatura është dashur të ndahen.
- Nga pika 2.0 deri 4.0 që ka punë të ndryshme sasia është dhënë e njëjtë 1236 m²
- Në pikën 2.9 që është për kallëpimin, latimin dhe mbushjen e pllakës përdhese me beton dhe armaturë, trashësia është dhënë 22cm. Do të duhej të ishte 1236 * 0.22 = 271.92 m³
- Janë dy pika 4.0. E para është e njëjtë si 2.9 vetëm që është për katin e parë. Edhe këtu sasia duhet të jetë 271.92 m³. Pika e dytë 4.0 është për katin e dytë por sasia është dhënë 479 m². Pasi nuk është dhënë trashësia po supozojmë që është 22 cm sikur pllaka e katit të parë, atëherë sasia duhet të jetë 479 * 0.22 = 105.38 m³
- Në pikën 5.11 dimensionet janë dhënë 300 m² dhe 15 cm trashësi ndërsa sasia e dhënë 50 m³, por duhet të jetë 300 * 0.15 = 45 m³
- Në pikën 5.12 dimensionet janë dhënë 300 m² dhe 60 cm trashësi ndërsa sasia e dhënë 210 m³, por duhet të jetë 300 * 0.60 = 180 m³
- Në pikën 5.14 është kërkuar që të shtrohet zhavorr me trashësi 5cm, por sasia është dhënë me m², ndërsa zhavorrit matet me m³
- Në pikat 6.1, 6.2 dhe 6.3 është dhënë sasia, por pa e specifikuar njësinë matëse.

Të gjitha këto gabime në sasi, përdorimi me m² në vend të m³, mos ndarja e betonit dhe armaturës, bërja bashkë e punëve si muratimi, betonimi, ndërtimi i rrufepritësit kanë bërë që Armendi-FA të ofrojë çmime tepër të ulëta. Në pikën 1.7 ka dhënë çmim 26 euro, që me siguri e ka vërejtur që sasia është me m², ndërsa çmimi në treg për m³ për betonin e kërkuar C25/30 është në mes 50-60 euro. Ndërsa armatura ka çmim rreth 0.90 euro për kg. Në pikën 5.5 që është për lyerje me betolit përfshirë edhe shtresën e dytë, çmimi i ofruar është 25 euro për m², ndërsa nga Lista e KRPP-së çmimet janë nga 13 deri 14 euro⁴⁵. Në pikën 1.4 që është për të njëjtën punë, por me më pak kërkesa çmimi është 1.50 euro m². Për të mos

44 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 20.12, 20.13 (2017). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

<http://rebrand.ly/rroopp>

45 Lista e çmimeve njësi mesatare referent për punë ndërtimore dhe materiale ndërtimore, PNO241 – PNO248 (2015). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

<https://rebrand.ly/krrpp>

ndodhur këto gabime në të ardhmen, Komuna duhet të sigurohet që sasia të llogaritet mirë, të ndahen punët në pozicione të veçanta në paramasë, të përdoret njësia matëse e duhur si dhe të kërkojë sqarime për çmime jo-normalisht të ulëta.

ZBATIMI I KONTRATËS

Për këtë tender, përveç analizimit të faturave, urdhërblerejeve dhe dokumenteve tjera D+ ka monitoruar edhe kryerjen e punëve. Deri më 24 maj 2018 ka qenë e përfunduar pllaka e përdhësës. Dinamika e punimeve ishte e ngadalshme, me vetëm tre punëtorë duke punuar atë ditë. Komuna e ka bërë pagesën për situacionin e parë që përfshin punët për ndërtimin e themeleve. Urdhërblerja është bërë para se të fillojnë punimet, ndërsa pagesa është bërë pasi OE i ka dërguar faturën komunës, pra në përputhje me Rregullën Financiare.

● Shërbimet e telefonisë mobile për nevojat e institucioneve komunale

Tenderi për shërbimet e telefonisë mobile është anuluar pas ankesës së Telekomit të Kosovës në OSHP. Vlera e parashikuar ka qenë 75,000 euro, kontratë kornizë për 36 muaj. TK ka bërë kërkesë për rishqyrtim para se të hapen ofertat. Kërkesa për rishqyrtim është bërë në bazë të Nenin 9.4 të LPP-së⁴⁶ i cili thotë që nëse një shërbim ofrohet nga ndonjë autoritet publik, autoriteti kontraktues duhet të marrë masa që këto shërbime të merren nga autoriteti publik. Kërkesa për rishqyrtim është refuzuar nga Komuna, ku pastaj Telekomit i Kosovës ka bërë ankesë në OSHP dhe është aprovuar⁴⁷. Komuna e ka zbatuar vendimin e OSHP për këtë rast.

Në Dosje të Tenderit dhe paramasë janë disa kërkesa të paarsyeshme:

- Në pikat 1, 2, 3 janë kërkuar nga 10 pako me minuta për secilën pikë, total 30 pako, por më poshtë si shënim është dhënë që 2000 numra do të përfshihen në kontratë. Këto sasi nuk përputhen pasi kërkohej 30 pako e shënohet që 2000 numra do të përfshihen në kontratë.
- Në pikën 4 janë kërkuar telefona të mençur, por nuk janë dhënë karakteristika të tyre. Telefona të mençur ka edhe me më pak se 100 euro e deri në 1000 euro
- OE do të duhej të ofronin me çmim për thirrje në të gjithë operatorët në Kosovë për 30 deri 50% më lirë se tarifat ekzistuese të operatorit. Kjo kërkesë është e paligjshme dhe është tendencë për të diktuar çmimin.

Po të llogarimis që çmimi mesatar në treg për një pako është 15 euro, atëherë $15 * 30 * 36 = 16,200$ euro. Ndërsa për telefona supozojmë që do të jenë të nivelit më të lartë, me çmim 500 euro, atëherë $500 * 25$ telefona të kërkuar = 12,500 euro. Totali është 28,700 euro. Paramasa është e përbërë vetëm nga këto pika, prej 1 deri 4, dhe vetëm për ato mund të jepet çmim. Vlera e parashikuar prej 75,000 euro nuk mund të arrihet as për së afërmi me çmimet e tregut. KV nuk janë plotësuar, ndërsa pasi është shërbim nuk ka nen në DT që e mbulon me Kushtet e Përgjithshme garancionin. Është dashur të kërkohej garancion për telefonat e mençur.

46 Ligji i Prokurimit Publik 04/L-042, Neni 9.4 (2011). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

47 Vendimi 280-17 (2017). Organi Shqyrtues i Prokurimit.

<http://rebrand.ly/280-17>



KOMUNA E GJAKOVËS

Në Komunën e Gjakovës nga tenderët që janë analizuar, D+ ka identifikuar një praktikë të gabuar; mos plotësimi i Kushteve të Veçanta gjatë përgatitjes së Dosjes së Tenderit, por plotësimi i tyre së bashku me Kontratën. Kushtet e veçanta rregullojnë elemente të rëndësishme të kontratës siç janë garancia, dëmet, zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe çështje të tjera të rëndësishme.

Në shumicën absolute të rasteve, kërkohet Siguria e Tenderit, përveç në tenderin për transportin e nxënësve, ku edhe është tërhequr një kompani pas hapjes së ofertave. Në disa tenderë shkaku që është kërkuar qarkullim financiar në kufirin maksimal të ligjit, nuk ka patur oferta dhe tenderët janë anuluar. Në dy tenderë janë identifikuar pika në listën e çmimeve ku ka çmime jo-normalisht të ulëta. Edhe në tenderët e Komunës së Gjakovës ka kërkesa për produkte të një kompanie të caktuar pa shtuar edhe fjalën ekuivalent.

Në tenderin për mirëmbajtjen e rrugëve ka gabime të shumta në llogaritjen e sasive, ku në disa pjesë sasia e dhënë për muaj është më e lartë se sasia për dy vite. Në mirëmbajtjen dimërore, specifikat teknike janë hartuar me shumë gabime, ku kompanitë kanë dhënë çmim më të lartë për shërbim të kombinuar se sa për shërbimet veç e veç. Edhe gjatë zbatimit të kontratës është porositur më shpesh shërbimi për pastrim të borës që ishte 16 herë më i shtrenjtë se shërbimi për pastrim të borës plus hedhja e kripës. Interesi i komunës në këtë rast është dëmtuar, pasi që komuna përdor pa arsye çmimin me të cilin merr më pak në këmbim dhe paguan më shumë në vlerë.

Në tenderin për servisim të veturave, i cili është ritenderuar tre herë, komuna ka zgjedhur fitues një tender me çmime jo-normalisht të ulëta në disa produkte/shërbime edhe në anën tjetër ka çmime shumë të larta në pjesët e tjera. Gjatë zbatimit të kontratës, kompania në 11 fatura ka kryer shërbimet, për të cilat ka ofertuar çmime më të larta sesa ato të tregut (çmime abuzive).

Furnizim me inventar për shkolla

Në tenderin për furnizim me inventar për shkolla kishin ofertuar katër kompani, prej tyre tri ishin të përgjegjshme dhe një e papërgjegjshme. Procedura ishte e hapur, vlera e parashikuar ishte 24,735 euro, ndërsa afati kohor për të përfunduar furnizimin, 30 ditë. Fitues ishte zgjedhur NTP Metali i Ri me çmim 15,155.35 euro.

Në Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit për vitin 2017, vlera e parashikuar është 18,000 euro, ndërsa kur është publikuar Njoftimi për Kontratë, vlera është më e madhe, 24,735 euro.

Njoftimi për Kontratë është publikuar më 16 tetor 2017, ndërsa afati për dorëzimin e ofertave ka qenë deri më 26 tetor 2017. Afati ka qenë 10 ditë, ndërsa sipas LPP duhet që për vlera të mesme të jetë 20 ditë. Kushtet e Veçanta nuk janë plotësuar fare, por janë plotësuar pasi është nënshkruar kontrata. Sipas Udhëzuesit, Neni 18.3⁴⁸ ato duhet të plotësohen

48 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 18.3 (2017). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.
<http://rebrand.ly/rroopp>

kur të përgatitet Dosja e Tenderit.

Në specifikat teknike, kërkesa për tabela shkrimi, kërkohet që ato të jenë të kualitetit të lartë, pa specifikuar se çka është kualiteti i lartë. Në pikën 5 për karrika lëvizëse nuk janë dhënë dimensionet dhe është kërkuar që të jenë me shtof kualitativ, por kërkesë është e pamatshme nëse nuk ofrohen kërkesa specifike se çka konsiderohet kualitative. Te pika 12 janë kërkuar karrika me ngjyra sipas kërkesës, por kërkesa është dashur të bëhet në DT.

Oferta e Metalit të Ri është e njëjtë në të gjitha pikat me ofertën e kompanisë DC Office, përveç në pikën 13.

ZBATIMI I KONTRATËS

Monitorimi i zbatimit të kësaj kontrate është bërë duke kontrolluar vetëm faturat, pagesat dhe dokumentet tjera. Për këtë tender urdhërblert janë me datë para se të kryhet furnizimi, pra janë bërë siç e kërkon ligji. Kontrata është lidhur me çmim 15,115 euro, ndërsa urdhërblert gjithsej kapin vlerën 12,247 euro.

Furnizim me naftë për ngrohje dhe karburante

Tenderi për furnizim me naftë në Planifikimin për vitin 2017 ka qenë i paraparë me vlerë 175,000 euro, por në Njoftimin për Kontratë është 124,500 euro. Ishte përdorur kontrata kornizë me afat gjashtë muaj. Për këtë tender kishin ofertuar dy kompani, që të dyja të përgjegjshme sipas vlerësimit të komunës. Fitues ishte shpallur Petrol Company me çmim 108,315 euro. Tenderi është anuluar një ditë para se të nënshkruhet kontrata, pas kërkesës së bërë nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). Pasi tenderat për furnizim me naftë janë kompetencë e AQP-së, komuna është lejuar që të shpallë tender pas komunikimit të bërë në mes AQP-së dhe komunës. Mirëpo anulimi i aktivitetit të prokurimit një ditë para se të nënshkruhet kontrata bie ndesh me nenin 62.1.1 të LPP-së⁴⁹. Sidoqoftë, anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit sipas komunës nuk është bërë për fajin e komunës, por për shkak të AQP-së.

Në DT janë dy kërkesa që mund të kufizojnë konkurrencën. E para është që vetëm kompanitë që importojnë derivate mund të konkurrojnë. Kjo kërkesë e dëmton në masë të madhe konkurrencën, pasi përjashtohen shumë kompani që shesin naftë, por nuk janë domosdoshmërisht importues vet. E dyta kërkesë kufizuese është që largësia e objektit të jetë jo më larg se 5km nga objekti i Komunës. Edhe kjo kërkesë e kufizon konkurrencën pasi këtë kriter mund ta plotësojnë vetëm kompanitë që pikat e tyre i kanë brenda qytetit. Kompania HIB Petrol edhe pse nuk ka pikë të furnizimit në Komunën e Gjakovës është dashur të shpallë e papërgjegjshme nga Komisioni i Vlerësimit pasi nuk e ka plotësuar kriterin për largësi më pak se 5km.

Çmimi për litër është llogaritur fiks, dhe pasi është për gjashtë muaj, çmimi në treg mund të rritet apo zvogëlohet për këtë periudhë. Praktika është që për këtë lloj furnizimi të përdoret premiumi, që është fitimi i kompanisë për litër. Këtë praktikë e përdor AQP dhe pjesa më e madhe e AK-ve në Kosovë. Në DT është kërkuar Sigurimi i Ekzekutimit, por nuk është dhënë afati kohor, dhe pa afat kohor të kërkuar, kompania do të kishte të drejtë të mos bënte Sigurimin e Ekzekutimit.

Furnizim me një automjet për hemodializë

Tenderi për automjet për hemodializë është anuluar dy herë shkak që asnjë kompani nuk ka ofertuar. Vlera e parashikuar ka qenë 15,000 euro, e që konsiderohet si shumë e ulët duke marrë parasysh që edhe në specifikat teknike të larta të automjetit që janë kërkuar në dosje të tenderit. Në hulumtimet që D+ ka bërë, çmimi për këto lloj automjetesh fillon nga

⁴⁹ Ligji i Prokurimit Publik 04/L-042, Neni 62.1.1. (2011). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

25,000 euro. Komuna arsyeton se ky buxhet ka qenë i planifikuar sipas kërkesës së drejtorisë përkatëse, dhe se për shkak se nuk ka patur rishikim buxheti, ka qenë e pamundur të shtohen mjete financiare në këtë linjë buxhetore.

Në kërkesat për kapacitetin ekonomik dhe financiar është kërkuar që qarkullimi të jetë 30,000 euro, pra maksimumi i lejuar me ligj, që është sa dyfishi i vlerës së parashikuar. Te kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar që operatori ekonomik të ketë së paku dy kontrata të përfunduara të natyrës së ngjashme. Pasi automjetet e dializës nuk kërkohen shpesh, dhe shpesh dhurohen nga organizatat e huaja, kjo kërkesë ka mundur që kufizojë pjesëmarrjen e kompanive.

Garancioni është kërkuar për dy vite, por zakonisht prodhuesit e automjeteve ofrojnë pesë vite ose më shumë. Garancioni është dashur të kërkohet për pesë vite ose të kërkohet aq sa ofron prodhuesi i automjetit.

Nëse Komuna dëshiron që përsëri të shpallë tender për këtë furnizim atëherë duhet që ta rrisë vlerën e parashikuar, t'i zvogëlojë kërkesat për kapacitetin ekonomik, financiar, teknik dhe profesional. Me çmimin e parashikuar prej 15,000 euro mund të blihet vetëm një veturë e vogël apo automjet i përdorur.





Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Komunës së Gjakovës

Komuna e Gjakovës ka shpallur tender për servisim të automjeteve, duke mos i ndarë ato në lloje sipas prodhuesve apo të ngjashme dhe kjo ka ndikuar që të mos ketë oferta të përgjegjshme, të mos aplikojnë bizneset lokale dhe në fund që çmimi të jetë i pafavorshëm. Rrjedhimisht për shkak të kushteve të dosjes së tenderit, tani riparimi i veturave të kësaj komune duhet të bëhet në Prizren dhe jo në Gjakovë.

Servisimet dhe mirëmbajtjet e automjeteve janë tenderët më problematik, shkak që nuk dihet sasia, por kontrata lidhet me çmime për njësi. Kjo ju mundëson kompanive që për servisimin që kërkohet më shpesh, siç është servisimi i vajit dhe filterave të ofrojnë me çmim më të lartë, ndërsa për servisimin që kërkohet më rrallë ofrojnë me çmime shumë më të ulëta se të tregut, pra jo-normalisht të ulëta. Për këtë shërbim katër herë është rishpallur tender derisa është zgjedhur fituesi. Që nga Njoftimi për Kontratë i bërë më 28 mars 2017 e deri në nënshkrimin e kontratës që është bërë më 12 janar 2018 kanë kaluar afërsisht dhjetë (10) muaj.

Procedura ka qenë e hapur, kontratë kornizë për 24 muaj me vlerë të parashikuar prej 55,000 euro.

Në tenderin e parë nuk ka ofertuar asnjë kompani dhe si rezultat është anuluar. Tenderi nuk është ndarë në lloje, ndërsa si kriter i dhënies është përdorur çmimi ekonomikisht më i favorshëm duke e ndarë vlerësimin në:

-  Servisimi i rregullt – 60%
-  Mirëmbajtja dhe pjesët rezervë – 20%
-  Riparim dhe ngjyrosje – 5%
-  Pjesa e karrocërisë – 15%

Si kriter tjetër është kërkuar që nëse punëtorja e kompanisë është më larg se 5km nga Komuna e Gjakovës, atëherë bartjen e automjeteve për në punëtori dhe anasjelltas duhet ta bëjë kompania. Po ashtu kriteri tjetër është që automjeti për bartjen e automjeteve të jetë i kompanisë, ndërsa ka mundur të lejohet që të merret edhe me qera.

Komuna nuk ka kërkuar autorizim nga prodhuesi apo dileri i autorizuar për servisimin e automjeteve, apo që pjesët të jenë origjinale. Kjo është dashur të kërkohej pasi montimi i pjesëve të përdorura bën që ato të prishen më shpesh dhe shtohet nevoja që të ketë servisim më të shpeshtë.

Kushtet e Veçanta nuk janë plotësuar. Mirëpo në DT për Shërbime nuk ka periudhë të garancionit në KP, dhe pasi KV nuk janë plotësuar nuk ka as garancione të kërkuar. Për këtë lloj shërbimi garancioni duhet të kërkohej patjetër duke marrë parasysh sa shpesh riparohen automjetet.

Në tenderin e dytë është bërë ndarja në dy lloje, automjetet e Komunës në një lloj dhe automjetet e QKMF-së në llojin tjetër. Në të dy llojet ka automjete që janë të njëjta. Ndarja në lloje do të mund të bëhej sipas madhësisë së automjetit, ose sipas prodhuesit. Komuna në vend që të ul kërkesat për qarkullim financiar, duke marrë parasysh që në tenderin e parë nuk ka pasur asnjë ofertë, në tenderin e dytë i ka rritur. Përderisa në tenderin e parë kërkesa për qarkullim financiar ishte 55,000 euro, në dytin është rritur në 60,000 euro për lloj 1 dhe 40,000 euro për lloj 2. Një ndryshim tjetër është që tani si kriter është përdorur çmimi më i ulët. Gjithashtu është hequr edhe kërkesa për sigurinë e tenderit. Edhe në tenderin e dytë kushtet e veçanta nuk janë plotësuar.

Edhe pse Komuna ka bërë shumë ndryshime në DT, në disa pjesë duke rritur kriteret e në disa duke i ulur, prapë asnjë kompani nuk ka ofertuar dhe tenderi është anuluar. Në tenderin e tretë prapë ka ndryshime në kriteret. Kontrata kornizë me një operator ekonomik është ndryshuar në kontratë kornizë me disa operatorë, duke përdorur mini konkurrencë për ekzekutimin e kontratës. Ndarja në lloje nuk është ndryshuar. Kërkesat për qarkullim financiar janë hequr. Kriter për dhënie është aplikuar përsëri çmimi më i ulët.

Në tenderin e tretë ka ofertuar një konzorcium por është shpallur i papërgjegjshëm shkaku që njëra nga kompanitë përbërëse të konzorciumit nuk e kishte nënshkruar deklaratën nën betim. Si rezultat tenderi është anuluar përsëri. Në tenderin e katërt përsëri ka ndryshime në kriteret. Tani është përdorur kontrata kornizë me një operator, siç ishte në tenderin e parë dhe të dytë. Kriteret tjera janë të njëjta si në tenderin e tretë.

Në këtë tender kanë ofertuar dy operatorë, konzorciumi që ishte eliminuar në tenderin e tretë dhe kompania DPZ Auto Ford që është shpallur edhe fituese. Oferta e Auto Ford ishte 35,621.21 euro për lloj 1 dhe 12,031.13 euro për lloj 2. Konzorciumi i papërgjegjshëm përsëri është eliminuar për të njëjtën arsye. Komuna ia ka kërkuar deklaratat nën betim të nënshkruara duke u bazuar në nenin 72 të LPP-së që ka të bëjë për sqarime shtesë, por nuk kanë kthyer përgjigje në email.

Më 14 Dhjetor 2017, Komisioni i Vlerësimit ka vërejtur që ka gabim në formulën e përgatitur nga Njësia e Kërkesës. Gabimi ka ndodhur në një formulë në Excel e cila nuk është shkruar si duhet dhe ka dhënë rezultat të gabuar. Komuna kërkon interpretim nga KRPP. Pyetja ishte "A mund të vazhdohet me vlerësim të ofertave pavarësisht që gabimi aritmetikor, në çmimin total mund të jetë më tepër se 2%?". KRPP kthen përgjigjen duke këshilluar që në rastin konkret të merret vendim në përputhje me rrethanat e krijuara dhe në përputhje me dispozitat e LPP-së. Në LPP nuk ka nene që rregullojnë nëse gabimet që janë në DT vërehen gjatë procesit të vlerësimit. Gabimet nga AK mund të korrigjohen vetëm para hapjes së ofertave.

Në Procesverbalin e Hapjes çmimi i dhënë nga Auto Ford është 31,994.81 euro për lloj 1 dhe 10,831.13 euro për lloj 2. Në Raportin e Vlerësimit çmimi është ndryshuar në 35,621.21 euro dhe 12,031.13 euro. Llogaritja e re është bërë pasi në pikën për servisim të rregullt që ka peshën 60%, çmimi total është ndryshuar nga 720 euro në 6,746 euro për lloj 1 dhe nga 240 euro në 2,240 euro në lloj 2.

Siç u përmend më lart kur nuk dihet sasia, atëherë kontrata lidhet me çmime për njësi. Kjo mundësohet nga Neni 56.1 i Udhëzuesit⁵⁰, ku thotë që çmimi total i poentuar shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi.

Nga shikimi i ofertës së kompanisë Auto Ford vërehet se artikujt dhe shërbimet të cilat shfrytëzohen më rrallë janë ofertuar me çmime shumë të ulëta, përderisa e kundërta ka ndodhur me artikujt dhe shërbimet më të zakonshme ku çmimet në shumë

50 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 56.11 (2017). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.
<http://rebrand.lv/rroopp>

raste janë shumë më të larta se ato të tregut. Në shumë raste pavarësisht markës së veturës pjesët kanë çmime të njëjta. Në treg këto çmime dallojnë dukshëm varësisht nga prodhuesi dhe marka e veturës. Për të gjitha automjetet shërbimi i servisimit të rregullt është ofertuar me 200 euro (shërbim i cili përfshinë ndërrimin e vajit, filterat e vajit, naftës, ajrit dhe klimës si dhe puna e dorës). Për automjetet që i posedon komuna (Golf V, Golf VI, Dacia Sandero, etj.), në treg, servisimi kushton më pak se 100 euro.

Në tabelën më poshtë janë disa nga pjesët kryesore të automjeteve ku ofrohen çmime shumë të larta dhe jo-normalisht të ulëta:

Përshkrimi	Çmimi për njësi	Çmimi në treg	I lartë / ulët
Servisimi i rregullt	euro 200.00	euro 100.00	Lartë
Litri i vajit	euro 20.00	euro 5.00	Lartë
Larja	euro 8.00	euro 3.00	Lartë
Uji për xhama / litër	euro 2.00	euro 0.50	Lartë
Antifrizi / litër	euro 20.00	euro 3.00	Lartë
Fshisat e xhamit	euro 25.00	euro 5.00	Lartë
Fellnet metalike / aluminit	euro 0.10	euro 30.00	Ulët
Cilindër i frenit para dhe pas	euro 0.10	euro 30.00	Ulët
Lladnjaku	euro 1.00	euro 100.00	Ulët
Motorri i fshisave të xhamit	euro 1.00	euro 50.00	Ulët
Koka e motorrit	euro 1.00	euro 150.00	Ulët

TABELA 5. Dallimet në mes çmimeve të Auto Ford dhe çmimeve të tregut

Servisimi i rregullt i automjeteve bëhet çdo 10,000 km, që do të thotë që servisimi do të bëhet së paku një herë në vit. Pasi kontrata është për dy vite dhe janë 32 automjete që kanë për t'u servisuar, çmimi i dhënë është 12,800 euro, ndërsa me çmime të tregut do të ishte 6,400 euro.

Në shumicën e pikave, çmimet jo-normalisht të ulëta janë me vlera 0.10 euro ose 1 euro. Në mënyrë që komuna të balanconte humbjet e krijuara nga çmimet abuzive në disa pozicione të ofertës, alternativë do të ishte që në fazën e zbatimit të kontratës të kërkonte shfrytëzimin edhe të pikave ku operatori ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta. Për shembull nëse komuna do të ndrronte të gjitha fellnet e veturave të komunës asaj do t'i kushtonte vetëm 3.2 euro, pasi që kompania ka ofruar ndërrimin e tyre për vetëm 0.10 euro për njësi. Pasi kur nuk dihet sasia, nuk mund të përdoret kufiri prej +-30%, ndërsa çmimi total shërben vetëm për poentim se cili operator e ka ofertën më të lirë, çfarëdo përqindje tjetër e poentimit po të përdorej çmimi për njësi nuk ndryshon. Kur kemi të bëjmë me çmime për njësi, duhet patjetër që komisioni i vlerësimit

të shikojë çmimin e tregut për secilën pikë në paramasë në mënyrë që të sigurohet që çmimet do të jenë reale, sikur një në mënyrë që të mos kemi dëmtim të buxhetit publik.

ZBATIMI I KONTRATËS

Në kontratën për servisim të automjeteve, ku kishte fituar operatori ekonomik (OE) Auto Ford shumica e çmimeve për njësi janë 0.01 euro ose 1 euro. Faturat dhe pagesat që D+ ka patur qasje janë deri më 14 prill 2018. Zbatimi i kontratës është monitoruar vetëm duke analizuar dokumentet, pa i verifikuar edhe fizikisht automjetet e servisuara. Pretendimi që disa çmime kanë qenë të manipuluar, konfirmohet nga fakti që komuna ka porositur vetëm shërbime, ndërrim të pjesëve ku OE ka ofruar me çmime të tregut ose me çmime më të larta, përveç një fature ku është ndërruar një pjesë që kishte çmim 1 euro. Porositja e shërbimeve ku çmimet janë të larta dhe abuzive e dëmton buxhetin e komunës në masë të madhe. Komuna nuk është dashur të lidh një kontratë e cila përmban çmime të tilla. Mirëpo përgatitja e tillë e dosjes së tenderit i ka mundësuar kompanisë që të aplikojë çmime të tilla. Për këto çmime operatori është dashur të mos shpërblehet me kontratë, për të ruajtur buxhetin. Mirëpo, pasi tenderi ka dështuar disa herë dhe komuna ka qenë e detyruar të lidh një kontratë servisimi, alternativë mbetet që të kërkohen artikujt të cilët janë ofruar me çmime jo normalisht të ulëta.

Kontrata ka pika të cilat janë shumë të ngjashme dhe ngatërrojnë faturimin e komunës. Pika e parë është Neni 2.2 i cili thotë se kontraktuesi do ta bëjë pa pagesë bartjen e automjetit me merimangë në rast të defektit në rrugë dhe pozicioni B140 në paramasë i cili thotë se Tërheqja e automjetit prej vendit të ngarkimit deri në servis do ti faturohet komunës me tetë euro për kilometër. Dy faturat e shikuara nuk specifikojnë se prej cilit vend është bartur automjeti, por distanca e faturuar është 28 kilometra. Përderisa në tenderin e parë, nuk ishte lejuar faturimi në mbi 5 km i komunës për bartjen e mjeteve deri në punëtori, në tenderin e fundit është shtuar edhe ky pozicion, i cili në shumë raste mund t'i kushtojë komunës më shumë sesa shërbimi i servisimit.

Në 11 fatura të analizuar, të gjitha e kanë një pozicion “të jepet çmimi për identifikimin e prishjeve të mundshme”, duke kontrolluar frenat, dritat, rrotat, etj me çmim 50 euro. Pra ky çmim është vetëm për identifikimin e prishjeve dhe jo rregullimin e tyre. Prishjet që janë identifikuar nuk janë të shënuara në faturë apo ndonjë dokument tjetër. Sipas hulumtimeve të bëra në kompani që merren me servisim të automjeteve, ky identifikim nuk zgjat më shumë se gjysmë ore dhe çmimi 50 euro është çmim shumë i lartë. Pasi ky çmim përsëritet në të gjithë faturat, besojmë që komuna edhe në të ardhmen do të ngarkohet me të njëjtën vlerë për të gjitha kontrollat.

Të gjitha kërkesat, zotimet dhe urdhërblertjet janë bërë për rreth 50 ditë më vonë se faturat e pranuar. Komuna në këtë rast ka porositur servisimin e automjeteve pa pasur mjete financiare të zotuara. Hyrja në obligime pa i siguruar mjetet financiare mund të rezultojë në vonesa në ekzekutimin e pagesave si dhe rritjen e obligimeve të papaguara.

Mirëmbajtja e Autorrugëve

Tenderi për mirëmbajtje të rrugëve ka qenë i ndarë në tre lloje: mirëmbajtja verore e rrugëve, mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane dhe mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale. Në të tri llojet specifikat teknike janë hartuar me shumë gabime, si në sasi, në njësinë matëse dhe në llogaritje. Në llojet për mirëmbajtjen dimërore, komuna ka porositur shërbimin me çmimin më të shtrenjtë në shumicën e faturave, ndërsa ka mundur të kursehet buxheti duke porositur shërbimin më të lirë. Çmimi i ofruar nga kompania për pastrimin e borës është 16 herë më i lartë se çmimi për pastrimin e borës, por tani përfshihet edhe hedhja e kripës. Me kontratë kornizë vlera totale nuk lejohet të tejkalohet për +-30%, ndërsa vlera për secilin pozicion në paramasë mund të tejkalohet me kusht që mos të tejkalohet kufiri prej +-30% i vlerës totale⁵¹. Komuna po të porositiste vetëm shërbimin për pastrim të borës plus hedhje të kripës, që kishte çmim prej 5 euro, do t'i kursente 48,750 euro.

51 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 56.10 (2017). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.
<http://rebrand.lv/rroopp>

Vlera e parashikuar ka qenë 341.136.28 euro, kontratë kornizë për 24 muaj. Mirëpo nuk janë dhënë vlerat e parashikuara për secilin llot. Sipas komunës kjo ka qenë e pamundur për shkak se platforma e e-Prokurimit ende nuk e mundëson këtë. Në Njoftimin për Kontratë është përdorur afati i shkurtuar për dorëzimin e ofertave me arsyen se jemi shumë afër sezonit të dimrit dhe mund të kemi reshje të borës. Në DT shkruan që DT është dorëzuar më 29 shtator 2017 në KRPP, ndërsa në e-prokurim shkruan që është dorëzuar më 5 tetor 2017. Pra vetë Komuna është vonuar, ndërsa është dashur që më herët të fillojë aktivitetin e prokurimit.

Fitues për llot 1 është shpallë Kompania Regjionale e Mbeturinave Çabrati me çmim 159,561.14 euro. Çmimi është dhënë me TVSH 8%, por në Ligjin mbi TVSH-në ky shërbim nuk është në listë të produkteve që mund të përdorin normën 8%⁵². Për llot 1 kishin ofertuar pesë operatorë, ndërsa vetëm Çabrati ishte shpallur i përgjegjshëm. Të tjerët ishin të papërgjegjshëm. Katër nga ofertat e papërgjegjshme kishin çmim më të lirë se Çabrati. Këta operatorë janë shpallë të papërgjegjshëm për mungesë të dokumenteve siç janë Deklarata e TVSH-së, kërkesat nga kapaciteti teknik dhe profesional. Komuna ka përdorur nenin 72 të LPP-së për të kërkuar informata shtesë, ku disa nga OE nuk janë përgjigjur. Komuna për të gjitha ofertat është udhëzuar nga Neni 39.8 i Udhëzuesit⁵³ që jep udhëzime se si duhet të vepohet kur ka mungesë të dokumenteve. D+ ka shikuar të gjitha ofertat që janë shpallë të papërgjegjshme dhe kemi vërtetuar që këta operatorë kanë mungesë të dokumenteve. Tenderi për llot 2 dhe 3 është anuluar pasi të gjitha ofertat kanë qenë të papërgjegjshme, për tu shpallur përsëri.

Në specifikat teknike për llot 1 ka detaje të shumta se si duhet të pastrohen rrugët, ndërsa në tabelë janë paraqitur edhe dimensionet e rrugëve. Por nuk janë dhënë data se kur llogaritet mirëmbajtje verore. Në bazë të tabelës numri i larjeve për një muaj është 1, ndërsa për dy vite është 10. Pra kemi dy sezone të verës me nga pesë muaj.

Dimensionet e rrugëve të pjesa I-rë e paramasës janë të llogaritura mirë pasi është dhënë gjatësia e rrugës dhe gjerësia e rrugës së bashku me trotuar. Mirëpo në pjesën e II-të, nga pika 1 deri 42 gjerësia e rrugës së bashku me trotuar është dhënë në shumicën e pikave 2 ose 4m, e vetëm në disa 6m. Dihet që rruga së bashku me trotuar është së paku 7m, e për rrugë kryesore që janë me katër (4) korsi qarkullues gjerësia është më e madhe.

Në pjesën II të paramasës, pikat 1 deri 42 (përveç pikës 3a dhe 3b), numri i fshirjeve për dy vite është 18 fshirje, ndërsa për muaj në shumicën e pikave është 4 (katër) fshirje e në disa (dy) 2 fshirje. Pasi kishim pesë muaj brenda sezonit veror, atëherë totali duhet të jetë $5 \cdot 4 \cdot 2 = 40$ larje, dhe ku ishte 2 fshirje në muaj $5 \cdot 2 \cdot 2 = 20$ fshirje. Në pikën 3a dhe 3b numri i fshirjeve në muaj është 22. Në bazë të kësaj vlere del që do të ketë më shumë fshirje në muaj se për dy vite. Komuna arsyeton se vetëm përshkrimi i shërbimit është bërë gabim teknik, pasi që numri 18 nuk nënkupton numrin e fshirjeve ashtu sic thuhet në kontratë, por është numri i fshirjeve shumëzuar 18 muaj.

Pikat 44 deri 49 nuk kanë të bëjnë me fshirje të rrugëve, sasia është shkruar me copë ose m³, por në tabelë është lënë numri i fshirjeve në muaj dhe numri i fshirjeve për dy vite. Sasia për 2 vite është në të gjitha 20, përveç në pikën 44 që është 10. Ndërsa sasia për muaj është më e madhe se sasia për dy vite. Gabimet në këto dy kolona të paramasës bëjnë që shembull në pikën 45 ku parashihet transporti i mbeturinave për m³, sasia e kërkuar për muaj është 26 m³, ndërsa për dy vite 20 m³. Këto gabime në paramasë e bëjnë kontratën të pazbatueshme, pasi në pikat ku sasia për muaj është më e madhe se për dy vite, do të tejkalohet sasia e parashikuar.

Shembulli tjetër është në pikën 49 që është për pastrimin e ujëmbledhësve atmosferik dhe gypit deri në kolektorin kryesor, ku sasia për një muaj është 300 copë, ndërsa për dy vite 20 copë.

Pasi llot 2 dhe 3 ishin anuluar, janë ritenderuar, ku vlera e parashikuar ishte 144,600 euro. Procedura ishte e hapur, kontratë kornizë për 24 muaj, ndërsa prapë nuk është dhënë vlera e parashikuar për llot. Nga katër oferta, vetëm dy ishin të përgjegjshme. Fitues për llot 2 për mirëmbajtjen dimërorë të rrugëve urbane ishte konzorciumi D&T Group & Florida me çmim 47,300 euro, ndërsa për llot 2 për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve rurale ishte konzorciumi Berisha Com & Drini Company me çmim 58,500 euro. D&T Group & Florida në tenderin e parë kishte ofertuar me çmim 103,200 euro, ndërsa në tenderin e dytë fitoi me çmim 47,300 euro. Në tenderin e parë ky konzorcium ishte shpallë i papërgjegjshëm për mungesë dokumentacioni dhe mosplotësim të kriterëve siç ishin licenca për menaxhim të mbeturinave, pajisjet nuk i plotësonin kriteret dhe shumica ishin pa afat të regjistrimit.

52 Ligji Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar/Shtojca.(2016). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11015>

53 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 39.8 (2017). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

<http://rebrand.ly/rruopp>

Në specifikat teknike për llot 2, përshkrimi i shërbimit është pastrimi i rrugëve nga bora dhe hedhja e kripës. Si praktikë e mirë është që Komuna ka kërkuar të pastrohen edhe trotualet, vendet ku janë të vendosura kontejnerët, ndërsa vetëm kur të pastrohen të gjitha këto llogaritet si pastrim. Në shumicën e Komunave, D+ ka parë që trotualet nuk pastrohen dhe zakonisht janë bizneset që e pastrojnë para lokalit të tyre.

Në specifikat teknike për rrugët urbane, të gjitha rrugët janë dhënë me gjatësi që përfundojnë me 00 ose 50, psh 250m, 300m. Nuk mund të jenë të gjitha rrugët kështu, pra matja nuk është e saktë. Dimensionet e rrugëve janë dhënë me metër gjatësi, krahasuar me llot 1 ku ishte dhënë gjatësia dhe gjerësia.

Pasi pastrim llogaritet e gjithë sipërfaqja e rrugës dhe trotuari, specifikimi me metër gjatësi është mbuluar nga kjo fjali. Por kjo ju pamundëson OE që të dinë saktë sipërfaqen e rrugëve, kur dihet që jo të gjitha rrugët e kanë gjerësinë e njëjtë. Hedhja e kripës është matur për km, ndërsa duhet të parashikohet me kg, pasi kompania mund të hedhë krip për një km, por nuk dihet se sa do të hedhë. Gjatësia totale e rrugëve është 61.567 km, ndërsa të gjitha rrugët parashikohen që të pastrohen 12 herë brenda sezonës, pra 24 herë për 2 vite.

Totali i kilometrave që parashikohen për tu pastruar duhet të jetë $61.567 * 24 = 1477.608$ km, por në paramasë dhe kontratë vlera është 1290 km.

Në ofertën e D&T Group & Florida, çmimet janë:

- Pastrimi nga bora dhe akulli – 35 euro / km
- Pastrimi nga bora dhe akulli plus hedhja e kripës – 60 euro / km
- Vetëm hedhja e kripës – 15 euro / km

Dy shërbimet e përbashkëta kanë çmim më të lartë se shërbimet veç e veç, që është përtej logjikës që përdoret në treg. Në praktikë nëse dy shërbime kombinohen atëherë ato gjithmonë duhet të kushtojnë më lirë⁵⁴. Pastrimi nga bora dhe akulli plus hedhja e kripës do të duhej të kishte çmim më të ulët se 50 euro, pasi dy shërbimet tjera bashkë bëjnë 50 euro (35 + 15). Dyshimi është që kompania ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta në pikën 1 dhe 3.

Është më lirë për Komunën që të kërkojë shërbimin për 1 dhe 3, pasi paguan 50 euro për km, në vend të 60 euro që do të paguante po të kërkohej shërbimi në pikën 2. Edhe konzorciumi Horn & Co. Kosova & Viktory Com që është cilësuar i papërgjegjshëm, ka tentuar të fitojë me çmime jo normalisht të ulëta, ku ka ofruar me 110, 10 dhe 5 euro.

Në specifikat teknike për llot 3, që është për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve rurale, totali i gjatësisë së rrugëve është 245 km.

Distancat për fshatra janë dhënë me numra të plotë, e nuk mund të jetë distanca në të gjithë fshatrat me numra të plotë, si psh. 7 km, 1 km, etj. Rrugët parashihen që të pastrohen 10 herë brenda sezonit, pasi kontrata është për dy vite, atëherë janë 20 pastrime.

Totali i kilometrave që parashikohen për tu pastruar duhet të jetë $245 * 20 = 4900$ km, por në paramasë dhe kontratë vlera është 1950 km. Në kontratë çmimi është 47,300 euro, ndërsa ky konzorcium ka ofertuar me 58,500 euro.

Në ofertën e Berisha Com & Drini Company, çmimet janë:

- Pastrimi nga bora dhe akulli – 80 euro / km
- Pastrimi nga bora dhe akulli plus hedhja e kripës – 5 euro / km
- Vetëm hedhja e kripës – 5 euro / km

⁵⁴ Shembull mund të merret kombinimi i shërbimit të internetit me televizionin digjital. Në treg çmimi i kombinuar është më i lirë se çmimet veç e veç.

Shërbimi i parë ka çmim tejet të lartë krahasuar me çmim të llot 2, kur merren parasysh që rrugët rurale janë më të ngushta dhe shumica nuk kanë trotuare. Në pikat 2 dhe 3 ka çmime jo-normalisht të ulëta, e gjithashtu nuk ka logjikë që çmimi për pikën 3 të jetë i njëjtë me pikën 2. Komuna për të kursyer buxheti do të duhej të porosiste vetëm shërbimin në pikën 2, pasi kjo pikë i përfshin pikën 1 dhe 3. Por siç është cekur më poshtë gjatë zbatimit të kontratës është porositur më së shumti shërbimi në pikën 1.

Konzorciumi Horn & Co. Kosova & Viktory Com që është cilësuar i papërgjegjshëm, prapë ka ofertuar me çmime jo-normalisht të ulëta, ku ka ofruar me 89 dhe 1 euro në dy pika tjera. Në këtë rast gjithmonë ekziston rreziku që njësia e kërkesës të bëjë kërkesa vetëm sa i përket pozicionit më të shtrenjtë dhe në këtë formë, çmimi kthehet në abuziv, edhe pse në mesatare nuk duhet si i tillë.

Vetëm OE tjetër i papërgjegjshëm, Kompania Lekaj ka ofruar me çmime më normale, përkatësisht me 27, 35 dhe 32 euro.

Komuna e Gjakovës nuk është dashur të pranojë këto çmime dhe do të duhej të kërkonte sqarime nga OE. Pasi i ka pranuar ofertat e tyre do të duhej të sigurohej që maksimalisht të mos dëmtohet buxheti. Për llot 3, pasi për shërbimin e kombinuar operatori fitues ka dhënë çmim 5 euro për km, komuna duhet ta kërkojë shërbimin vetëm për këtë pikë.

Pasi paramasa nuk është e përgatitur mirë, ju ka mundësuar OE që të ofrojnë me çmime jo-normalisht të ulëta. Pasi nuk dihet saktë se sa herë bie borë gjatë dimrit dhe mund të ndryshojë nga sezoni në sezon, kontrata është dashur të lidhet me çmime për njësi, ku nuk dihet sasia e kërkuar, ndërsa të tre shërbimet të poentohen në mënyrë që të zgjidhet OE fitues. Gjithashtu sasia e kripës duhet të llogaritet me kg, e jo për km. Për të përgatitur specifikat teknike sa më mirë Komuna e Gjakovës duhet të marrë si shembull për të njëjtin shërbim tenderin e Komunës së Vushtrrisë, i cili është përgatitur shumë mirë, duke përdorur njësi matëse të duhura dhe duke e parashikuar se sa ditë brenda vitit ka reshje bore.

ZBATIMI I KONTRATËS

Kontrata për lot 1, që është për mirëmbajtjen verore të rrugëve urbane është lidhur me kompaninë Çabрати. Pastrimi i rrugëve është paraparë të bëhet në sezonin veror – vjeshtor. Çabрати ka bërë pastrim të rrugëve në muajin dhjetor, i cili muaj është në sezonin dimëror. Urdhërblerja është lëshuar rreth 45 ditë pasi është kryer shërbimi. Kjo do të thotë që shërbimi është kryer pa u zotuar mjetet financiare.

Çmimet e dhëna nga Çabрати kanë TVSH me normë prej 8%, ndërsa në dy lotet tjera kompanitë kanë dhënë TVSH me normë 18%. Kjo nënkupton që komisioni i vlerësimit nuk i ka verifikuar normat e TVSH-së të dhëna nga ofertuesit. Kontrata për llot 2 është lidhur me konzorciumin D&T Group & Florida e cila kishte ofruar me çmim 47,300 euro. Lot 2 është për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve urbane. Kjo kontratë është kontratë kornizë dy vjeçare me afat deri më 20 janar 2020, pra përfshihet sezoni dimëror për vitin 2019 dhe një pjesë e sezonit për vitin 2020. Vetëm këtë sezon konzorciumi fitues ka kryer shërbime në vlerë 31,786.06 euro. Edhe po të rritet sasia për 30%, që është e lejuar me kontratë kornizë, komuna do të ketë probleme në zbatimin e kësaj kontratë pasi shumica e mbetur në dispozicion është 29,703.94 euro për një sezon e gjysmë të mbetur.

Sasia e parashikuar dhe çmimet e dhëna nga OE fitues janë në tabelën e mëposhtme:

Nr	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total
1	Pastrimi nga bora dhe akulli	Km	430	35 euro	15,050 euro
2	Pastrimi nga bora dhe akulli plus hedhje e kripës	Km	430	60 euro	25,800 euro
3	Vetëm hedhje të kripës	Km	430	15 euro	6,450 euro
Gjithsejt					47,300 euro

TABELA 6. Oferta e D&T Group & Florida

Nga dy fatura të analizuar pozicioni dy që është për pastrim nga bora dhe akulli plus hedhje të kripës e ka tejkalar sasinë për 157.72 kilometra. Sasia e llogaritur nga këto dy fatura është 587.72 kilometra. Edhe po të shtohet sasia për 30% e cila për kontratat kornizë lejohet, prapë sasia do të tejkalohej për 28.72 kilometra. Tejkalmi i sasisë, kur kanë mbetur edhe një sezon e gjysmë që kontrata të përfundojë do të paraqesë probleme të mëdha gjatë zbatimit të kësaj kontrate.

Ashtu edhe siç pritet në raste të tilla, Komuna ka porositur më shpesh pozicionin dy përkatësisht atë më të shtrenjtë dhe më të dëmshëm, ndërsa pozicioni një dhe tre së bashku kanë çmim më të ulët. Nëse komuna do të porosiste pozicionet 1 dhe 3 ajo do të merrte të njëjtin shërbim me më pak shpenzime dhe do të kursente buxhetin e saj. Edhe në këtë kontratë punët janë kryer para së të zotohen mjetet. Njëra faturë e ka diferencën kohore në mes datës së faturës dhe datës së urdhërbljes 50 ditë. Kontrata për lot 3, që është për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve rurale është lidhur me konzorciumin Berisha Com & Drini Company. Kontrata është lidhur me çmim 47,300 euro, ndërsa oferta e këtij OE është 58,500 euro. Sipas nenit 4.1 të kontratës, përparësi si dokument ka Kontrata, prandaj në këtë rast çmimi prej 47,300 euro do të duhej të vlente.

Sasia e parashikuar dhe çmimet e dhëna nga OE fitues janë në tabelën e mëposhtme:

Nr	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total
1	Pastrimi nga bora dhe akulli	Km	650	80 euro	52,000 euro
2	Pastrimi nga bora dhe akulli plus hedhje e kripës	Km	650	5 euro	3,250 euro
3	Vetëm hedhje të kripës	Km	650	5 euro	3,250 euro
Gjithsejt					58,500 euro

TABELA 7. Oferta e Berisha Com & Drini Company dhe çmimet për njësi

Edhe në këtë rast komuna ka porositur më shumë shërbimin në pozicionin një. Secili person do ta vërente që pozicioni dy përfshin pozicionin një plus hedhje të kripës e ndërsa çmimi është 5 euro. Në pastrimin që e ka bërë kompania për tri ditë në muajin janar i ka faturuar komunës 27,780 euro, ku vetëm 20 euro janë për hedhje të kripës, ndërsa 27,760 euro janë për pastrim nga bora dhe akulli. Në mënyrë që të mos dëmtohet buxheti, komuna duhet të porosisë shërbimin në pikën 2, e në rast që kompania refuzon të kryejë shërbimin, të shkëputet kontrata dhe ky shërbim të ritenderohet.

Anëtarët e komisionit të pranimit janë personat e njëjtë si te kontrata për lot 2. Mirëmbajtja e rrugëve për lot 2 dhe 3 është bërë në të njëjtat ditë, më 20, 21 dhe 22 janar 2018. Komisioni i pranimit i ka aprovuar të dy situacionet për këto ditë. Komisioni nuk ka mundur të njëjtën ditë të verifikojë se a janë kryer këto shërbime kur kemi parasysh që njëri shërbim është për pastrim të rrugëve urbane e tjetri për rrugë rurale. Si duket ky verifikim nuk është bërë në mënyrë të duhur dhe profesionale.

EDHE PËR KËTË LOT URDHËRBLERJA ËSHTË LËSHUAR RRETH TRE JAVË PASI ËSHTË KRYER SHËRBIMI I MIRËMBAJTJES.

Arsyetimi i plotë i komunës thotë:

Sipas planit për veprim, operatori është udhëzuar që të veprojnë me hedhje të kripës gjatë rënies së temperaturave atëherë kur kemi ngrica të rrugëve sidomos në tatëpjeta dhe përpjeta. Janë caktuar rrugët me prioritet që duhet të pastrohen dhe që duhet të bëhet hedhja e kripës fillimisht pastaj largimi i borës.

Hedhja e kripës është bërë para se të fillojnë reshjet e borës, kjo për shkak se me rënien e borës nuk duket të ketë akull në sipërfaqen qarkulluese. Pas shtresimit të borës për rreth 10 cm apo më shumë, ka filluar pastrimi i saj pa hedhje të kripës. Hedhja e kripës duhet të jetë minimale për shkak se si e tillë e dëmton shtresën e asfaltit duke e gërryer dhe duke hapur gropa. Andaj, si çdo vit operatorët që kanë bërë pastrimin dimërorë të rrugëve janë udhëzuar që të hedhin kripë në sasi minimale për shkak se kripa e dëmton rrugën.

SIPAS SITUACIONEVE TË DORËZUARA DHE PROCESIVE TË PRANIMIT TË PUNIMEVE OE GJATË SEZONËS DIMËRORE 2018 KA KRYER KËTO PUNIME:

833KM – Pastrim nga bora dhe akulli
266KM – Vetëm Hedhje të Kripës

Pas shtresimit të borës për rreth 10 cm apo më shumë, ka filluar pastrimi i saj pa hedhje të kripës. Pastrimi është bërë në zonat e thella malore-zonën kufitare, në rrugët e fshtrave:

Vlen për tu theksuar se Komuna e Gjakovës kufizohet me numerikisht me 86-fshatra kryesisht rrugët të pa asfaltuara si dhe konfiguracioni i terrenit është i ashpër, gjatë gjithë kohës me reshje të borës edhe fshatrat më të larta kanë pasur rrugët e hapura dhe komunikim të përhershëm me qytetin. Si dëshmi për atë që është cekur më lartë si komision kemi edhe fotot e punimeve në teren gjatë gjithë kohës.

D+ megjithatë nuk pajtohet me arsyetimin e komunës pasi që po të ishte e vërtetë se komuna do të duhej të bënte këto dy shërbime të ndara, atëherë nuk do të kishte nevojë për pozicionin e tretë, i cili përfshinte edhe pastrimin e borës edhe hedhjen e kripës. Përveq se çmimi është shumë i lartë për pastrim të rrugëve i cili në rastin më të keq do të duhej të kushtonte jo më tepër se 50 euro për kilometër gjatësi. Me këto sasi të deklaruara nga komuna si të shpenzuara, dhe më këto çmime, i bie që kontrata dy vjeçare është shpenzuar që në sezonin e parë dimror⁵⁵.

⁵⁵ 833 Km * 80 euro = 66,640 euro, 266 Km * 5 = 1,330 euro, totali i shpenzuar deri më tani 67,970 euro. Vlera e kontratës së nënshkruar është 47,300 euro. Sipas kësaj llogaritje i bie që kontrata është tejkaluar për 47.3% më shumë sesa 30% sa është kufizimi ligjor.

Furnizim me pajisje mjekësore dhe jo-mjekësore

Ky tender është ndarë në katër lloje, me vlerë të parashikuar 29,977.90 euro, ndërsa afati për të kryer furnizimin ka qenë 15 ditë. Edhe në këtë tender nuk është dhënë vlera e parashikuar për secilin llot. Në tenderin e parë nuk kishte ofertuar asnjë kompani dhe ishte anuluar. Në tenderin e dytë për llot 1 dhe 4, fitues është zgjedhur Koslabor me çmim 10,965 përkatësisht 8,110 euro për llotin 4, ndërsa për llot 3 fitues është Rimi-Altex me çmim 4,184 euro. Për llot 2 nuk kishte ofertë dhe si rezultat është anuluar.

Në specifikat teknike për produktet e kerkuara janë dhënë informacione të mangëta, ku mungojnë dimensionet, kapaciteti, pastaj është kërkuar markë e veçantë pa e shtuar fjalën ekuivalent. E gjithashtu është kërkuar që një produkt të ketë ngjyrë vjollcë, që për pajisjet mjekësore nuk është e zakonshme apo e domosdoshme. Për llot 1 dhe 2 të gjeturat se çka mungon në specifika janë në tabelën e mëposhtme. Për llot 3, ku kërkesa është për uniforma mungojnë madhësitë e uniformave. Për llot 4 në pikat 1 deri 5 është kërkuar markë të një prodhuesi të caktuar.

LLOT 1: Blerja e aparaturave mjekësore dhe jo mjekësore

Pozicioni	Përshkrimi	Të gjeturat
1	Karrige rrotulluese për pacient	Mungojnë dimensionet dhe materiali
4	Çanta për terren në urgjencë Elite Doctor's Medical Bag – Brown Leather	Është kërkuar model i kompanisë Elite Bags

LLOT 2: Blerja e pajisjeve të ndryshme jo-mjekësore

4	Shporetë me dru	Mungojnë dimensionet dhe kapaciteti
8	Karrige me mundësi rrotullimi dhe lëvizje (me rrota) dhe me mbajtëse të krahëve	Mungojnë dimensionet dhe materiali
9	Varëse rrobash	Mungon kapaciteti

TABELA 8. Mungesa e informatave në specifika teknike

Në ofertën e Koslabor për llot 1, në pikën ku kërkohet Elite Doctor's Medical Bag – Brown Leather, ka dhënë çmim 75 euro, por në faqen [Medisave.co.uk](https://www.medisave.co.uk) kushton 281 funtë⁵⁶.

Pika 3 dhe 5 kanë të njëjtin përshkrim fjalë për fjalë por çmimet janë të ndryshme, 65 dhe 75 euro. Në paramasën për llot 4 ka dallime në mes çmimit të ofruar dhe çmimeve të tregut në këto pika:

Pika 1 për Welch Allyn DS65 çmimi i ofruar është 40 euro, ndërsa në katër dyqanet online që hulumtuani tanë kanë shikuar (Medisave, Wijgergangs Medical, HCE dhe Daxtrio), çmimet janë 64 funtë, 70 funtë, 66 euro dhe 92 euro.

Pika 2 për Welch Allyn Pocket LED Otoscope Mulberry është dhënë çmimi 45 euro, ndërsa në katër dyqane online që D+ ka shikuar (Medisave, Oncall, Miller Medical dhe Digas), çmimet janë 70 funtë, 77 funtë, 90 funtë, 141 euro. Pika 3 për Dermlite DL100 është ofruar çmim 550 euro, ndërsa në tri (3) dyqanet online që hulumtuani tanë kanë shikuar (Dermlite, Amazon dhe Medisave), çmimet janë 375 dollarë, 265 dollarë dhe 397 euro.

56 "Elite Doctor'S Medical Bag – Brown Leather". 2018. Medisave UK. Qasur më 14 Mars 2018. <https://www.medisave.co.uk/doctor-s-medical-bag-brown-leather.html>.

Të gjitha këto dallime në çmime tregojnë që çmimet nuk analizohen fare gjatë vlerësimit. Këtë hulumtuesi tanë e kanë vërtetuar duke monitoruar dhjetë komisione të vlerësimit, e në asnjërin prej tyre nuk është bërë krahasimi i çmimeve me ato të tregut.

Kushtet e Veçanta, si në të gjithë tenderët e Komunës së Gjakovës nuk janë plotësuar kur është përgatitur Dosja e Tenderit, por janë plotësuar pasi është nënshkruar kontrata.

Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme



Tenderi për transportin e nxënësve është rishallur pasi për disa lloje nuk ka pasur oferta. Tenderi është ndarë në 30 lloje, me vlerë të parashikuar 130,992.62 euro, kontratë kornizë për shtatë (7) muaj. Në këtë tender është dhënë vlera e parashikuar për secilin lloj. Është përdorur afati i shkurtuar për dorëzimin e ofertave, por është dashur që procedurat e prokurimit të bëhen më herët në mënyrë që të përdoret afati normal. Gjithashtu Kushtet e Veçanta nuk janë plotësuar.

Ashtu siç ishte në tenderin e Komunës së Prishtinës, edhe në Komunën e Gjakovës është kërkesa që operatorët duhet të ofrojnë dëshmi që kanë përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme. Si dëshmi janë kërkuar referenca. Kompanitë që bëjnë bartje të zakonshme të udhëtarëve dhe lëshojnë bileta individuale nuk mund ta dëshmojnë përmes referencave shërbimin e tyre, pasi udhëtari nuk lëshon referenca.

Për 28 lloje kanë ofertuar katër kompani, ndërsa lloji 18 dhe 29 është anuluar pasi s'ka pasur oferta, pasi që në këto dy lloje ka numër të vogël të nxënësve. Fitues janë shpallur Meti Comerc, Destani Trans, Çlirimi dhe Ekremi Tours. Ekremi Tours është tërhequr nga oferta për lloje 5, 22 dhe 24 pasi janë hapur ofertat. Për këto lloje fitues është zgjedhur Çlirimi. Për këto 3 lloje Ekremi Tours kishte ofruar me çmim 3,824.70, 5,145.96 dhe 5,841.36 euro që kanë qenë shumë më të lira se të Çlirimit i cili për këto lloje kishte çmime 6,710, 8,125 dhe 9,223.20 euro.

Për 25 nga 28 llojet çmimi i ofruar është i njëjtë me çmimin e parashikuar. Pasi edhe Ekremi Tours është tërhequr në relacionin ku kishte konkurruar me Çlirimin, mund të supozohet se ka pasur marrëveshje në mes kompanive që mos të konkurrojnë njëra tjetrën si dhe që të ofrojnë me vlerë të njëjtë me vlerën e parashikuar.

Në këtë tender gjithashtu ka dallime në llogaritjen e çmimit pa TVSH dhe kur i është shtuar TVSH çmimi është rrumbullakuar, ndërsa sipas ligjit duhet të merren vetëm dy numra pas pikës dhjetore. Disa nga rastet ku ka dallime janë:

-  Llot 14 – çmimi për njësi pa TVSH $0.93 * 1.18 = 1.0974$ euro, por është dhënë 1.10 euro
-  Llot 16 – çmimi për njësi pa TVSH $0.76 * 1.18 = 0.8968$ euro, por është dhënë 0.90 euro

Paramasa në Excel ka qenë shumë mirë e përgatitur duke llogaritur saktë çmimin total për secilin lloj. Vlerat në secilën qeli janë zgjedhur që të kenë vetëm dy numra pas pikës dhjetore. Qelitë ku nuk janë lejuar ndryshimet janë të mbrojtura me fjalëkalim. Komisioni i Vlerësimit e bën llogaritjen ndryshe dhe ka dallime në çmim, ku edhe pse të vogla nuk është dashur të ndodhin. Komisioni llogaritjen e ka bërë duke shkruar me dorë mbi paramasat e shtypura të OE.



KOMUNA E GJILANIT

Për Komunën e Gjilanit janë analizuar nëntë tenderë të ndryshëm. Kjo komunë nuk ka ofruar qasje në të dhënat e zbatimit të tri kontratave, duke përfshirë faturat dhe shikimin e produkteve të dorëzuara nga operatorët ekonomik. D+ tërheq vëmendjen se nga pesë komunat e monitoruara, vetëm Komuna e Gjilanit nuk ka ofruar një qasje të tillë. Kjo përveç se është një mangësi në informatat e këtij raporti, tregon edhe për qasje jo bashkëpunuese që Komuna e Gjilanit ka patur në raport me këtë monitorim që nga faza fillestare.

Komuna e Gjilanit i ka katër ankesa në OSHP, për të cilat OSHP ka marrë vendime që Komuna e Gjilanit duhet t'i zbatojë. Të gjeturat kryesore për këtë komunë janë: në shumicën e tenderëve afati kohor për dorëzimin e ofertave është më i shkurtër se sa e lejon ligji, në një rast plotësimi i Deklaratës së Nevojave është bërë me laps kimik, e në një rast pas publikimit të Njoftimit për Kontratë, ndërsa duhet të bëhet para publikimit. Disa nga tenderët nuk kanë qenë të planifikuar në Planifikimin e Prokurimit për vitin 2017. Në përgjithësi garancioni nuk kërkohet edhe pse plotësohen Kushtet e Veçanta.

Afatet kohore për sigurinë e tenderit dhe ekzekutimit gjithashtu janë gabim, pasi duhet të jetë plus 30 ditë. Në rast që validiteti i tenderit është 90 ditë, siguria e tenderit duhet të jetë 120 ditë. Njëjtë është edhe për sigurinë e ekzekutimit, në rast që afati për kryerjen e punëve është 60 ditë, sigurimi duhet të kërkohet për 90 ditë.

Në tenderin për furnizim me inventar, tenderi është jo-normalisht i ulët pasi plotësohen kriteret e përcaktuara nga formulari B57 i KRPP-së⁵⁷. Komuna nuk ka bërë krahasimin e tenderit me tenderët tjerë, dhe rrjedhimisht nuk ka kërkuar as sqarime nga kompania.

Në tenderin për furnizim me tonera, aktiviteti i prokurimit është anuluar pasi janë hapur ofertat me arsyen që ka gabime në paramasë, ndërsa në njoftimin për anulim është dhënë edhe arsyeja që ka mungesë të buxhetit. Anulimi me arsyen që nuk ka buxhet bie ndesh me nenin 62 të LPP-së dhe me Deklaratën e Nevojave ku komuna i ka zotuar mjetet financiare për këtë tender.

Në tenderin për rregullimin dhe hapjen e rrugëve të rendit të tretë, komuna nuk e ka zbatuar vendimin dhe urdhëresën e OSHP-së të datës 16 janar 2018, ku edhe pas gjashtë muajve ende nuk ka marrë ndonjë vendim për dhënie të kontratës apo anulim të aktivitetit të prokurimit.

Furnizim me inventar për të gjitha njësitë kërkuese në Komunën e Gjilanit

Tenderi për furnizim me inventar ka qenë me vlerë të paraparë 150,000 euro, kontratë kornizë për 36 muaj. Për këtë tender kishin ofertuar katër kompani, ku të gjitha ishin të përgjegjshme, ndërsa fitues uzjodh NTP Metali me çmim 88,935 euro.

Krahasuar me ofertat tjera, Metali e ka tenderin me çmim jo-normalisht të ulët, i cili në bazë të kriterëve nga formulari B57

⁵⁷ Ky formular rregullon trajtimin e çmimeve jo normalisht të ulëta në aktivitetet e prokurimit publik.

i KRPP-së i plotëson kushtet për tu cilësuar i tillë. Mesatarja e katër ofertave të përgjegjshme është 115,815 euro, ndërsa Metali e ka çmimin për 30.22% më të ulët. Gjithashtu e ka ofertën edhe për më shumë se 10% më të ulët se ofertuesi i dytë që ka çmim prej 116,885 euro.

Diferenca në mes të mesatares së ofertave të përgjegjshme dhe ofertës së Metalit	$115815 - 88935 = 26880$ euro	
Diferenca në përqindje në mes të vlerës më lartë (26880) dhe ofertës së Metalit	$26880 / 88935 = 30.22\%$	Oferta e Metalit është për 30.22% më e ulët se mesatarja e ofertave të përgjegjshme
Diferenca në mes të ofertës në vendin e dytë dhe ofertës së Metalit	$116885 - 88935 = 27950$ euro	
Diferenca në përqindje në mes të vlerës më lartë (27950) dhe ofertës së Metalit	$27950 / 88935 = 31.43\%$	Oferta e Metalit është për 31.43% më e ulët se oferta e vendit të dytë

TABELA 9. Llogaritja e tenderit me çmim jo-normalisht të ulët sipas formularit B57 të KRPP-së

Komuna është dashur të kërkojë sqarime nga Metali pasi ka ofruar tender me çmim jo-normalisht të ulët.

Pasi është vlerë e madhe, afati kohor për dorëzim të ofertave është 30 ditë, ndërsa në këtë tender afati fillimisht është dhënë 19 ditë, ndërsa me Njoftim për Korrigjim të Gabimeve është zgjatuar në 24 ditë, por prapë është më pak se afati i lejuar me ligj.

Në DT, në kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional janë kërkuar dy furnizime të njëjta, por në bazë të ligjit fjala e përdorur duhet të jetë “të ngjashme”. Siguria e tenderit është kërkuar për 90 ditë, por pasi validiteti i tenderit është 90 ditë, është dashtë të kërkohej për 120 ditë, ashtu siç kërkohej në Udhëzues⁵⁸. Garancioni është kërkuar në mënyrë të paqartë, ku është kërkuar gjashtë muaj garancion për mallrat që e lejojnë këtë, ndërsa për mallrat specifike kërkohej që të kenë afat të caktuar, por nuk është dhënë afati specifik. Kontrata është nënshkruar më 8 shkurt 2018, ndërsa përgatitja e Njoftimit për Nënshkrim të Kontratës është bërë më 15 shkurt 2018. Përgatitja e njoftimit është dashur të bëhet brenda dy ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Specifikat teknike janë të paraqitura mirë, ku janë të paraqitura me fotografi se si duhet të duken bankat, karrikat, tavolinat, etj. Në disa nga pikat e specifikave teknike nuk janë kërkuar dimensione:

- Në furnizimin për shkolla, në pikën 8 është kërkuar karrikë lëvizëse për stafin, por nuk janë dhënë dimensione të karrikës, ndërsa për disa pika tjera të cila janë për karrika, janë dhënë dimensione.
- Në pikën 12 janë kërkuar kasa të metalta për nxënës ku është dhënë çmimi 15 euro për një kasë. Paramasa nuk duhet të ketë çmime të vendosura, ato duhet të jepen nga OE.
- Në furnizimin për administratën e Komunës, në pikën 9 janë kërkuar perde, pa dhënë dimensione të tyre, materialin si dhe dizajnin.
- Në pikën 12 dhe 13 për furnizim për administratën e Komunës, janë kërkuar karrika lëvizëse pa dhënë dimensione.
- Në pikën 15 janë kërkuar karrika treshe për pritje, por nuk janë dhënë dimensionet.
- Në pikën 16 janë kërkuar rafta për dokumente, por nuk janë dhënë dimensionet.

58 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 29.6 (2017). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. <http://rebrand.ly/rroopp>

- Në pikën 19 janë kërkuar shporta të mbeturinave për park, por nuk është dhënë kapaciteti i shportave, materiali apo specifika të tjera të domosdoshme të cilat përcaktojnë edhe çmimin dhe kualitetin.
- Në pikën 22 janë kërkuar karrika për amfiteatër, por nuk janë dhënë dimensionet si dhe çfarë materiali duhet të përmbajë ulësja.

Me këto kërkesa secili produkt pavarësisht kualitetit mund t'i ofrohet për shitje komunës dhe e njëta është e obliguar të lidhë kontratën pasi që nuk ka specifikuar mirë produktet, kualitetin dhe përmbajtjen.

Në ofertën e kompanisë Metali janë disa pika ku e bëjnë tenderin të cilësohet si jo-normalisht i ulët:

- Në pikën 9 për furnizimin për shkolla çmimi për një karrike për mësimdhënës në klasë është dhënë 5 euro, ndërsa në pikën 5 që është pothuajse me përshkrim të njëjtë çmimi është 20 euro.
- Në pikën 11 për furnizimin për shkolla, çmimi për një bankë për tre persona së bashku me tre karrika palosëse është 5 euro, ndërsa duhet të jetë më i lartë pasi në pikën 9 vetëm një karrikë kishte çmim 5 euro.
- Në furnizimin me inventar për administratën e Komunës në pikën 7 që është për tavolina për sallë të mësimdhënësve është çmimi 5 euro, ndërsa në pikën 4 tavolina e leximit është me çmim 100 euro.
- Në pikën 10 për të njëjtin furnizim çmimi për vitrinë për zyrë të drejtorit është 5 euro, ndërsa një vitrinë me dimensione e kërkuara 80 x 45 x 200 kushton së paku 100 euro në treg.
- Në pikën 12 dhe 13 për karrika lëvizese për stafin çmimi është 10 euro, ndërsa këto në treg kushtojnë së paku 171 euro pasi janë kërkuar të veshura më lëkur, rregullim të mbështetjes, me mundësi ulje e ngritje.
- Në pikën 14 çmimi për ormana metalik me dimensione 200 x 90 x 40 është 10 euro, ndërsa në treg kushton së paku 100 euro.
- Në pikën 15 për karrika treshe për pritje, çmimi është 10 euro, ndërsa në treg një karrikë kushton së paku 20 euro, e me tre ulëse duhet të kushtojë më tepër.
- Në pikën 17 për orman të metaltë për garderobë me dimensione 200 x 90 x 40 çmimi është dhënë 10 euro, ndërsa në pikën 18 për të njëjtin orman por me dimensione pak më të mëdha çmimi është 150 euro.
- Në pikën 20 për kaseta me tri fioka për tavolina të punës me dimensione 70 x 60 x 45 çmimi është 5 euro, që bie në kundërshtim me pikën 3 për inventar për QKMF ku çmimi është 100 euro, ndërsa është kërkuar të ketë katër fioka.
- Në pikën 21 për ormana të drurit me dimensione 200 x 90 x 45 çmimi është 5 euro, ndërsa duke marrë parasysh që në pikën 18 ishte 150 euro, duhet të kushtojë së paku aq.

Pasi ka shumë pika ku ka çmime jo-normalisht të ulëta sipas të gjitha gjasave kompania ka paraparë që këto do të mbulojnë me kontratën kornizë e cila lejon që të ketë devijim në +-30%, ndërsa porosia shtesë mund të bëhet nga pikat ku ka çmim të tregut ose më të lartë. Në kontratat kornizë nuk duhet të tejkalohet vlera totale në +-30%, por pikat në paramasë mund të tejkalohen ose të mos porositen fare. Në këtë tender mundësia e keqpërdorimit është që të porositen produktet që kishin çmim të lartë, ndërsa ato me çmim jo-normalisht të ulët të porositen fare pak.⁵⁹

⁵⁹ "Chairs". Shop-Europrinty.Com. Qasur më 19 Mars 2018. <https://shop-europrinty.com/sq/45-chairs>.

Furnizim me material Higjeniko – Sanitar

Sikur në tenderin për furnizim me inventar, edhe në këtë tender, në specifikat teknik ka mungesë të dimensioneve, kapaciteteve dhe informacione më të detajuara. Kjo ju mundëson OE që të sjellin produkte më pak cilësore. Vlera e parashikuar ishte 100,000 euro. Nga gjashtë ofertues, dy ishin të papërgjegjshëm shkak i llogaritjeve gabim të çmimit, por që nuk ishin ofertat më të lira. Kontratën e fitoi Eurotec me çmim 86,929.20 euro.

Në Deklaratën e Nevojave vlera e parashikuar është 66,000 euro, ndërsa duhet të jetë e njëjtë me vlerën në Njoftimin për Kontratë dhe DT. Është përdorur afati i përshpejtuar për shkak të vonesës së kërkesës nga njësia kërkuese. Kjo vonesë nuk është e arsyeshme dhe është dashur që të përdoret afati normal për dorëzimin e ofertave.

Në DT është një ngatërrim në kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional ku është kërkuar furnizimi i ngjashëm por është për tonera, ndërsa furnizimi është për material higjeniko-sanitar. Por kërkesa në Njoftim për Kontratë është ndryshe ku kërkohet që OE të ketë realizuar dy kontrata të ngjashme në tri vitet e fundit. Kriteret për pjesëmarrje duhet të jenë të njëjta në DT dhe Njoftim për Kontratë.

Në shumicën e pikave në specifikat teknike është kërkuar markë të një prodhuesi të caktuar pa e shtuar fjalën ekuivalent. Gjithashtu në shumicën e pikave janë kërkuar produkte me mangësi në informacion siç është sasia, dimensionet dhe kapaciteti. Disa nga pikat në paramasë ku ka mungesë të informacionit janë:

- Në pikën 24 janë kërkuar shporta të mbeturinave pa e dhënë kapacitetin e shportave.
- Në pikën 26 janë kërkuar lopata të plastikës pa i dhënë dimensionet.
- Në pikën 65 janë kërkuar mantila pune pa specifikuar dimensionet apo elemente tjera si xhepat, patentit, etj.
- Në pikën 66 janë kërkuar rroba puna komplet, pa dhënë detaje se çka përfshihet në këto rroba pune. A përfshihen dorëzat, kapelat, këpucët?

Të gjitha këto mund të bëjnë që të ketë keqpërdorime. Shembull kompania mund të ofrojë një çmim për shportë të mbeturinave, i cili çmim mund të nënkuptojë që do të dërgohet shportë e madhe, ndërsa kompania dërgon shportë të vogël.

Në ofertën e Eurotec janë disa pika ku çmimet e dhëna kanë dallim të madh me çmimet e tregut dhe ato nga Lista e KRPP-së:

- Në pikën 87 për shportë për mbeturina me kapak, kapaciteti 10 litra, çmimi është 0.55 euro, ndërsa nga Lista e KRPP-së është 7.34 euro
- Në pikën 95 për rollne për kuzhinë, gjatësia 20m, çmimi është 0.12 euro, ndërsa në treg është nga 2-2.50€, ndërsa nga Lista e KRPP-së 1.56 euro .

Nga 102 pika që janë gjithsej, në 40 prej tyre ka mungesë në të dhëna për dimensionet, kapacitetin si dhe elemente tjera. Komuna duhet të sigurohet që specifikat të hartohen më mirë, pasi në këtë formë ju mundëson OE të ofrojnë produkte jo-cilësore, duke u munduar që të zvogëlojnë koston.

60 Lista e çmimeve njësi mesatare referent për material higjienik, MH054 (2015). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.
<https://rebrand.ly/kropp2>

61 Lista e çmimeve njësi mesatare referent për material higjienik, MH031 (2015). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.
<https://rebrand.ly/kropp2>





Furnizim me serra për nevojat e fermerëve në Komunën e Gjilanit

Tenderi për furnizim me serra ka qenë i shpallur dy herë. Vlera e parashikuar ishte 36,000 euro me afat kohor që furnizimi të kryhet për 60 ditë. Në tenderin e parë kishin ofertuar dy kompani, ndërsa të dyja ishin shpallur të papërgjegjshme. Një OE kishte dallime të mëdha në çmim si shkak i llogaritjes së gabuar, ndërsa tjetri kishte bërë ndryshime në sasi.

Në tenderin e dytë, Metaliku fitoi me çmim 35,240 euro. Kishte edhe një ofertë tjetër që kishte çmim më të lartë për 700 euro. Metaliku kishte ndryshuar sasisë e dhëna në paramasë, ndërsa komuna i kishte dërguar letër standarde për kërkesë për sqarim. Metaliku është përgjigjur duke thënë që bëhet fjalë për lëshim teknik. Për të mos lejuar këto veprime që të ndodhin, përshtirimi i çmimeve duhet të bëhet në Excel dhe të mbrohen me fjalëkalim për celulat ku nuk bën të ndryshohen. Këtë praktikë e përdor Komuna e Vushtrrisë që është një praktikë shumë e mirë. Gjithashtu komuna duhet të hetojë ndryshimin e sasisë të bërë nga kompania, pasi nuk mund të bëhet fjalë për gabim teknik.

Ky aktivitet i prokurimit nuk ka qenë i planifikuar, pasi mungon në Planin e Prokurimit për vitin 2017. Deklarata e Nevojave nuk është plotësuar e gjitha, numri i prokurimit ka numër tjetër me numrin që është në Njoftimin për Kontratë, pjesa ku duhet të shkruhet natyra dhe fushëveprimi është fshirë pasi ka patur tekst në të dhe është shkruar me dorë mbi të. Ndërsa pjesa Neni 3: Shqyrtimi, nuk është nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) dhe Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) Siguria e tenderit është kërkuar për 60 ditë, ndërsa është dashtë të kërkohej për 90 ditë Edhe pse Kushtet e Veçanta janë plotësuar garancioni nuk është kërkuar për afat të caktuar, vetëm me fjalë të përgjithshme që furnizimet duhet të jenë të reja, i cili është kopjuar nga Neni 24.1 i Kushteve të Përgjithshme. Vetëm për një produkt, për folinë antidrip kërkohej pesë vjet garacion, që është i shkruar në specifikat teknike.

Në specifikat teknike, nga 10 pika, në 4 prej tyre nuk janë kërkuar dimensione dhe karakteristika tjera.

-  Në pikën 4 janë kërkuar unaza dhe lidhëse pa dhënë dimensionet.
-  Në pikën 5 janë kërkuar bulona, pa dhënë dimensionet.
-  Në pikën 8 është shënuar vetëm fjala “baza”, me sasi 38 m³. Nuk është dhënë se a do të shtrohet baza dhe me çka do të shtrohet.
-  Në pikën 9 janë kërkuar rrota për dyer pa dhënë dimensionet e tyre.

Për të eliminuar këto mangësi Komuna duhet të japë më shumë përshkrime, duke specifikuar dimensionet, apo në rastin e pikës 8 se me çka do të shtrohet baza. Mangësia në përshkrime ju lejon kompanive që të përshtatin ofertën ashtu si ju konvenon atyre me kualitet të pa përshtatshëm dhe kushte të cilat nuk i shërbejnë komunës apo përdoruesit.

Furnizim me tonera për te gjitha njësitë shpenzuese në Komunën e Gjilanit

Tenderi për furnizim me tonera është anuluar pasi janë hapur ofertat me arsye që “Komisioni i Vlerësimit gjatë ekzaminimit të ofertave ka hasur në gabime të shumta në specifikacionet teknike, prandaj rekomandon anulimin e aktivitetit të prokurimit. Në Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit si arsye për anulim është dhënë që “Drejtoria për Buxhet ka njoftim që nuk ka mjete për shkak të fundit të vitit”. Sipas Raportit të Vlerësimit gabimet janë për shkak që një printer është shkruar në disa pika në vend që të bashkohen në një të vetme. Sipas Udhëzuesit⁶² një tender nuk mund të anulohet pasi të janë hapur ofertat për këtë arsye. Në raportin e vlerësimit të gjithë operatorëve ju është shënuar që janë në mospajtim me të gjitha kërkesat e DT, në mënyrë që të mund të shpallen të gjithë të papërgjegjshëm dhe pastaj të anulohet tenderi.

62 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 44.7, 44.8 (2017). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.
<http://rebrand.ly/rroopp>

Ofertat janë hapur më 6 dhjetor 2017, ndërsa publikimi i vendimit për anulim është bërë më 29 dhjetor 2017. Duke marrë parasysh këto të dhëna, ka të ngjarë që tenderi është anuluar për shkak të mungesës së buxhetit, ku si pasojë e anulimit është shkelur neni 62 i LPP-së.

Vlera e parashikuar ka qenë 100,000 euro, kontratë kornizë për 36 muaj. Është përdorur afati i përshpejtuar me arsyetimin se ka vonesa nga njësia e kërkesës, por pa dhënë arsye të vonesës.

Specifikacioni teknik, përveç që disa printerë të njëjtë kanë qenë të shkruar 2-3 herë, ka qenë i përgatitur mirë. Është kërkuar që tonerët të mos jenë të rimbushur dhe të ripërpunuar, që është një praktikë e mirë që duhet ta ndjekin të gjitha komunat.

Furnizim me Skener (Detektor) dhe pajisje për nevoja të sallës së re të Kuvendit Komunal

Specifikat teknike për skener kanë qenë të përshtatura për kompaninë fituese pasi pothuajse të gjitha specifikat teknike të ofruara janë të njëjta me ato të kërkuara.

Vlera e parashikuar për këtë tender ishte 49,950 euro, me afat prej një (1) muaj për të kryer furnizimin. Vetëm një OE ka ofertuar, i cili edhe ka fituar. Grupi i OE NAS-Systems & Tetronic LLC ka fituar me çmim 49,903 euro, i cili është për vetëm 47 euro më i ulët se vlera e parashikuar.

Ky aktivitet i prokurimit nuk ka qenë i planifikuar pasi që nuk gjendet në Planifikimin e Prokurimit për vitin 2017. Në Deklaratën e Nevojave është shënuar që ka qenë i planifikuar.

Edhe për këtë tender është përdorur afati i përshpejtuar për pranimin e ofertave me arsyen "Për shkak të përmbylljes së vitit buxhetor dhe se shumë shpejt mund të caktohet seanca inauguruese". Kjo arsye nuk është bindëse, prandaj është dashur të përdoret afati normal.

Pasi ky tender është me vlerë të mesme, validiteti i tenderit kërkohet 60 ditë, ndërsa sigurimi i tenderit duhet të kërkohet për 90 ditë, por është kërkuar për 60 ditë.

Në kërkesat e kualifikimit, kërkesat teknike dhe profesionale është kërkuar që të sillen autorizim nga prodhuesi, por do të duhej të vlente edhe autorizimi nga distributori, i cili veçse është i autorizuar nga prodhuesi. Prodhuesit e mëdhenj nuk lëshojnë autorizime direkt për kompanitë, por i kanë përfaqësuesit e autorizuar në shtete apo rajone të caktuara. Po në këto kërkesa është kërkuar referencë për vitet 2014, 2015 dhe 2016 me së paku një referencë të njëjtë.

Edhe këtu është dashur që të përdoret fjala e ngjashme, pasi kufizohet konkurrenca, sidomos kur dihet që këto blerje bëhen shumë rrallë. Gjithashtu janë kërkuar certifikata të standardeve të BE-së për të gjitha produktet, por nuk janë specifikuar cilat standarde. Ndërsa në kërkesën tjetër është kërkuar Standardi ISO 9001, ku është shkruar që ky standard është për shitjen dhe instalimin e pajisjeve të sigurisë. ISO 9001 është për sistem të menaxhimit të kualitetit⁶³.

Në specifikat teknike të produkteve është kërkuar garancion 12 muaj, në KV është garancion por pa dhënë kohëzgjatjen, ndërsa në Kontratë nuk është kërkuar garancion fare.

63 "ISO 9001:2015 - Quality Management Systems". 2015. iso.org.
<https://www.iso.org/standard/62085.html>.

Specifikat teknike për katër produktet e kërkuara janë në shumicën e pikave të njëjta me të dhënat nga katalogjet e produkteve të ofruara. Kjo mund të nxis dyshime që specifikat teknike mund të kenë qenë të përshtatura për kompaninë fituese. Disa nga pikat ku të dhënat janë identike janë:

- Për detektorin është kërkuar që rryma e tubit të operojë në 0.7 mA, temperatura e operimit 0 deri 40 gradë celsius, shpejtësia e shiritit 0.20 m/s, ngarkesa në shirit 165kg. Këto të dhëna janë të njëjta me të dhënat e produktit të ofruar. Gjithashtu edhe kompjuteri që është në detektor, specifikat janë të njëjta me modelin e ofruar.
- Për detektorin e metalit është kërkuar që të ketë 10 nivele të ndjeshmërisë, temperatura e operimit -20 deri 70 gradë celcius, ndërsa këto janë të njëjta me të dhënat e produktit të ofruar.
- Për transmetuesin e sistemit të votimit digjital është kërkuar që radio frekuenca të jetë minimum 100 m, të ketë dy porte të rrjetit, fuqia të jetë 9dBm, antena të mund të zgjatet deri në 15cm. Të gjitha këto janë të njëjta me të dhënat e produktit të ofruar.

Në disa nga pikat ku nuk përputhen të dhënat janë:

- Është kërkuar që metal detektori të ketë mbrojtje IP44, por në katalog është IP40-41. IP44 ofron mbrojtje nga spërkatja me ujë, ndërsa IP40 dhe 41 nuk ofrojnë mbrojtje nga uji .

Sipas të dhënave që janë krahasuar, duke marrë parasysh që DT e kanë tërhequr 22 OE, ndërsa vetëm një OE ka bërë ofertë, duket që specifikat teknike i janë përshtatur NAS-Systems & Tetronics, gjë që ndalohej me Nenin 7 të LPP-së⁶⁵.

Përderisa në tenderin e Komunes së Prishtinës për furnizim me pajisje të teknologjisë informative ishin eliminuar dy kompani vetëm për një pikë, Komuna e Gjilanit është dashtë ta shpallë të papërgjegjshme NAS-Systems & Tetronics, pasi detektori është kërkuar të jetë me mbrojtje IP44, ndërsa është ofruar me IP40-41.

● **Furnizimi dhe montimi i nxemjes qendrore në sallën e edukatës fizike në shkollën fillore “Musa Zajmi”**

Për këtë tender vlere e paraparë ka qenë 25,000 euro, me afat prej dy muajsh për zbatimin e kontratës. Nga tre ofertues, njëri ishte i papërgjegjshëm, ndërsa fitues u zgjodh Adetex me çmim 19,987.76 euro. Kompania Doni Term që ishte shpallur e papërgjegjshme bëri kërkesë për rishqyrtim me pretendimin që Adetex nuk e ka sjellë sigurinë e tenderit edhe në formë fizike ashtu siç kërkohet në Udhëzues⁶⁶. Kërkesa për rishqyrtim është refuzuar nga Komuna me arsyetimin se në dokumentet që përbëjnë DT, siguria e tenderit e dorëzuar në formë të skenuar, shihet që data është para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.

Arsyetimi vazhdon me “Në Njoftimin për Kontratë dhe në dokumentet të cilat përbëjnë DT nuk ka qenë e specifikuar që domosdoshmërisht OE të cilat ofertat i dorëzojnë përmes platformës elektronike të dorëzohet edhe kopja fizike e sigurisë së tenderit para momentit të hapjes së ofertave”. Është e vërtetë që nuk kërkohet në asnjë Njoftim për Kontratë të sillet kopja fizike, por këtë gjë e kërkon Neni 29.13 i Udhëzuesit.

64 Shpjegime për IP (Ingress Protection).

<http://www.dsmc.com/resources/ip-rating-chart/>

65 Ligji i Prokurimit Publik 04/L-042, Neni 7. (2011). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

66 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 29.13 (2017). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

<http://rebrand.ly/rroopp>

Doni Term nuk ka qenë i kënaqur me përgjigjen dhe ka bërë ankesë në OSHP për shkeljen e Nenit 29.13. OSHP e aprovon⁶⁷ ankesën e Doni Term dhe urdhëron që tenderi të kthehet në rivlerësim. Pas rivlerësimit Komuna merr parasysh vendimin e OSHP-së dhe shpallë fitues kompaninë Doni Term.

Ky tender nuk ka qenë i planifikuar pasi nuk gjendet në Planifikimin e Prokurimit për vitin 2017. Deklarata e Nevojave e ka datën të plotësuar me laps kimik, 9 nëntor 2017, ndërsa data e përgatitjes së Njoftimit për Kontratë është 1 nëntor 2017, ndërsa e publikimit më 6 nëntor 2017. Deklarata e Nevojave duhet të hartohet para se të iniciohet aktiviteti i prokurimit, pra para datës 1 nëntor do të duhej të ishte bërë. Në FDT është e shkruar që data e dorëzimit të Njoftimit në Kontratë në KRPP është 30 tetor 2017, por Njoftimit për Kontratë është përgatitur më 1 nëntor 2017.

Afati për dorëzimin e ofertave ka qenë 18 ditë, ndërsa duhet të jetë së paku 20 ditë pasi është vlerë e mesme.

Edhe në këtë tender si në të gjithë tenderët tjerë të Komunës së Gjilanit, siguria e tenderit nuk është kërkuar në +30 ditë nga afati i validitetit të tenderit.

Sigurimi i automjeteve për nevojat e K.K. Gjilan

Tenderi për sigurimin e automjeteve kas pasë vlerë të parashikuar 39,000 euro, kontratë kornizë për 36 muaj. Kanë ofertuar nëntë OE, ndërsa tetë prej tyre ishin të përgjegjshëm. Fitues u zgjodh Insig me çmim 13,048.07 euro për një vit sigurim për të gjitha veturat, do të thotë kjo vlerë është për tre vite, që bëjnë 39,144.21 euro. Insigut i është korrigjuar çmimi, pasi fillimisht kishte ofruar me 13,107.08 euro. Kundër vendimit për dhënie të kontratës, kompania Sigma bën kërkesë për rishqyrtim me arsyetimin se çmimet e dhëna nga Insig dhe tre OE tjerë nuk janë të njëjta me çmimet që vendosen nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Komuna e refuzon kërkesën për rishqyrtim me arsyen që komisioni i vlerësimit është mbledhë prapë dhe ka bërë shqyrtimin e të gjitha çmimeve, ndërsa dallimi ka qenë shumë i vogël.

Sigma pas këtij vendimi bën ankesë në OSHP me pretendimet e njëjta, pra çmimet e sigurimit për disa vetura nuk përputhen me tarifat e vendosura nga BQK. OSHP e aprovon⁶⁸ pjesërisht ankesën dhe vendos që tenderi të shkojë në rivlerësim. Pas rivlerësimit fituese është zgjedhur kompania Scardian me çmim 13,208.41 euro për një vit sigurim. Të gjithë OE tjerë janë shpallë të papërgjegjshëm.

Në specifikat teknike, për veturën Hyundai Terracan kërkohet sigurim edhe pse është shkruar që është jashtë përdorimit. Kjo veturë do të duhej të ç'registrohej ose të riparohet. Kërkesa që për të të paguhet sigurim i shkakton humbje buxhetit të komunës rreth 450 euro për tri vite.

Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit të tretë, pastrimi i lumenjëve dhe largimi i deponive të egra në Komunën e Gjilanit

Ky tender nuk është përmbyllur ende dhe ka dhjetë (10) muaj që është në procedurë. Shkak janë dy ankesa në OSHP të bëra nga OE El-Bau.

Vlera e parashikuar ka qenë 400,000 euro, kontratë kornizë 36 muaj. Edhe për këtë tender nuk do të duhej të përdorej kontrata kornizë për punë që kryhen vetëm një herë dhe jo në vazhdimësi. Fitues u zgjodh kompania Zuka Commerce me çmim 115,269 euro.

⁶⁷ Vendimi 01-18 (2018). Organi Shqyrtues i Prokurimit.

<http://rebrand.ly/01-18>

⁶⁸ Vendimi 20-18 (2018). Organi Shqyrtues i Prokurimit.

<http://rebrand.ly/20-18>

Kundër këtij vendimi kompania El-Bau ka bërë kërkesë për rishqyrtim e cila është refuzuar. Pas kësaj, operatori ekonomik ka bërë ankesë në OSHP e cila ka aprovuar të njëjtën dhe tenderi është kthyer në rivlerësim⁶⁹.

Pas rivlerësimit, përsëri është zgjedhur fitues Zuka Commerce, me të njëjtin çmim që ka ofertuar në herën e parë. El-Bau edhe kësaj here ka bërë kërkesë për rishqyrtim, kërkesë e cila refuzohet. E njëjta kompani bënë ankesë në OSHP, e cila përveç që e aprovon ankesën, i jep urdhër Komunës që të zbatohet vendimi i mëhershëm⁷⁰. Kështu, tenderi prapë kthehet në rivlerësim. Kanë kaluar më tepër se gjashtë muaj që nga urdhëresia e OSHP-së dhe komuna nuk ka publikuar ndonjë vendim. Deri më 27 qershor 2018 nuk ka ndonjë vendim të publikuar në platformën e-prokurimi në lidhje me urdhrin e lëshuar nga OSHP.

Afati për pranimin e tenderëve ka qenë 17 ditë, ndërsa pasi është vlerë e mesme duhet të jetë 20 ditë. Tenderi është kërkuar që të jetë i vlefshëm për 120 ditë, ndërsa sigurimi i tenderit është dashur të kërkohej për 150 ditë, por është kërkuar për 120 ditë. Siguria e ekzekutimit është kërkuar por nuk është dhënë kohëzgjatja. Kushtet e Veçanta nuk janë plotësuar. Vlerësimi i parë ka zgjatur 53 ditë, që sipas ligjit duhet të jetë 30 ditë.

Specifikat teknike janë të mangëta me shumë pak të dhëna. Për hapjen e rrugëve nuk janë dhënë përshkrime se cilat rrugë do të hapen, sa është gjatësia dhe gjerësia e tyre. Sasitë në m² dhe m³ janë të rrumbullakuara në numra që përfundojnë me 000, shembull 25000, 5000, 3000, etj.

Në specifikat teknike për hapjen e rrugëve, sipërfaqja është dhënë 25000 m². Ka disa gabime në llogaritjen e sasive për m³:

- Në pikën 3 që është për shtruarjen e bazës me material të granular me trashësi 10cm, sasia është dhënë 10000 m³. Sipas llogaritjes ajo duhet të jetë 2500 m³ pasi $25000 * 0.1 = 2500$.
- Në pikën 4 që e njëjtë si pika 3 por vetëm me 20cm trashësi, sasia e dhënë është përsëri 10000 m³, por duhet të jetë $25000 * 0.2 = 5000$ m³.
- Në pikën 5 që është për mbushje me material vendor me trashësi 20cm, sasia është dhënë 9000 m³, por duhet të jetë $25000 * 0.2 = 5000$ m³.
- Në pikën 6 që është për shtruarjen e bazës me material shterpë me trashësi 20cm, sasia është dhënë 3500 m³, por duhet të jetë 5000 m³.
- Në pikën 7 që është për ngjeshjen e rrugës me cilindër hidraulik, ngjeshja vetëm se është llogaritur në pikat 3-6, ku në tekst është shkruar "trashësia në gjendje të ngjeshur".

Të gjitha këto gabime në llogaritje të sasive, kanë bërë që të ketë një diferencë të madhe në mes së vlerës së parashikuar dhe ofertës së Zuka Commerce.

Në pikat 3-6 sasia do të duhej të ishte në total 17500 m³, por është 32500 m³, e që nga këto gabime sasia është për 15000 m³ më e madhe. Nga ky dallim i madh në sasi do të mund të ketë keqpërdorime duke dhënë çmime jo-normalisht të ulëta. Komuna duhet të sigurohet që mos të ketë gabime në sasi, pasi kështu mund të keqpërdoret buxheti.

69 Vendimi 277-17 (2017). Organi Shqyrtues i Prokurimit.
<http://rebrand.ly/277-17>

70 Vendimi 461-17 (2017). Organi Shqyrtues i Prokurimit.
<http://rebrand.ly/461-17>

● Rekonstruimi i stadionit të qytetit në Gjiilan

Tenderi për rekonstruimin e stadiumit është i bashkëfinancuar në mes të Komunës së Gjiilanit dhe Ministrisë së Kulturës. Vlera e parashikuar është 3,883,855.22 euro, kontratë kornizë për 36 muaj. Edhe për këtë tender përdorimi i kontratës kornizë, në mendimin e D+ nuk është mënyra më mirë. Në Deklaratën e Nevojave shuma e zotuar për tri (3) vite është 950,000 euro, ndërsa Ministria e Kulturës merr obligim për 598,000 euro që në total janë 1,548,000 euro. Pjesa tjetër që është 2.33 milion euro mjetet nuk janë të zotuara. Mjetet duhet të zotohen para se të fillojë aktiviteti i prokurimit⁷¹.

Për këtë tender kishte shtatë ofertues, ku gjashtë ishin të përgjegjshëm, ndërsa fitues u zgjodh kompania Al-Trade me çmim 3,121,346.07 euro.

Kompania e vetme që është shpallë e papërgjegjshme, SDI shpk, ka pasur çmim më të ulët se të Al-Trade. SDI është eliminuar shkaku që i kanë munguar dokumentet për inxhinierin e gjeodezisë. Në listën e stafit është paraqitur, por kanë munguar kontrata, diploma dhe CV-ja e tij. Komuna i ka dërguar letër standarde për informacion shtesë, ndërsa SDI i ka dërguar këto dokumente, por për një person tjetër. Nga qasja në dokumente që u është ofruar hulumtuesve tanë, është verifikuar që në listën e punëtorëve është tjetër person, ndërsa kontrata dhe diploma janë dërguar për tjetër person.

Afati për dorëzim të ofertave ka qenë 38 ditë, ndërsa pasi është vlerë e madhe do të duhej të ishte 40 ditë. Në DT që shkakohet nga e-prokurimi mungon projekti ekzekutues që duhet patjetër të bashkëngjitet me DT. Siguria e ekzekutimit është kërkuar, por nuk është dhënë kohëzgjatja, ndërsa KV nuk janë plotësuar, pra garancioni është vetëm një vit sipas KP.

Specifikat teknike janë të hartuara përgjithësisht mirë, tek sasisë është përdorur njësia matëse e duhur, për shembull betoni me m³, armatura me kg, sipërfaqja me m², gërmimi me m³. Por në disa pika ka lëshime:

- Në pikën F021 në përshkrim thuhet që çmimi llogaritet me m², por sasia është dhënë me m³.
- Në pikën F085-2, F087-2 ka kërkesë për produkt specifik të kompanisë Lexan pa e përdorur fjalën ekuivalent. Në disa pika tjera është përdorur kjo fjalë.
- Në pikën F121 që është për rrjetin e rrymës është kërkuar që të gjithë prodhuesit të jenë nga vendet e BE-së.
- Për pikën 131 ku është kërkuar pajisje për kondicionimin e ajrit, janë të kompanisë Daikin. Modeli në pikën 131-1 ka çmim 11,610€, por kompania Daikin e shet për 1,100 funta⁷². Edhe pse janë të përfshira edhe montimi, vendosja e gypave, etj, diferenca në çmim është dhjetëfish. Pika 130-2 që e ka të njëjtën pajisje me të njëjtin përshkrim ka çmim 1,207€. Për pikat 131-2 dhe 131-3 produktet me emërtim FLXS35B9/RXS35L4 dhe L5 nuk ekzistojnë në faqen e Daikin, daikinairconditioning.com, ndërsa çmimet janë dhënë 14,040 dhe 16,215 euro.
- Pika F901 që është për punë të paspecifikuara, punë shtesë, punë në plotësimin e kritereve të ardhshme të UEFA-s është dhënë si 6% e shumë së pikava paraprake, në total 175,354.02 euro. Punët në këtë pikë duhet të specifikohen më qartë.

Specifikat teknike për ndërtimin e stadiumit në përgjithësi janë përgatitur mirë. Mungesa e zotimit të mjeteve mund të shkaktojë vonesa në përfundimin e punëve.

⁷¹ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 8.2, 8.3 (2017). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

<http://rebrand.ly/rroopp>

⁷² "Daikin FLXS35B9/RXS35L3 3.5KÉ 12,000Btu Heat Pump Floor/Ceiling Mounted Inverter System". Daikinairconditioning.Com. Qasur më 21 Mars 2018.

<https://www.daikinairconditioning.com/daikin-flxs35b9-rxs35l3-3-5kë>.



KOMUNA E VUSHTRRIË

Për Komunën e Vushtrrisë janë analizuar nëntë tenderë. Të gjeturat kryesore në këtë komunë janë si në vijim: ka kërkesa për produkt specifik të ndonjë kompanie të caktuar, kërkesë për standarde të shteteve të huaja, një tender ka çmime jo-normalisht të ulëta e një aktivitet të prokurimit i gjithë tenderi përmbanë çmime jo normalisht të ulëta në bazë të kriterëve të ligjit, ndërsa nuk është kërkuar sqarim nga operatori. Në disa tenderë për punë ka gabime në llogaritje të sasive.

Në tenderin për furnizim me pajisje të teknologjisë informative, kompania Tech Vision ka dërguar kompjuterë të vjetër dhe të përdorur, specifikat e të cilit nuk përputhen me ato të kërkuara. Tech Vision si duket e ka mashtruar komunën, gjë që nuk është vërejtur nga personat përgjegjës për pranimin e mallit.

Si praktikë e mirë është që qarkullimi financiar nuk kërkohet, ku i mundësohet kompanive të reja apo të sapo themeluara që të mund të konkurrojnë. Kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional janë minimale, siguria e tenderit nuk kërkohet edhe pse kjo mund të keqpërdoret nga kompanitë që ofertojnë. Si rezultat i kriterëve më të buta në shumicën e tenderëve të analizuar ka oferta më shumë se të komunave tjera, ndërsa pothuajse shumica e OE janë të përgjegjshëm.

Furnizim me pajisje të teknologjisë informative për nevoja të Komunës së Vushtrrisë

Fituesi i këtij tenderi, kompania Tech Vision si duket e ka mashtruar Komunën e Vushtrrisë, ku dyshohet se ka dërguar kompjuterë të vjetër, të përdorur dhe që nuk përputhen me specifikat e kërkuara. Zyrtarët përgjegjës që kanë pasur për detyrë të kontrollojnë kompjuterët që i ka dërguar kompania, në raportin e pranimin kanë shënuar që kompania ka sjellë produktet e kërkuara.

Vlera e parashikuar ishte 21,554 euro, me afat 30 ditë për ta kryer furnizimin. Nga katër oferta, të gjitha ishin të përgjegjshme, ndërsa fitues ishte zgjedhur Tech Vision me çmim 20,691.50 euro, i cili e kishte edhe ofertën më të lirë.

Afati për dorëzimin e ofertave ka qenë 17 ditë. Pasi është përdorur afati normal është dashur të jetë 20 ditë.

Në shumë pika të specifikave teknike janë kërkuar pjesë që specifikojnë markën apo produktin specifik të një marke pa përdorur fjalën ekuivalent. Shembull është kërkuar që procesori të jetë Intel Core i3 për llaptopët dhe kompjuterët. Në pikën 15.1 dhe 16.1 është kërkuar printer, por është dhënë edhe modeli specifik që është i prodhuesit Ricoh. Kërkesa për produkt të një prodhuesi të caktuar, kufizon konkurrencën dhe bie ndesh me LPP⁷³.

Pasi specifikat teknike përgatiten nga Njësia e Kërkesës, Komuna duhet që të sigurohet që të shtohet edhe fjala ekuivalent aty ku ka kërkesa për markë të veçantë, në mënyrë që të jetë në përputhje me ligjin. Pa u shtuar fjala ekuivalent mund të lindin dyshime që tenderi mund të përshtatet për ndonjë kompani të caktuar në Kosovë që e ka të drejtën ekskluzive për ndonjë markë të caktuar.

73 Ligji i Prokurimit Publik 04/L-042, Neni 28.7. (2011). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

ZBATIMI I KONTRATËS

Për tenderin për furnizim me pajisje të teknologjisë informative, hulumtuesit tanë kanë vizituar dy lokacione ku janë dërguar këto pajisje. Një desktop kompjuter është dërguar në Njësinë e Zjarrfikësve në Vushtrri. Ka dallim të madh në mes specifikave të kërkuara dhe kompjuterin që e ka dërguar kompania Tech Vision.

Tech Vision ka dërguar kompjuter të përdorur, me pjesë nga viti 2011 dhe nuk i ka ofruar specifikat e kërkuara që gjenden në tabelën më poshtë:

Nr	Specifikat e kërkuara	Specifikat e kompjuterit të dërguar
1	Intel Core i3 4170	Intel Core i5 2400 (2 gjenerata më i vjetër)
2	2 USB 3.0	Nuk ka port USB 3.0
3	1 DVI	Nuk ka port DVI

TABELA 10. Dallimi në mes specifikave të kërkuara dhe ato që ka dërguar Tech Vision

Tech Vision gjithashtu shtëpizën e ka futur në një paketim që dukej që nuk është i prodhuesit, pasi kishte vetëm logon e HP dhe asnjë informatë tjetër. Monitori ishte gjithashtu HP, por ai ishte në një paketim, ku përveç logos së HP, tregohet modeli dhe informata të tjera.

Kompjuteri punonte shumë ngadalë duke u bllokuar disa herë. Kjo ndodhte pasi hard disku kishte rreth 1000 orë punë të bëra dhe e ngadalësonte kompjuterin. Ky kompjuter është faturuar me çmim 420 euro nga Tech Vision, por vlera në treg është rreth 200 euro. Kompjuterë sipas specifikave në dosje të tenderit janë kërkuar edhe për dy shkolla, në të cilat janë dërguar kompjuterë të njëjtë të përdorur.

Komisioni i pranimit, zyrtari i regjistrimit dhe zyrtari autorizues, të gjithë kanë nënshkruar që mallrat dhe shërbimet janë pranuar sipas kushteve të specifikuara. Shqetësues është fakti që Tech Vision dyshohet se ka mashtruar komunën duke dërguar kompjuter të vjetër, të përdorur dhe që nuk i përmbushin specifikat e kërkuara. Dëmi në buxhet vlerësohet të jetë 660 euro.

Në tender është kërkuar edhe një lloptop për zyrën e kryetarit. Hulumtuesit e D+ e kanë verifikuar këtë lloptop dhe i njëjti ka qenë sipas specifikave të kërkuara në dosje të tenderit.

Urdhërblertjet janë me datë para pranimit të pajisjeve, ndërsa për kryerje të pagesës komuna ka lëshuar urdhërpagesë që është brenda afatit 30 ditor për kryerje të pagesës. Gjithashtu komuna për vonesa në dorëzim të produkteve i ka shqiptuar gjobë kompanisë Techvision në vlerë 310,32 euro. Faturat që Techvision i ka dërguar kanë shumë mangësi, nuk tregohen se cilat produkte e kanë TVSH-në 8 ose 18%, edhe pse vendi për shënim të TVSH-së është në faturë, por nuk është plotësuar. Në të gjitha faturat nuk është dhënë përshkrim i detajuar për produktet, është shënuar vetëm furnizim me pajisje të teknologjisë informative. Një faturë e zakonshme për blerje të një kompjuteri do të kishte të dhëna për prodhuesin e kompjuterit, modelin dhe specifikat bazike. Një faturë e tillë do të kishte gjithashtu çmimin pa TVSH, normën e TVSH-së dhe çmimin me TVSH.

Furnizim me fidane Arrë

Tenderi për furnizim me fidanë të arrës ka pasur vlerë të parashikuar 32,264.34 euro, ndërsa afati kohor që të kryhet furnizimi ka qenë 20 ditë. Ky aktiviteti i prokurimit ka qenë i përfshirë në Planifikimin Vjetor për vitin 2017, por me vlerë më të ulët, 20,000 euro. Është përdorur afati i shkurtuar për dorëzimin e ofertave me arsyen se "Meqenëse projekti financohet

nga të hyrat vetanake dhe participimi i përfituesve". Nga tre tenderues, që të tre ishin të përgjegjshëm, ndërsa kontrata iu është dhënë kompanisë Semenarna me çmim 20,282.24 euro.

Në Dosjen e Tenderit, është kërkuar që fidanët të jenë të importuar nga vendet anëtare ose kandidatë të BE-së. Ky kusht e kufizon konkurrencën pasi fidanë të arrës ka nga e gjithë bota. Specifikat teknike dhe përshkrimin se si duhet të jenë fidanët janë të detajuara. Gjithashtu për sistemin e ujitjes pikë-pikë është kërkuar garancion prej tre vitesh.

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale të Komunës së Vushtrrisë

Në tenderin për mirëmbajtjen e rrugëve vlera e parashikuar ishte 95,982 euro, kontratë kornizë për 18 muaj. Nga pesë ofertues, të gjitha ishin të përgjegjshëm, ndërsa fitues ishte shpallur kompania Ramadani me çmim 68,989.72 euro

Afati për fillimin dhe mbarimin e shërbimit është dhënë me ditë të caktuar, që është praktikë e mirë. Por në kontratë këto data janë të ndryshme nga Dosja e Tenderit. Në DT periudha kohore e mirëmbajtjes është nga 15.11.2017 – 15.03.2019, ndërsa në kontratë është nga 11.12.2017 – 10.05.2019. Periudha kohorë në DT ka qenë e gabuar, pasi afati për dorëzim të ofertave ka qenë deri më 27 nëntor 2017. Këto mospërputhje të datave mund të dërgojnë në interpretime të ndryshme se cilat data vlejné. Pasi të nënshkruhet kontrata datat e dhëna në kontratë kanë përparësi, ndërsa para se të nënshkruhet përparësi kanë datat e dhëna në dosje të tenderit.

Përderisa në tenderin e Komunës së Gjakovës specifikat teknike ishin me shumë gabime, Komuna e Vushtrrisë i ka më mirë të hartuara. Është parashikuar pastrimi të bëhet për 180 ditë nga 18 muajt e kontratës kornizë. Pra ka dy sezone dimërore, që i bie nga 90 ditë secili sezon. Pastaj nga të dhënat e statistikave meteorologjike në Kosovë është marrë mesatarja e reshjeve të borës që është 22 ditë për një sezon. Gjatësitë e rrugëve janë dhënë më numra të rrumbullakuar si për shembull 2000m, 10000m. Pasi distancat mund të maten lehtë është dashur të jepet gjatësia e saktë. Gjerësia e shumë rrugëve së bashku me trotuar është dhënë më pak se katër metra. Në total gjerësia për rrugët brenda qytetit është 18470 metra, ndërsa sipërfaqja 81260 m². Nga këto dy vlera është nxjerrë gjerësia mesatare $81260 / 18470 = 4.42m$. Për të gjithë rrugët e fshatrave gjerësia është dhënë tre metra. Gjerësia e rrugëve si brenda qytetit, si e atyre rurale është më e madhe në praktikë.

Krahasuar me shumë paramasa të komunave tjera, këtu paramasa është hartuar më mirë, ku operatori është dashur të shënojë vetëm normën e TVSH-së dhe çmimin për njësi me TVSH, ndërsa formula i llogaritë të tjerat. Pika 1 në paramasë është për hedhjen e kripës, njësia matëse është ton, për pikën 2 që është për hedhjen e rërës, njësia matëse është m³. Pasi mirëmbajtja e planifikuar ishte 22 ditë në sezon, janë $22 \times 24 = 528$ orë të planifikuara, orë të cilat janë ndarë për orë punë për kamion. Edhe pse gjerësia e rrugëve ishte gabim, pastrimi është llogaritur me metër gjatësi, total 205.57km. Është llogaritur që një kamion këtë distancë e bënë për 10.05 orë duke u bazuar në shpejtësinë 20km/h. Pra për një sezon një kamion mund ta bëjë këtë distancë 52.53 herë, $528 \text{ orë} / 10.05 \text{ orë} = 52.53$ herë ose më shumë se dy herë në ditë. Është parashikuar që nëse ka reshje rrugët të pastrohen së paku dy herë në ditë. Përderisa në Komunën e Gjakovës rrugët ishin parashikuar që të pastrohen 10 dhe 12 herë brenda sezonës, që po ta llogarisim me mesataren e reshjeve del që $12 / 22 = 0.54$ pastrime për një ditë, apo të pastrohen çdo dy (2) ditë.

Pasi për këtë kryer këtë shërbim janë kërkuar tre kamionë dhe tre ngarkues, orët e punës janë ndarë në bazë të peshës, por operatori është dashur të japë çmim për secilin kamion. Kompania Ramadani ka dhënë çmim prej 25 euro për orë për të gjithë kamionët dhe ngarkuesit. Në total vetëm për orët e punës çmimi është 26,425 euro.

Edhe pse Komuna e Vushtrrisë ka bërë përpjekje që llogaritja të bëhet sa më e saktë, ka dhënë gjerësinë e rrugëve gabim. Ky gabim në paramasë nuk ka pasë efekt negativ pasi pastrimi i rrugëve është llogaritur me metër gjatësi. Por kjo nuk është dashur të ndodhë pasi po të jepej edhe gjerësia si duhet OE do ta dinin saktë sipërfaqen e rrugëve që kanë për t'u pastruar.

● **Ndërtimi i lapidarit në fshatin Gllavotin (Faza e I-rë)**

Tenderi për ndërtimin e lapidarit në Gllavotin është anuluar pasi nga një ofertë që ishte pranuar, ajo ishte e papërgjegjshme pasi kishte kaluar me dyfish vlerën e parashikuar që ishte 30,000 euro. Afati për fillimin dhe mbarimin e punëve ka qenë i dhënë me datë të caktuar.

Në Dosje të Tenderit është bashkangjitur edhe projekti i lapidarit, ashtu siç kërkohet në Udhëzues. Në specifikat teknike, në pikën 24 dhe 25 kërkohet që materiali të jetë i kualitetit të lartë, pa specifikuar se çfarë lloj kualiteti kërkohet. Në pikën 26 kërkohet që dimensionin e shkronjave që do të shkruhen në lapidar të jetë sipas standardave, pa specifikuar se sipas cilit standard.

Në pikën 27 ku kërkohet që gravimi i emrave dhe figurave të dëshmorëve, njësia matëse është paushall. Në pikën 31 kërkohen shporta të mbeturinave që do të vendosen përreth lapidarit, por pa dhënë dimensionet dhe kapacitetin e shportave.

Kushtet e Veçanta janë plotësuar, ndërsa garancioni është kërkuar për dy vite. Pasi tenderi është anuluar, nëse Komuna parasheh që të shpallë përsëri tender, do të ishte mirë që gabimet në pikat më lartë të përmirësohen.

● **Ndërtimi i Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina” në Vushtrri**

Tenderi për ndërtimin e Qendrës së Kulturës është bashkëfinancim së bashku me Ministrinë e Kulturës. Vlera e parashikuar është 1,400,345 euro, ndërsa afati për përfundimin e punëve është dhënë me ditë të caktuar, që është një praktikë e mirë. Nga tetë ofertues, gjashtë ishin të përgjegjshëm, ndërsa kontrata iu është dhënë kompanisë ENG Group dhe Ariani Co me çmim 1,178,132.50 euro. Sipas projektit që është bashkangjitur me DT është paraparë që të priset objekti ekzistues dhe të ndërtohet i riu. Përshkrimi teknik është i detajuar, por në disa pjesë janë kërkuar produkte nga prodhues të caktuar si dhe të përdoren standarde gjermane DIN. Në specifikat teknike, pika 9 që është për demelimin e objektit ekzistues nuk është dhënë sasia e as njësia matëse. Sasia e ka vlerën 0.

Në specifikat teknike, pika 22 që është për punët e dheut më përshkrim: furnizimi, hedhja dhe ngjeshja e zhavorrit nën themel pllakë me trashësi 175cm sasia është dhënë 1768.35 m^3 . Në Njoftimin për Kontratë sipërfaqja për bodrum është dhënë 678.59 m^2 , ndërsa sasia do të duhej të ishte $678.59 * 1.75 = 1187.53 \text{ m}^3$.

Në pikën 25 që është për latimin dhe betonimin e pllakës së themelit me trashësi 50cm, sasia e dhënë është 424.48 m^3 , ndërsa do të duhej të ishte $678.59 * 0.50 = 339.295 \text{ m}^3$. Edhe po të llogaritet me sipërfaqen e përdhësës që është 740.47 m^2 prapë sasia del më pak, $740.47 * 0.50 = 370.235 \text{ m}^3$.

Garancioni është kërkuar për një vit, ndërsa duke marrë parasysh rëndësinë e objektit dhe punët që do të kryhen është dashur të kërkohej për afat më të gjatë.

Në ofertën e konsorciumit fitues ka disa pika ku çmimet e ofruara dallojnë shumë nga çmimet në treg. Për shembull:

- Në pikën 41, 42 dhe 43 që është për muratimin e mureve të brendshme me giter blloka 25cm, çmimi është 45 euro, ndërsa nga Lista e KRPP-së⁷⁴ çmimi është 57euro m³.
- Në pikën 73, 74 dhe 75 që është për suvatimin e mureve, plafonëve dhe shkallëve, çmimi është 2 euro m², ndërsa nga Lista e KRPP-së⁷⁵ çmimet janë rreth 6 euro.
- Në pikën 76 dhe 77 që është për gletim të mureve dhe plafonëve është ofruar çmim 0.50 euro m², ndërsa nga Lista e KRPP-së⁷⁶ çmimi është 4.5 euro.
- Në pikën 80 që është për furnizim me pllaka graniti me dimensione 60 x 60cm, çmimi është 10 euro, nga Lista e KRPP-së⁷⁷ çmimi është 37 euro
- Në pikën 166 që është për furnizim me beton C30, çmimi është 45 euro m³, ndërsa çmimet në treg janë nga 50-60 euro
- Në pikën 167 për furnizim me kubëza betoni me trashësi 8cm ka ofruar me 4.80 euro, që është në koston e prodhimit, e çmimi në treg është së paku 12 euro për m².
- Në pjesën për instalimet elektrike, pika 114 është kërkuar hard disk me kapacitet 3TB nga kompania Seagate. Çmimi i ofruar prej 25 euro shumë i ulët krahasuar me çmimin prej 112 euro që e ofron Comtrade⁷⁸.
- Në pikën 115 është kërkuar monitor LED 27" me resolution Full HD i cili është me çmim 25 euro, ndërsa në treg kushton së paku 250 euro.
- Në pikën 117 është kërkuar pajisje e rrjeti, përkatësisht Switch SF500-48P i prodhuesit Cisco, çmimi i ofruar është 25 euro, ndërsa në tre dyqane online që D+ i ka shikuar kushton 964 dollarë, 1525 dollarë dhe 1165 euro (Amazon, Comelsoft, VoIP Supply).
- Në pjesën për punët e ngrohjes, në pikat 1 deri 6 që janë për furnizimin dhe montimin e radiatorëve çmimet janë nga 30-80€, ndërsa nga Lista e KRPP-së⁷⁹ çmimet janë nga 50-108€.

Në shumë pjesë fituesi ka dhënë çmime jo-normalisht të ulëta, për çka është dashur që Komuna të kërkojë sqarime nga kjo kompani. Për shkak që disa nga produktet nuk mund të prodhohen vetë ato blihen nga kompani tjera. Komuna duhet të sigurohet që furnizimet për hard disk, monitor, switch të jenë të reja dhe të papërdorura më parë, pasi në bazë të çmimi të dhënë ato nuk kanë mundësi të sillen të reja.

74 Lista e çmimeve njësi mesatare referent për punë ndërtimore dhe materiale ndërtimore, PN0270 (2015). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

<https://rebrand.ly/krpp>

75 Lista e çmimeve njësi mesatare referent për punë ndërtimore dhe materiale ndërtimore, PN0372 - 0377 (2015). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

<https://rebrand.ly/krpp>

76 Lista e çmimeve njësi mesatare referent për punë ndërtimore dhe materiale ndërtimore, PN0379 (2015). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

<https://rebrand.ly/krpp>

77 Lista e çmimeve njësi mesatare referent për punë ndërtimore dhe materiale ndërtimore, PN0347 (2015). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

<https://rebrand.ly/krpp>

78 "Barracuda Desktop 6Gb/S 3TB". Comtrade Computers. Qasur më 16 Mars 2018.

<http://www.comtrade-ks.com/sq/product/8206>.

79 Lista e çmimeve njësi mesatare referent për punë ndërtimore dhe materiale ndërtimore, PN1594 - 1598 (2015). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

<https://rebrand.ly/krpp>

● Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni (Faza e IV-rë)

Në këtë tender parashihen që disa rrugë të shtrohen më kubëza betoni. Vlera e parashikuar e kontratës është 87,439.57 euro, me datë të caktuar se kur duhet të përfundojnë punimet. Nga pesë (5) tenderues, të gjithë ishin të përgjegjshëm. Fitues është zgjedhur kompania Wenda me çmim 66,755.69 euro i cili ishte ofertuesi më i lirë. Garancioni është kërkuar për një vit. Përshkrimi teknik, që është shumë i detajuar, në disa pjesë ka kërkuar përdorimin e standardeve gjermane DIN të cilat janë gjermane dhe si të tilla nuk njihen nga legjislacioni kosovar, ndërsa kanë mundur të kërkojnë standarde ekuivalente ISO.

Në përshkrimin e çmimeve janë dhënë dimensionet e secilës rrugë, gjatësia dhe gjerësia. Sipas projektit bazë e rrugës është paraparë që të shtrohet më këto shtresa:

- Tampon prej gurit të thyer gëlqeror 0-60mm, t=20cm
- Tampon prej gurit të thyer gëlqeror 0-31mm, t=10cm
- Zhavor të lumit me fraksion 4-8mm t=5cm
- Kubëza betoni t=8cm
- Totali – 43 cm

Në disa rrugë sasia në metër kub është llogaritur gabim:

- Në rrugën Rafet e Burim Behrami, me dimensione 110 x 4m, te pika 6 është kërkuar furnizim me material prej gurit të thyer me trashësi 10cm. Sasia është dhënë 55 m³, por duhet të jetë $110 * 4 * 0.1 = 44 \text{ m}^3$
- Në rrugën Dituria me dimensione 277 x 3.5m, te pika 4 është kërkuar rrafshimi i nënbazës me grejder, ndërsa sasia është dhënë 1264.5 m². Sasia duhet të jetë $277 * 3.5 = 969.5 \text{ m}^2$
- Po në të njëjtën rrugë, në pikën është kërkuar furnizim me material prej gurit të thyer me trashësi 20cm. Sasia është dhënë 97 m³, ndërsa duhet të jetë $277 * 3.5 * 0.2 = 193.9 \text{ m}^3$. Sasia është llogaritur sikur të shtrohej me 10cm.

Për shtrimin e kubëzave me trashësi 8cm, Wenda ka dhënë çmim 6.7€. Edhe katër kompanitë tjera kanë dhënë çmime nga 6.5 – 8.7€ për shtrimin e kubëzave.

Edhe pse shumica e rrugëve i kanë llogaritjet mirë, në dy rrugë kishte gabime në llogaritje që mund të ju mundësojnë kompanive që ato të ofrojnë me çmime jo-normalisht të ulëta, kur ato e vërejnë që sasia e kërkuar është më e lartë se sasia reale. Njësia e Kërkesës duhet të sigurohet që nuk ka gabime në llogaritje të sasive, ndërsa zyra e prokurimit të bëjë kontrollimin e tyre para publikimit të Njoftimit për Kontratë.

ZBATIMI I KONTRATËS

Për monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate janë shikuar vetëm faturat, pagesat dhe dokumentet tjera. Urdhërblerja është bërë para se të fillojnë punimet, ashtu siç kërkohet me Rregullën Financiare. Deri më 1 qershor 2018 është kryer pagesa vetëm për një pjesë të punëve edhe pse në kontratë shkruan që punimet do të përfundojnë më 31 maj 2018. Situacioni i bashkëngjitur me fatura tregon që nga dhjetë rrugë që do të duhej të shtroheshin me kubëza, janë shtruar vetëm katër. Edhe pse Komuna e Vushtrrisë qëndron më mirë se komunat tjera, duke kërkuar që punët të përfundojnë me datë të caktuar, shkelja e afatit të përfundimit të punëve duhet të rezultojë me dënime për kompaninë.

● Riasfaltimi i rrugës lokale Vushtrri-Sllatinë

Në tenderin për riasfaltimin e rrugës Vushtrri-Sllatinë kishin ofertuar dy kompani, ku të dyja ishin të përgjegjshme. Fitues ishte zgjedhur kompania Bageri me çmim 18,966 euro, ndërsa vlera e parashikuar ishte 20,000 euro. Rruga duhet të riasfaltohet për 30 ditë. Është përdorur afati i shkurtuar për dorëzimin e ofertave me arsyen se “projekti financohet nga të hyrat vetanake, i cili deri më tani nuk ka mundur të plotësohet me mjete financiare për inicim të aktivitetit”. Arsyeja nuk është bindëse për të përdorur afatin e shkurtuar, ndërsa riasfaltimi i një rrugë nuk është punë urgjente. Është dashtë të përdorej afati normal.

Garancioni është kërkuar një vit për defekte, dhe tre vite për cilësinë e punëve. Edhe në përshkrimin teknik të kësaj rrugë janë kërkuar standarde gjermane DIN dhe rregulloret gjermane ZTV. Sic është theksar edhe më lartë këto standarde nuk janë të aplikueshme në vendin tonë.

Në specifikat teknike, te pika 5 dhe 6 që janë për furnizimin dhe ngjeshjen e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror me trashësi 10cm, sasisë janë dhënë të ndryshme 260 dhe 225 m³, ndërsa duhet të jetë 225 m³ për të dyja.

Gabimi në llogaritje të sasisë nuk duhet të ndodhë, pasi edhe pse në këtë rast sasia është e vogël po të ishte 225 m³ në pikën 5, çmimi i Bagerit do të ishte $225 * 5 = 1,125\text{€}$, ndërsa në ofertë e ka $260 * 5 = 1,300\text{€}$. Buxheti i Komunës do të kursehej për 175€.

ZBATIMI I KONTRATËS

Ky tender, përveç faturave dhe dokumenteve tjera është monitoruar duke e vizituar vendin ku janë kryer punët. Në vizitën që është bërë më 1 Qershor 2018 rruga ka qenë e riasfaltuar. Urdhërblerja është bërë rreth 1 muaj pasi kanë përfunduar punimet. Raporti i pranimit i kryerjes së punëve është më i detajuar duke dhënë informacione për ditët që nuk është punuar dhe pengesat. Nga paramasa, vetëm dy pozicione nuk janë punuar me vlerë 550 euro, e cila është shtuar në dy pozicione tjera.

● Rregullimi i varrezave






Tenderi për rregullimin e varrezave është anuluar dy herë. Në tenderin e parë ka pasur një ofertë e cila është cilësuar e papërgjegjshme pasi ka dhënë çmimet pa TVSH. Edhe në tenderin e dytë ka pasur një ofertë, por tani nga një kompani tjetër, e cila është cilësuar e papërgjegjshme pasi ka pasur gabime aritmetikore në ofertën e saj dhe pas korigjimit është tejkalluar limiti prej +-2%. Vlera e parashikuar ka qenë 15,000 euro me afat që varrezat të rregullohen për 40 ditë. Afati për pranimin e tenderëve ka qenë 18 ditë, ndërsa do të duhej të ishte 20 ditë, pasi vlera është e mesme. Bashkë me Dosjen e Tenderit është bashkëngjitur edhe projekti i varrezave, i cili ka gjithashtu edhe pamje se si do të dukeshin varrezat kur të përfundojë rregullimi i tyre. Garancioni është kërkuar një vit për defekte dhe tre vite për cilësinë e punëve.

Në specifikat teknike, pika 1 që është për gërmimin e dheut me trashësi 10cm sasia është dhënë me m², ndërsa duhet të jetë me m³. Në pikën 2 kërkohet betonimi i pllakave dhe mureve me beton me trashësi 15cm dhe dimensionet e varrit 2.3 x 1.2m sasia është dhënë 28.08 m³. Sasia nga dimensionet e dhëna del $2.3 * 1.2 * 0.15 = 0.414 \text{ m}^3$. Në DT kërkohet që rregullimi të bëhet për 24 varre, atëherë sasia totale është $24 * 0.414 = 9.936 \text{ m}^3$. Sasia e dhënë është shumë më e lartë se sasia e llogaritur në bazë të dimensioneve të dhëna. Në pikën 3 janë të dhëna të tri dimensionet, por sasia është kërkuar në m².

Edhe në këtë tender ka gabime, ku edhe pse janë dhënë dimensionet, sasia është llogaritur gabim e në një pikë në vend të përdoret m³ është përdorur m², ku dihet që nëse trashësia është më pak se 1m, sasia në m³ është më e vogël. Komuna duhet t'i përmirësojë gabimet në sasi para se të shpallë tender përsëri për rregullimin e varrezave.

Zgjerimi, thellimi dhe pastrimi i shtratit të Lumit Llap

Në këtë tender kishin ofertuar nëntë OE, ku të gjithë ishin të përgjegjshëm, ndërsa fitues ishte Wenda me çmim 81,554.01 euro. Krahasuar me vlerën e parashikuar që është 160,909.35 euro, çmimi i fituesit është përgjysmë më i ulët. Komuna është dashur që të kërkojë sqarime për tenderin me çmim jo-normalisht të ulët pasi plotësohen kushtet sipas formularit B57 të KRPP-së.

-  Mesatarja e të nëntë ofertave është 115,783.75€
-  $115,783.75 - 81,554.01 = 34,229.74$
-  $34,229.74 / 81,554.01 = 41.97\%$, ndërsa kufiri është 30%
-  Oferta e dytë më e lirë është 93,236€; $93,236 - 81,554.01 = 11,681.99$
-  $11,681.99 / 81,554.01 = 14.32\%$, pra është për më shumë se 10% më e lirë se oferta e dytë.

Në pikën 8 për gërmim të dheut në fundin e lumit ka ofruar me çmim 0.15€ për m³, ndërsa nga Lista e KRPP-së⁸⁰ çmimi varion nga 2 deri 5€.

Duke e parë që kompania Wenda ka ofruar me çmim rreth 80,000 euro më pak se vlera e parashikuar, si dhe pasi i ka plotësuar kushtet për të kërkuar sqarime për tender jo-normalisht të ulët. Komuna është dashur të kërkojë sqarime siç obligohet edhe me ligj. Pasi tenderi është jo-normalisht i ulët është reflektuar edhe në çmimet e dhëna. Këtu nuk ka proces të prodhimit që të mund të llogaritet kosto, ndërsa Wenda do ta kishte të vështirë t'i arsyetonte çmimet e dhëna. Po ashtu në rast se komuna do të kishte dyshime në realizimin e suksesshëm të punimeve ka mundur të rrisë kërkesën për sigurim të ekzekutimit të punimeve deri në 100% sipas nevojës. Gjë e cila do të ofronte një siguri më të madhe se kompania do të respektojë kontratën dhe afatet.

80 Lista e çmimeve njësi mesatare referent për punë ndërtimore dhe materiale ndërtimore, PN0009 - 0058 (2015). Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. <https://rebrand.lv/krpp>



**DEMOCRACY
PLUS**



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA